
Parapagimi për revistën.....	2
Festivali veror i filmave politik.....	3
Ligji i All-llahut.....	8
Si të bëhemi zemërbutë?.....	9
Kushtet e debatit dhe etika e tij.....	12
Kujto ditën e gjykimit.....	15
Mos mallko!.....	30
Sunneti dhe mustehabi.....	32
Pavarësia e sistemit gjyqësor.....	34
Vendimi islam për eutanazinë.....	37
Rreziqet e zinasë.....	39
Artistja dhe udha e saj drejt dritës.....	43
Ahmed Didat.....	46
Imam Shu'be ibën El Haxh-xhaxh.....	47
Hafsa bint Sirin.....	49
Imam ibën Ebil Izz el Hanefi.....	49
Muaji Shaban.....	51
Veçoritë e besimit.....	57
Porosia e Nuhit, alejhis-selam.....	61
26. Mëshira.....	63

Parapagimi për revistën

Ofrojmë mundësinë që të parapaguheni me parapagim vjetor në revistën Albislam. Parapagimi kushton gjithsej **10 euro** (dhjetë) për Europë, (përfshirë edhe Shqipërinë, Kosovën, Turqinë dhe ish republikat Jugosllave) dhe vetëm **310 denarë** për parapaguesit nga Maqedonia. Me këtë parapagim brenda një viti juve ju dërgojmë 12 numra të revistës, prej numrit aktual kur ju parapaguheni. Në këtë çmim janë të përfshira edhe harxhimet postare për dërgim të thjeshtë.

Për parapagim mjafton që të dërgoni pajtimin tuaj me emrin dhe adresën e plotë në:

email: albislam@albislam.com

sms: +389 70 445 725

fax: +389 2 3290 408

tel: +389 2 3290 408 (çdo ditë, përveç të xhumasë dhe të dielës, prej 9 deri 16)

ose me postë në: rr.386 nr.11, Q.T. Mavrovka lok.44, 1000 Shkup, Maqedoni

viti III nr: 26

albislam@albislam.com

redaksia: Ramadan Ramadani (kryeredaktor)

rr: 386 nr: 11

Agim Bekiri (ndihmës kryeredaktor)

Q.T.Mavrovka lok: 44

Bekir Halimi, Talha Kurtishi,

1000 Shkup

Alajdin Idriz, Fatmir Zaimi, Ali Shabani

fax: +389 2 3290 408

Del në fillim të muajit, kalendari i hixhretit, takvimi i Türkiye Diyanet Vakfi. Numri i ardhshëm: 05 10 2005

Boton: NUN-R DOOEL

Xhirollogaria: 300000001759616 Komercijalna Banka A.D. - Skopje (denar)

Xhirollogaria: 0270100209184 Komercijalna Banka A.D. - Skopje (euro)

rr. "Kej Dimitar Vlahov" 4

S.W.I.F.T. : KOB5MK2X

IBAN MK07300701002091869

Numri tatimor: 4030003487017

Revista është e regjistruar pranë Agjencisë për Informata të Maqedonisë nr. 02-124/2.

Shtypur në: Cetus Print DOOEL-Shkup Tirazhi: 800 kopje ISSN: 1409-6250

Festivali veror i filmave politik

U rrit befasia dhe dallimet në ndodhitë e njëpasnjëshme që ndodhin përreth nesh në këtë sezon verore. Këto ndodhi e shndërruan skenën arabe si një festival të filmit politik përplot kuriozitete që dallojnë nga filmat kinematografik të zakonshëm në një pjesë të rëndësishme, e ajo është se regjisori dhe skenaristi nuk shfaqen në ballinën e filmit, përpos se befasi në disa raste.

1- Merr për shembull filmin e kushtetutës irakiane, duke filluar nga skena që e përcjellim natën e martë me datë 23.08.2005 kur u mbledh parlamenti, në të cilin dominonte trema dhe stresi, sidomos pasi që kaloi koha e mbledhjes pa dalë në horizont ndonjë gjë që tregonte lajmin, të cilin të gjithë e pritnin dhe i cili do ta përcaktonte zhvillimin e mbarrë parlamentit. Kjo ka ndodhur sepse sipas agjendës, të cilin e ka përcaktuar ligji bazë, drafti i kushtetutës së re duhej të përfundonte më 15 gusht, përndryshe do të shpërbëhej parlamenti dhe të formohej një komision tjetër për të realizuar këtë detyrë. Pasi që komisioni i formuar nuk arriti t'i tejkalojë divergjencat e shkaktuara mbi projektin mes grupeve kryesore (sunnitet, shiitët dhe kurdët) në afatin e caktuar, ata kërkuan t'u zgjatet afati edhe për një javë që të përfundonte më 23 gusht. Arritja e pajtimit mes këtyre tre grupeve ishte kushti kryesor, i cili ishte vendosur që në fillim, kur pranuan përfaqësuesit e Sunitëve të merrnin pjesë në këtë komision. Në dhjetë minutat e fundit të mbledhjes parlamentare, kryetari i parlamentit hipi

në vendin e tij dhe lajmëroi se parlamenti e ka pranuar draftin e kushtetutës, kurse kur e shprehu këtë fjali, e tërë salla ushtoi nga duartrokitjet, nga gëzimi i kësaj të arriture dhe nga galdimi me suksesin e parlamentit për të zgjidhur këtë situatë. Mirëpo kryetari i parlamentit e vazhdoi fjalimin e tij duke thënë se në këtë draft-kushtetutë kanë mbetur edhe disa pika të papërfunduara, të cilat kërkojnë edhe tri ditë të tjera për të eliminuar divergjencat rreth tyre, pastaj ua ktheu shpinën, e la binën e vet dhe doli nga salla duke e lënë sallën dhe njerëzit në të të habitur.

Atë që nuk e ka xhiruar kamera, është fakti se kjo befasi nuk ka qenë e vetmja, por ka pasur edhe befasi të tjera. Më e rëndësishme është se ofrimi i draft-kushtetutës ka ndodhur pasi që është prishur rregulli i harmonizimit, sepse u pa qartë se kjo ka qenë marrëveshje mes shiitëve dhe kurdëve, duke izoluar Sunitët, përfaqësuesit e të cilëve ishin në bisedime me ambasadorin amerikan dhe atë britanik, për t'i bindur që të zbusin qëndrimet e tyre dhe ta kalojnë këtë draft-kushtetutë. Ajo që është më e rrezikshme në këtë marrëveshje është se ata janë sjellë me Irakun si të ishin shoqëri aksionare e jo vatan, pasi që secila palë është munduar të rrisë aksionet e veta dhe të realizojë fitim sa ma të madh në tokën dhe thesaret e naftës, gjë e cila siguron gjendje shumë të përshtatshme për ndarjen e Irakut në të ardhmen.

Kjo befasi nuk e goditi vetëm Ehli Sunetin, por edhe disa qarqe nacionaliste dhe arabe që kujdesen për unitetin e Irakut.

Kjo i shqetësoi edhe disa grupacione përbrenda vetë shiitëve, e cila doli në shesh me mobilizimin e fraksionit të Sadrit në protestat e simpatizantëve të vet, të cilat i ka regjistruar kamera dhe u përleshën me "Brigadën e Bedrit", e cila është krahu ushtarak i Abdul-Aziz Hakimit, i cili ka thirrur në themelimin e një rajoni federal të shiitëve, duke i bashkuar disa komuna të mesit dhe jugut të Irakut.

Parlamenti kurd nxitoi ta përkrahë këtë draft-kushtetutë, të cilin e konsideroi "sukses" sepse i dha legjitimitet gjendjes së krahinës kurde, në të cilën liderët e tyre sillen si të jenë të pavarur në qeverinë Irakiane. (Sa për informatë, Uashingtoni shpali një marrëveshje të vitit 1998 mes kurdeve dhe Ministrisë së punëve të jashtme amerikane, ku përgjegjësit e parë konfirmuan menaxhimin e burimeve të naftës dhe gazit në Kurdistan për dyzet vjet. Bazuar në këtë fakt, kurdët u dhanë të drejtë ekskluzive për gropimin e naftës në krahinë disa sipërmarrjeve amerikane duke mos u konsultuar me qeverinë qendrore në Bagdad).

Pamja e fundit dhe që ta tërheq vëmendjen në këtë film, është se Bushi hyri në këtë debat nga toka e tij në Teksas duke ua tërhequr vërejtjen Ehli Sunetit nga kundërshtimi i kësaj draft-kushtetute. (Më herët treguam presionin që u bënte ambasadori i tij në Bagdad).

Ky insistim amerikan nuk ka pasur lidhje me ardhmërinë e Irakut, sepse ardhmëria e Bushit dhe llogaritë e tij të brendshme ishin shtytësi kryesor, sepse publikimi i draftit-kushtetutës në këto ditë ishte kërkesë dhe insistim amerikan, sepse në këtë mënyrë do të kontribuohet në mbulimin e dështimit ushtarak në Irak, kurse nga ana tjetër është

letër, të cilën kryetari amerikan dëshiron ta përdorë për ta mbrojtur pretendimin e tij "misionar", i cili përgëzonte demokracinë, gjatë ballafaqimit me kampanjën e kritikave në rritje e sipër kundër tij. Në anën tjetër, ky publikim i mundëson më shumë pika, të cilat mund ti shfrytëzojë me rastin e përkujtimit të 11 shtatorit që vjen pas pak ditësh.

Pamja e fundit që ta tërheq vëmendjen janë divergjencat e thella mes anëtarëve të komisionit kushtetues rreth kësaj draft-kushtetute, sepse zakonisht divergjencat duhet të jenë gjatë përpilimit e jo pas përpilimit të kushtetutës. Mirëpo, të gjitha dëshmitë tregojnë se ata kanë divergjencë mbi një draft që u është sjellë, jo që ata vetë e kanë përpiluar. Kjo vetvetiu shkaktonte një pyetje të madhe: kush është pala që e ka kryer këtë detyrë?!

Befasia e filmit dhe sekretit publik në Bagdad, është ajo që e përflasin ata që interesohen për këtë çështje se amerikanët janë ata që e kanë përgatitur origjinalin e këtij projekti, kurse detyrë e komisionit ka qenë "formulimi", vepër e cila nuk e kalon kufirin e përkthimit të atij teksti në gjuhën arabe!

Edhe më tej vazhdon prezantimi i këtij filmi me pengesa të mëdha!

2- Një shkrimtar palestinez, Azmi Beshare e përshkruan tërheqjen nga Gaza duke e cilësuar si prezantimi më i madh televiziv në histori, (Gazeta "El-Hajat", 25, 08) sepse policia e qeverisë izraelite kujdeset që aty të ishin kamerat që nga fillimi i punës për t'u paraqitur para opinionit publik se janë duke u "flijuar" për hir të paqes, madje edhe duke i shkullur shtëpitë e ardhacakëve ku i kishin mbjellë ëndrrat e tyre. Në pamjen e tërheqjes, të gjithë u shndërruan në aktorë të stërvitur për të luajtur rolet e tyre. Kolonët kapen për toke duke qarë, kurse ushtarët i marrin me dhunë dhe duke i ulur kokat i tërheqin. Sharoni shfaqet i mërzhitur për të

treguar se kjo pamje e ka shtyrë të qahet. Mirëpo, pamjet e këtij filmi dramatik nuk ndalen në këtë kufi, madje skenaristët kanë shkuar edhe më larg, sepse nuk janë mjaftuar me fotografinë e kësaj katastrofe që u ka ndodhur kolonive, por i kanë lëshuar dritë "fundit të keq" që u kërcënohet qindra maceve dhe qenve pas largimit të kolonive. (Gazeta Hartz, më datë 14.08 solli lajmin e takimit të njerëzve që janë aktivë në mbrojtjen e të drejtave të kafshëve me përgjegjësit e qeverisë për të hulumtuar mënyrën e ballafaqimit të këtij problemi dhe është folur mbi thirrjet që janë përhapur për të thirrur izraelitët që qentë dhe macet që kanë mbetur pa kujdesi pas shpartallimit të kolonive t'i merrnin me vete).

Kamerat dhe raportet gazetareske ishin shumë aktive në propagandimin e këtyre pamjeve të improvizuara, kurse kjo gjë ka penguar botën e jashtme që të shohë fytyrën e vërtetë dhe trishtuese të atentatit të mbarë një toke dhe dëbimi i më shumë se pesë milion palestinezëve në vende të ndryshme dhe nënçmimi i më shumë se katër milion e 600 mijë të tjerëve që banojnë në Gaza dhe Bregut Perëndimor. Fatkeqësisht, disa media arabe kanë rënë në këtë kurth dhe kanë marrë pjesë në xhirimin e kësaj loje të tërheqjes së kolonëve duke mos hedhur dritë mbi dimensionet e fatkeqësisë së vërtetë palestineze në Gazë dhe Bregun Perëndimor.

Pjesa e dytë e filmit rrotullohet mbi Gazën pas tërheqjes, kurse veçori e dukshme është ajo e llojit stihik, të cilin nuk mund ta kuptojë logjika. Në këtë drejtim është edhe ajo që e dëgjuam nëpërmjet radio Monte Karlos më datë 19.08 se pas tërheqjes nga Gaza: "Nuk ka më nevojë për rezistencë dhe armë". Duke e injoruar faktin se Gaza (365 km²) nuk paraqet më shumë se 6% e tokave që i ka okupuar Izraeli në vitin 1967 dhe

se çlirimi i Bregut Perëndimor është "xhihadi i madh", të cilin domosdo palestinezët duhet të futen në të. Ata në këtë rrugë nuk kanë asgjë tjetër përveç rezistencës, për kohën dhe mënyrën e së cilës ata vetë duhet të vendosin dhe askush nuk mund ta fshijë me aq lehtësi.

Është gjë e kotë në këtë film edhe deklarata e ministrit për punë të jashtme izraelite se vendi i tij do të studiojë idenë e nxjerrjes së rezolutës nga këshilli i sigurimit se Gaza nuk është më vend i okupuar, në kohë kur përgjegjësit në pushtetin palestinez janë unanimit se Gaza sipas kriterëve të ligjeve ndërkombëtare akoma është tokë e okupuar edhe pse ushtria izraelite është larguar nga pikat e veta. Këtë e ka shprehur ministri i punëve të jashtme palestineze Nasir El-Kudve dhe ministri përgjegjës për dosjen e tërheqjes, Muhamed Dehlani, i cili shumë qartë tha se Gaza do të mbetet nën përgjegjësinë e okupuesit në aspektin juridik, "sepse ata do të qeverisin me jetën tonë në një formë ose tjetër, nëpërmjet pikëkalimeve, porteve detare ose ajrit".

Nuk di si ta klasifikoj këtë film, si dramë ose komedi, pasi që në kohën kur Izraeli veproi për të shpallur përfundimin e okupimit të Gazës, ajo dëshiron të çlirohet nga të gjitha përgjegjësitë ligjore që i detyrohen pushtetit palestinez në përputhje me marrëveshjen e katërt të Gjenevës, e cila i detyron në këtë gjendje ti mbrojnë civilët dhe t'u sigurojë nevojat esenciale, shëndetësore dhe të arsimit. Loja në fakt është që Gaza të çlirohet juridikisht, mirëpo të mbetet e okupuar realisht. Kjo nuk është gjëja më e çuditshme, sepse logjika stihike na udhëzon drejt asaj që është edhe më e çuditshme se kjo. Nuk është çudi që ndonjë ditë Uashingtoni të përdorë ndikimin e tij dhe të nxjerrë rezolutë dëfryese që u përgjigjet dëshirave izraelite.

3- Filmi i tretë na e kujton atë që e kemi harruar në botën arabe. Na befasoi më 3 gusht grusht-shteti ushtarak në Mauritani, i cili e rrëzoi pushtetin e Veled Taiut, i cili në këtë pushtet ishte 21 vjet. Edhe pse kjo ndodhi është e rëndësishme, mirëpo disa gjëra që u përvodhën mbi prapavijën e këtij grusht-shteti janë kurioze, saqë kjo ndodhi mund të propozohet që të jetë pjesë e këtij festivali filmik. Prej prapavijave të kësaj ndodhie janë:

- Konflikti amerikano-francez për dominim në magribin arab ka rol në lëvizjen e këtij grusht-shteti në Mauritani. Vetë kryetari i shkarkuar Veled Tai kur erdhi në pushtet në vitin 1984, erdhi me grusht-shtet ndaj gjeneral Muhamed Veled Hejdele, kurse Franca qëndronte pas këtij grusht-shteti. Shkaku ishte se Veled Hejdele u thirr në një konferencë frankofone në Burundi (dhjetor 1984), mirëpo ai e ndryshoi vendimin për pjesëmarrje pasi që kishte nuhatur erën e komplotit kundër tij. Mirëpo, kryetari i Francës Fransua Miterani ndërhyri personalisht dhe insistoi shumë duke e siguruar dhe duke e bindur për të udhëtuar. Ai edhe u pajtua. Mirëpo, sa fluturoi aeroplani i tij nga aeroporti i Nevakshotit, u realizua ajo nga e cila kishte frikë dhe kryetari i atëhershëm i qeverisë, Muhamed Veled Taiu, organizoi grusht-shtet ushtarak dhe si pasojë e këtij veprimi e mori pushtetin. Mirëpo, ditët kaluan dhe Veled Taiu dëshiroi ta forcojë qëndrimin e tij në ballafaqimet me armiqtë e brendshëm dhe filloi të krijojë raporte me Uashingtonin duke krijuar raporte me Izraelin. Franca nuk ishte e gëzuar me hyrjen amerikane në zonat që sipas saj janë zona të saja. Andaj raportet francezo-amerikane përjetuan acarim për këtë shkak. Kjo krizë arriti kulmin e vet kur Veled Taiu bëri marrëveshje ushtarake me komandantin e komandës ushtarake ameri-

kane në Evropë, Admiralin Hamlin për të bartur forcat ushtarake amerikane të vendosura në Detin Mesdhe në bazën "Rota" në jug të Spanjës në bazë tjetër në Mauritani, në zonën "Lemigitij". Kjo marrëveshje ishte krëndja që e theu kurrizin e devesë, sepse takimi mes këtyre dy njerëzve ndodhi më 14 korrik, kurse grusht-shteti më 3 gusht.

- Veled Taiu kur krijoi raporte diplomatike me Izraelin në vitin 1999, ai e dobësoi me të madhe pushtetin e tij dhe aspak nuk e forcoi, sepse ky hap ishte goditje e madhe për popullin mauritanë dhe elitën, e cila ka lidhje të fuqishme me lojalitetin arabo-islamik. Ky hidhërim të cilin e shkaktoi ajo goditje ishte shkaku i grusht-shteteve të përgjakshme të udhëhequra nga elementet nacionaliste kundër Veled Taiut në vitin 2003 dhe dështuan pas një lufte që zgjati 36 orë. Kryetari i mëparshëm reagoi kundër këtyre veprimeve duke nisur kampanjë për të burgosur shumë nacionalistë dhe islamistë. Të parët i akuzoi për grusht-shtet, kurse të dytët për terrorizëm dhe për themelimin të krahut ushtarak dhe sekret me emër "Njësi Musab Ibën Umejri". Më interesant është fakti se udhëheqësit e kësaj "organizate" u detyruan të japin deklarata konfirmuese para ekraneve televizive që më pastaj të bëhet e qartë se kjo çështje është e shpifur dhe se kjo organizatë sekrete e rrezikshme është vetëm një klub rinor edukativ, i cili bart emrin e Musab ibën Umejrit!

4- Filmi i katërt është mes realitetit dhe imagjinatës, sepse në këtë film ekzistojnë që të dy këto elemente. Mediat publikuan lajmin nga kryeqyteti i Libisë, Tarablusi, se Sejful-Islam Gadafi ka shpallur planin konkret për liberalizim të politikës dhe pajtim me shoqërinë libiase, i cili filloi me lirin e një grupi të aktivistëve politik dhe me thirrje drejtuar opozitës që janë në ekzil të kthehen në

vendin e tyre. Gjëja më e rëndësishme që tha është se dosja e vrasjeve, spastrimeve dhe konfiskimeve që kanë ndodhur gjatë dy dekadave, nga komisionet popullore dhe gjykatat revolucionare, do të hapen, për të kompensuar ata që janë dëmtuar dhe për të barazuar gjendjen e familjes së tyre duke treguar qartë se ato gjykime nuk kanë qenë legale dhe legjitime.

Për herë të parë, vështirë se mund ta besojë njeri këtë lajm, i cili nuk dëgjohet në këto vende përveç se pas ndonjë grusht-shteti ushtarak. Mirëpo, raportet që dalin nga Tarablusi e sjellin të njëjtin lajm dhe të njëjtat detaje që e potencojnë se këto fjalë kanë origjinë dhe se burojnë nga Sejful-Islami, i cili nuk do ta kishte nisur këtë kampanjë pa pëlqimin e babait të tij, kryetarit, Muamer Gadafi.

Ajo që nuk e kam kuptuar dhe ia lë që ta zgjedhë këtë gjë regjisorit i filmit është fakti

se këto fjalë u publikuan gjatë ekzistimit të kryetarit të komisionit të raporteve të jashtme në Kongresin amerikan, senatori Richard Lujer, i cili ishte për vizitë në kryeqytetin libias dhe u cilësua që është shumë i rëndësishëm. Është thënë se senator Lujeri ka humtuar gjatë kësaj vizite disa gjëra që kanë të bëjnë me zhvillimin e raporteve të këtyre dy vendeve, luftës kundër terrorizmit dhe të drejtat e njeriut në Libi. Pastaj pas dy ditëve lexuam se i është bërë thirrje zyrtare Bushit dhe ministres për punë të jashtme që ta vizitojnë Libinë dhe se dy ambasadat do të hapen në dy vendet për disa ditë.

Nuk janë këto të gjitha filmat e kësaj vere arabe, sepse kemi parë edhe filma të tjerë, mirëpo janë të nivelit shumë të ulët, në mënyrë që ato mund të prezantohen jashtë festivalit!

Fehmi Huvejdi
Përktheu: Bekir Halimi

Ligji i All-llahut

All-llahu i Madhërishtëm e ka krijuar gjithësinë dhe çdo gjë që gjendet në të dhe Ai ka vendosur ligje në bazë të të cilave funksionon gjithësia. Ligjet e All-llahut, subhanehu ve teala, janë dy lloje:

1. Ligjet e Gjithësisë: Këto janë ligjet e natyrës, të cilat All-llahu i ka vendosur dhe të cilave u nënshtrohen të gjitha krijesat. Të gjitha krijesat i nënshtrohen ligjeve të cilat Ai ua ka caktuar dhe nuk kanë zgjidhje tjetër dhe nuk mund të dalin nga sundimi i All-llahut. P.sh. lindja dhe vdekja. Të gjithë njerëzit i nënshtrohen lindjes dhe të gjithë njerëzit i nënshtrohen vdekjes. Këto të dyja, lindja dhe vdekja, janë ligje që i ka caktuar All-llahu për jetën e kësaj bote. Askush nuk mund t'u ikë këtyre ligjeve.

2. Ligjet e Sheriatit: Këto janë ligjet që All-llahu ua ka caktuar krijesave të cilat janë të ngarkuara me përgjegjësi dhe të cilat kanë lirinë e zgjedhjes. Këto krijesa janë njerëzit dhe xhinët. Ligjet e Sheriatit, që kanë ardhur nëpërmjet Pejgamberëve, në krye me pejgamberin e fundit Muhammedin, sal-lallahu alejhi ve sellem, janë ligje për të mirën e njerëzisë në jetën e kësaj bote dhe të ahiretit. Ligjet e shariatit kurrsesi nuk bien ndesh me ligjet e Gjithësisë.

All-llahu i Madhërishtëm thotë: "A mos kërkojnë ata fe, pos fesë së shpallur nga All-llahu? E Atij i është dorëzuar gjithëçka ka në qiej e në tokë, me dashje e pa dashje dhe tek Ai kthehen." [Ali Imran: 83].

Çdo krijesë i nënshtrohet All-llahut, me dashje dhe pa dashje. Pra, nënshtrimi është dy llojesh:

1. Nënshttrim pa dashje: Të gjitha krijesat i nënshtrohen All-llahut pa dashje. I nënshtrohen ligjeve që Ai i ka caktuar për natyrën, i nënshtrohen lindjes dhe vdekjes që ua ka caktuar All-llahu dhe i nënshtrohen plakjes.

2. Nënshttrim me dashje: Ky është nënshttrim i veçantë i besimtarëve. Ata i nënshtrohen shariatit të All-llahut me dashje, e adhurojnë All-llahun, si dhe jetojnë sipas normave që i ka caktuar All-llahu. All-llahu ua ka bërë obligim këtë lloj nënshtrimi njerëzve, mirëpo nuk i ka detyruar me këtë, por i ka lënë të zgjedhin. Mirëpo, u është kërcënuar atyre që nuk e kryejnë obligimin me dënim në xhehenem, kurse ata që e kryejnë këtë obligim, i ka përgëzuar me shpërblim në xhennet.

All-llahu i Madhërishtëm e dërgoi Muhammedin, sal-lallahu alejhi ve sellem, si mëshirë për mbarë botët, në një kohë kur mbi rruzullin tokësor mbisundonin errësitat e kufrit, mosbesimit, idhujtarisë dhe mëkateve. Në një kohë kur disa njerëz i shtypnin dhe i mundonin njerëzit e tjerë. Në një kohë kur njerëzimi jetonte si kafshët, madje edhe në mënyrë më të humbur. Në një kohë kur mbretërit e quanin veten zot dhe i urdhëronin njerëzit që t'u nënshtroheshin atyre dhe t'i adhuronin ata. Në këtë kohë All-llahu e dërgoi njeriun më madhështor, mësuesin e njerëzimit, edukatorin më të madh, njeriun më të sjellshëm dhe më të moralshëm, njeriun i cili i vuri themelet e civilizimit dhe moralit, e dërgoi Muhammedin, sal-lallahu alejhi ve sellem, që t'i nxjerrë njerëzit prej errësirave të

kufrit dhe mëkateve, prej padrejtësisë së tiranëve, në dritën e besimit dhe devotshmërisë dhe në drejtësinë e Sheriatit Islam.

Për 23 vjet, aq sa zgjati misioni i Muhamedit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, arriti që të bëjë ndryshime rrënjësore në shoqërinë njerëzore, arriti që t'i vendosë bazat e moralit, adhurimit, ekonomisë, ligjit dhe të gjitha sferat e tjera jetësore.

Pra, Islami është mënyrë jetese dhe i përfshin të gjitha aspektet e jetës. Është mënyrë jetese ashtu siç na ka mësuar Krijuesi jonë. Ashtu siç i nënshtrohemi ligjeve të Gjithësisë, ashtu duhet t'u nënshtrohemi ligjeve Sheriatike, sepse të dyja i ka vendosur All-llahu i Madhërishtëm. Mirëpo ekziston dallim ndërmjet tyre, se Ligjeve të Gjithësisë u nënshtrohemi pa vullnetin tonë, kurse ligjeve të Sheriatit u nënshtrohemi me vullnetin dhe zgjedhjen tonë.

Prandaj, ku ka liri të zgjedhjes ka edhe shpërblim apo ndëshkim. All-llahu nuk të shpërblen pse u je nënshtroar ligjeve të Gjithësisë, sepse u je nënshtroar pa vullnetin tënd, mirëpo, të shpërblen nëse i nënshtrohesh ligjeve të sheriatit me xhennet dhe të dënon me xhehennem nëse nuk u nënshtrohesh, sepse këto gjëra i ke bërë me vullnetin tënd.

Për këtë gjë luftoi Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, për t'i drejtuar njerëzit në rrugën e Xhennetit dhe për t'i larguar nga rruga e Xhehennemit, për t'i drejtuar drejt ligjeve të All-llahut dhe për t'i larguar nga ligjet njerëzore, të cilat janë të padrejta dhe janë në interes të pakicës, duke i bërë padrejtësi pjesës tjetër.

Nënshtrimi ndaj ligjeve është adhurim, e adhurimi i takon vetëm All-llahut, prandaj vetëm Sheriatit duhet t'i nënshtrohemi...

Omer Islami

Si të bëhemi zemërbutë?

1. Prej shkaqeve më të mëdha për zbutjen e zemrës së robit është leximi i Librit të Allahut, subhanehu ve teala. Me asgjë tjetër nuk mund të zbutet zemra ashtu si zbutet me këtë libër madhështor, çudirat dhe mirësitë e të cilit nuk kanë fund.

Andaj, prej mirësive më të mëdha që Allahu ia dhuron robit të tij është inspirimi për lexim të shumtë të Kur'anit Famëlartë, lexim me meditim dhe ndikim. Thotë Allahu, subhanehu ve teala: "Dhe atyre ua sollëm librin të sqaruar me argumente". (Araf-52)

Njeriu më zemërbutë është ai i cili kur lexon fjalët e All-llahut, subhanehu ve teala, i dridhet dhe i përmallohet zemra për All-

llahun e Lartë dhe i zgjerohet gjoksi. I lexon ajetet e Kur'anit, të cilat e nxjerrin prej ngushtisë së kësaj dynjaje në gjerësinë e ahiretit, e afrojnë te premtimi i All-llahut, për atë premtim të cilin fluturon nga gëzimi i madh duke shpresuar mëshirën e të Gjithëmëshirshmit. Ato ajete, pastaj, e shëtisin atë nëpër kërcënimet e All-llahut, derisa trishtimi i xhehennemit i parafytyrohet në ato momente, ashtu që, zemra i thyhet dhe i përulet All-llahut më tepër. Pikërisht për këtë, mund të vëresh se ata që më së tepërmi e lexojnë Kur'anin janë njerëzit më zemërbutë, sepse All-llahu, subhanehu ve teala, ua ka zbutur atë, Ai ka thënë: "Juve ju erdhi këshilla prej Zotit tuaj, në

të cilën ka shërim për atë që fshihet në gjoks”. (Junus-57)

Ngurtësia e zemrës është sëmundje, dhe Allahu dëshmon se shërimi i saj gjendet në librin e Tij. Pra, zemra nuk mund të zbutet me asgjë, ashtu si zbutet me librin e Allahut, subhanehu ve teala. Ky është shkaku pse Resulullahu, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, i tha Abdullah ibën Mes’udit: “Më lexo Kur’an”, tha: O i dërguar, si të të lexoj ty, ndërsa ty të ka zbritur? I tha: “Kam dëshirë që ta dëgjoj prej të tjerëve”. Tha Ibën Mes’udi radijallahu anhu: “Fillova t’ia lexoj suren en-Nisa derisa arrita te ajeti: “Dhe si do të jetë gjendja e atyre (që nuk besuan), kur Ne do të sjellim dëshmitarë për çdo popull, e ty do të sjellim dëshmitarë mbi ata (që nuk të besuan)? Atë ditë ata që nuk besuan dhe kundërshtuan të dërguarin, do të dëshironin që toka të rrafshohej mbi ta, ngase nuk mund t’i fshehin All-llahut asgjë”. (Nisa-41,42) Te ky ajet më tha: “Mjaft”, e shikova dhe pashë sytë e tij si kishin filluar të lotojnë.”

Resulullahu sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ishte njeriu me devotshmëri më të plotë ndaj All-llahut, subhanehu ve teala, ndonjëherë, gjatë leximit të Kur’anit në namaz të drekës, dëgjohej një zë sikurse vlimi i ujit në kazan. Kjo ndodhte prej qarjes së tij dhe butësisë së zemrës që kishte.

Gjeneratat e para (selefu salih) e lexonin Kur’anin me shumë devotshmëri dhe kjo ndikonte në zbutjen e zemrës, në shtimin e devotshmërisë dhe në zgjerimin e gjoksit. Ka ndodhur shpesh, kur ishin të hidhëruar, lexonin ca ajete dhe menjëherë iu zbutej zemra, kur u vinin të mira nga kjo dynja, lexonin ca ajete dhe menjëherë e jepnin atë pasuri në rrugë të All-llahut, subhanehu ve teala.

Pra, ai që do lumturinë e plotë, të jetë zemërmirë dhe punëmirë, atëherë le ta zgje-

dhë për udhëheqës të tij Kur’anin Famëllartë në çdo gjë.

2. Prej shkaqeve është edhe duaja (lutja). Ta lusë All-llahun për zemër të butë e të devotshme dhe të kërkojë mbrojtje nga zemra e ngurtë. Po ashtu të kërkojë nga All-llahu, subhanehu ve teala, mbrojtje prej fitneve dhe sprovave të ndryshme të cilat ia ngurtësojnë zemrën.

3. Bamirësia ndaj prindërve. Ai i cili u bën mirë prindërve dhe e fut gëzimin në zemrat e tyre, All-llahu ia zgjeron gjoksit, ia ndriçon zemrën dhe ia bën atë të butë. Dhe ashtu bëhet që të meritojë xhenetin, banorët e të cilit u zbuten zemrat dhe u zgjerohen gjokset çdoherë kur bëjnë, shohin apo dëgjojnë për mirësi e devotshmëri.

Kush është i lumtur?! I lumtur është ai i cili është bamirës ndaj prindërve, i cili duke mos e harruar hakun dhe vlerën e nënës dhe babait u ka bërë mirë sa ka mundur. Këtë njeri, mund ta vësh se çdoherë kur del prej shtëpisë së prindërve, prindërit e tij i ngrejne duart për të bërë lutje për të birin (bijën). Ashtu që e mbulon mëshira e All-llahut kudo që të gjendet. Mund ta vësh se ky njeri ka zemër të butë dhe është vepërmirë.

Si dhe, e kundërta me të kundërtën. Prej shkaqeve më të mëdha që e ngurtësojnë zemrën është mosrespektimi i prindërve - All-llahu na ruajt - .

4. Vizita e farefisit. I viziton xhaxhallarët, hallat, dajallarët dhe tezet. I viziton edhe nëse jetojnë larg. Hyn në shtëpitë e farefisit duke qenë bamirës ndaj tyre, i kënaqur me mikpritjen, dashamir i farefisit dhe i devotshëm ndaj All-llahut, subhanehu ve teala.

Pra, kush kujdeset për mbajtjen e lidhjeve farefisnore edhe All-llahu do të kujdeset për të, e kush nuk kujdeset për ato lidhje, edhe All-llahu nuk do të kujdeset për atë njeri. Kur All-llahu, subhanehu ve teala, do të kujdeset

për të, atëherë ai do të bëhet prej njerëzve më zemërmirë dhe zemërbutë. Rrallëherë mund të gjesh njeri zemërbutë, i cili nuk kujdeset për lidhjet farefisnore.

5. Dashuria e dijetarëve dhe njerëzve të mirë. Po ashtu edhe lutja për ta, qofshin të gjallë apo jo. Njeriu zemërbutë i do dijetarët, i do ndejat me ta dhe ka dëshirë të dëgjojë fjalët e tyre. I do për shkak se ulematë janë njerëz të All-llahut, njerëz që i respektojnë urdhrat e tij, njerëz të cilët i thërrasin të tjerët në praktikimin e ligjeve të All-llahut dhe mundohen t'i largojnë prej gjërave që i ka ndaluar All-llahu, subhanehu ve teala.

All-llahu i ka mbivlerësuar dijetarët ndaj njerëzve të thjeshtë, atyre ua ka besuar këtë fe, sidomos imamët e gjeneratave të para, kolosët nga koha e sahabëve, tabiinëve dhe etbau tabiinëve. Ata i përmendim vetëm për të mirë, lutemi për ta, përmendim veprat madhështore të tyre dhe flasim rreth vlerës së tyre. Ndërsa, dijetarët që i kemi gjallë, i vizitojmë, lutemi që All-llahu t'u japë të mira ashtu si lutemi për vete, e All-llahu di më së miri se çfarë është e mirë dhe e dobishme për këtë ummet.

6. Bamirësia ndaj të ngratëve. Thotë All-llahu, subhanehu ve teala: "E ai nuk bëri gjë për të kaluar udhën e rrëpirët. E ç'gjë të mësoi ty se ç'është rruga e rrëpirët? Është lirimi i një skllavi, ose dhënia e ushqimit në kohën kur mbretëron uria. Ndonjë jetimit që është i afërt, ose ndonjë të varfëri që e ka molisur varfëria. E pastaj të bëhej prej atyre që besuan, që këshilluan njëri-tjetrin për durim dhe që këshilluan për mëshirë". Shih mirë, se pas atyre ajeteve tha: "E pastaj të bëhej prej atyre që besuan, që këshilluan njëri-tjetrin për durim dhe që këshilluan për mëshirë". (Beled 11-17)

Pra, zemërbutë është ai që këshillon të tjerët për mëshirë, por, kur? Kur e kaloi udhën e rrëpirët, e cila është shumë e vështirë d.m.th. lirimi i robit. Ndërsa, ajetet: "ose dhënia e ushqimit në kohën kur mbretëron uria. Ndonjë jetimit që është i afërt, ose ndonjë të varfëri që e ka molisur varfëria", ndonjëherë është më madhështore sesa lirimi i robit, për shkak të gëzimit të madh që fut te i ngrati (i varfëri). Paramendo një vejushë muslimane e cila nëpër mbeturina publike kërkon diç për t'i veshur apo për t'i ushqyer fëmijët e saj. Në këtë moment i afrohesh dhe i dhuron diçka që ia plotëson nevojat e saj. Paramendo se çfarë gëzimi dhe mëshire do të përjetojë ajo në këto çaste.

Vallahi, prej këshillave më të mëdha që i japin dijetarët dhe që më së tepërmi u japin rëndësi është: bamirësia ndaj grave të dobëta. Andaj, dije se kur të takosh ndonjë grua muslimane të nevojshme dhe i ndihmon në largimin e asaj nevoje, dije, se porsa të largohesh prej saj, do ta ndiesh butësinë dhe devotshmërinë e zemrës në sasi që vetëm All-llahu e di!

Njerëzit janë gradë-gradë, shumë njerëz e kanë arritur lumturinë e kësaj bote dhe të tjetrës, si rezultat i lutjes së ndonjë gruaje, që e ka bërë në terrin e natës apo në dritën e ditës. Resulullahu, sal-lall-llahu alejhi ve sellem, ka thënë: "Ai që kujdeset për vejushat dhe jetimët ka shpërblimin sikurse ai që falet pandërprerë dhe agjëron pandërprerë".

Lusim All-llahun e Madh, Zotin e Arshit të madh të na bëjë zemërbutë e zemërmirë.

Lutja jonë e fundit është: falënderimi i takon Zotit të botëve, ndërsa, paqja, mëshira dhe bekimi qoftë mbi Muhammedin, familjen dhe shokët e tij.

Muhammed el-Muhtar esh-Shenkiti
Përshtati dhe përktheu: Omer Berisha

Kushtet e debatit dhe etika e tij

Para se t'i përmendim kushtet e debatit dhe adabet (etikën) e tij, së pari do të hedhim një ndriçim në lidhje me domethënien e "debatit".

Me debat nënkuptojmë diskutimin e mbështetur me fakte dhe argumente mes dy palëve të kundërta në lidhje me ndonjë çështje për të cilën ka ndonjë mospajtim, apo ndonjë ndryshueshmëri mendimi. Në debat mund të marrin pjesë edhe më shumë debatues. Debatit mund të jetë ballë për ballë, mund të jetë publik dhe jopublik. Ai mund të jetë edhe përmes shkrimeve të ndryshme, polemikave, diskutimeve, etj., por mund të jetë edhe përmes mediave dhe mund edhe të jetë drejtpërsëdrejti.

Objekt debati mund të jetë ndonjë temë e caktuar fetare ose jofetare, apo ndonjë rast, apo ndonjë ndodhi dhe të vërtetat rreth saj, apo edhe ndonjë rast politik etj.

Zakonisht me debat nënkuptohet shpalosja e të vërtetës dhe nxjerrja e saj në pah përmes argumenteve dhe fakteve bindëse, të cilat më pas e mposhtin të pavërtetën e palës tjetër, ose të pavërtetën e trilluar.

Gjithsesi këtu e kemi për qëllim shpalosjen e Hakut (të vërtetës).

Në shumë vende të Kur'anit famëlartë përmendet debati në mes peygamberëve, alejhis-selam, dhe kundërshtarëve të tyre, të cilët kanë qenë nga shtresa të ndryshme njerëzish si perandorë, mbretër, ministra, kryetarë fisesh, njerëz me besime të ndryshme, njerëz pa besim, tregtarë, fshatarë, qytetarë, etj., pra nga shtresat më të larta të njerëzve e deri tek ato më të ulëtat.

Ibrahimi, alejhis-selam, p.sh. ka pasur debate të ndryshme, të cilat na i përmend edhe Kur'anit famëlartë me popullin e tij në

lidhje me atë se kush në fakt është Zot që meriton të adhurohet, por ka pasur edhe me Nemrudin, sundimtarin e atëhershëm, i cili për vete pretendonte se ishte zot, e të cilin e mposhti Ibrahimi, alejhis-selam, me argumente.

Musai, alejhis-selam, gjithashtu, rrëfimi mbi të cilin është më i përmenduri në Kur'an, pati shumë debate me njerëz të ndryshëm, me sihibazë etj., nga të cilat më të theksuara janë debatet e tij me sundimtarin e atëhershëm, Faraonin i cili gjithashtu pretendonte për vete se ishte zot.

Edhe peygamberët e tjerë e kanë pasur të njëjtën, por gjithnjë kanë triumfuar me të vërtetën që ka qenë në krahun e tyre, sepse kanë qenë të mbështetur me argumente nga ana e Allahut, subhanehu ue teala, e në mesin e të cilëve gjithsesi është edhe peygamberi i fundit i Allahut, Muhammedi, alejhis-selam, i cili e ka pasur përkrahjen e argumenteve të fuqishme në mes të tjerash nga vetë Kur'anit famëlartë, Libri i shpallur nga Allahu, xhel-le sha'nuhu.

Të theksojmë edhe atë se mrekullitë hyjnore (mu'xhizet) kanë qenë argumentet më të fuqishme të peygamberëve. Argumente që nuk kanë pranuar kurrë mposhtjen, sepse kanë qenë drejtpërsëdrejti nga vetë Allahu, subhanehu ue teala, përmes të cilëve Allahu xhel-le sha'nuhu e ka argumentuar peygamberllëkun e të dërguarve të Tij.

Sot për të debatuar me ndokënd dhe për ta mbrojtur Hakun, (të vërtetën) të cilën e ka shpallur Allahu dhe të cilën e kanë ndjekur të parët tanë të mirë dhe në të cilën ka thirrur Peygamberi, alejhis-selam, duhet t'i kemi parasysh disa kushte, të cilat konsiderohen si kushte të debatit, në mënyrë që të jetë debati objektiv dhe i suksesshëm.

Kështu pra, Muhammed Salih el Munexhid, dijetar dhe thirrës i njohur nga Arabia Saudite, imam në një xhami të qytetit Huber, në një nga fjalimet e tij në lidhje me peshën e argumentimit në aspektin islam, i përmend disa kushte të debatimit në mënyrë që debati të jetë i suksesshëm, nga to edhe këto:

1. Nëse pretendon diçka, sill argumentin. Allahu i lartmadhëruar ka thënë: "Thuaj: silleni argumentin tuaj...";

2. Argumento vërtetësinë e asaj që thua, sepse disa njerëz ndoshta thonë (sjellin) argumente, por ato mund që të jenë të pavërteta;

3. Mos e përmend vetëm argumentin (të përgjysmuar), por sill atë të tërësishëm.

P.sh. mos e thuaj vetëm: "mos i afrohuni namazit...", por sill atë të kompletuar e që është kështu: "mos i afrohuni namazit duke qenë të dehur";

4. Haku (e vërteta) nuk njihet përmes burrave, por burrat njihen përmes Hakut.

Kështu kishte thënë në një rast Aliu, radijAllahu anhu;

5. Haku është një, nuk ndryshon dhe kështu është që nga koha e Muhammedit, alejhisselam, e deri më sot dhe deri në Ditën e Kijametit. Kjo d.m.th. se Haku (e vërteta) në mesele është një.;

6. Domosdoshmëria e paraqitjes së thënieve të njerëzve për sqarim dhe shqyrtim të hollësishëm.

P.sh. unë them, ti thua, ai ka thënë, ata kanë thënë etj., të gjitha këto janë thënie, andaj pra duhet të gjitha të nxirren në pah për analizim.;

7. Heshtja ndaj atyre gjërave për të cilat ka heshtur Allahu dhe i Dërguari i Tij.;

8. Batilit (të pavërtetës) nuk i kthehet me batil (të pavërtetë), e as bidatit nuk i kthehet me bidat por me të vërtetën.;

9. Mosdija (mosnjohja) e argumentit nuk do të thotë mosekzistimin e argumentit,

sepse gjatë debatit ndoshta nuk të kujtohet argumenti, kurse ai ekziston;

10. Për meselet (çështjet) në të cilat ka ihtilaf (mosmarëveshje), argumentimi bëhet përmes argumentit të përbashkët, në të cilin kanë prehje dhe i besojnë edhe tjerët.;

11. Argumentit të vërtetë nuk i bie dhe nuk i zvogëlohet vlera, nëse i zoti saj (pra ai që e përmend atë argument) nuk ka aftësi që ta tregojë atë si duhet dhe sa duhet.;

Në vazhdim Muhammed Salih el Munexhid i përmend edhe disa adabe që të paktën duhet të jenë tek ai musliman apo dijetar, i cili bën debat me ndokënd, dhe thotë se ai duhet të jetë i pajisur me adabe (veti të mira) nga të cilat ne përmendim këto:

1. Sinqeriteti (në debat të jetë) për Allahun e lartmadhëruar dhe jo të kemi ndonjë prapavijë tjetër siç është nënçmimi apo poshtërimi etj.;

2. Të filluarit me falënderim dhe lavdërim Allahun;

3. Ulje me edukatë në mexhlis të tillë;

4. Kthimi në Hak pasi që të bëhet me dije dhe e qartë, si rasti i Aliut, radiall-llahu anhu, që i tha atij: "...ti ia qëlllove ndërsa unë gabova";

5. Vetëpajisja me butësi dhe sabër;

6. Të folurit drejt dhe të mos gënjejmë;

7. Sjellja e butë dhe e mirë me kundërshtarit, sepse qëllimi është bindja dhe udhëzimi i tij dhe nuk është për qëllim vetëm thyerja e tij, sepse të përfitohet njeriu këtu është më me rëndësi sesa fitorja e situatës;

8. Dëgjimi i vëmendshëm i kundërshtarit dhe t'i jepet mundësia që ta kompletojë dhe përfundojë deri në fund atë që dëshiron ta thotë;

9. Drejtësia dhe paanshmëria. Pra, gjërat e vërteta që thuhet duhet që të merren nga kushdo qoftë, në mënyrë të drejtë, pa patur rëndësi se kush është ai që i thotë, pra sipas asaj që është Hak;

10. Përmirësimi i mënyrës së të menduarit dhe të shprehurit dhe kujdes të veçantë në fjalët që thuhet, shprehjet, etj., që të mos ketë fjalë dhe shprehje të ndyta dhe ofendime, etj.

11. Çështjet të cilat debatohen, nuk duhet të jenë shkak i fesadit, ndarjes dhe keqësimit të ndërmjetëm, por përkundrazi, duhet që të vazhdojmë dhe të bisedojmë me edukatë dhe sjellje të mirë.

Këto pra ishin kushtet dhe adabet që muslimani duhet t'i ketë parasysh kur të jetë në debat me ndokënd.

Kështu, të pajisur me ato që i cekëm më lart, dijetarët tanë të parë i kemi pasur të mirë (selefi salih) dhe ata që e kanë ndjekur rrugën e tyre të mirë.

Ndërsa në tri dekadat e fundit nga ata që kanë ndjekur këto parime të debatit, veçojmë luanin e pamposhtur nëpër debate publike dhe ato botërore, shejh Ahmed Didatin-Allahu e mëshiroftë, i cili debatet e tij i ka pasur kryesisht me të krishterët dhe priftërinjtë e tyre duke ua hedhur poshtë preten-

dimet e tyre false në vetë besimin e tyre në stilin e pyetjeve të shtruar sikur: «a është Bibla Libër i Zotit » etj., e që kuptohet pastaj duke ua hedhur poshtë si të pabaza duke u argumentuar nga vetë biblat e tyre të pavërteta, e në të njëjtën kohë duke i dalë në këtë rast në mbrojtje Islamit, si fe e vetme dhe e vërtetë e shpallur nga Allahu, subhanehu ue teala...

Sot për fat të keq në mesin e disa muslimanëve dhe dijetarëve por kuptohet jo tek të gjithë po vërehet se kur diskutojnë për mesele (çështje) të hapura të dinit, ata armiqësohen dhe nuk i flasin njëri-tjetrit, sa që gati sa nuk i marrin armët dhe të vriten.

Junus es SadeFi tregon dhe thotë: »Nuk kam parë njeri më të mençur se Shafiun. Një ditë kam debatuar me imam Shafiun gjatë për disa çështje që kishim ihtilaf (mospajtim), por ai më në fund më kapi mua për dore dhe më tha: o Ebu Musa, a nuk është e drejtë që të jemi vëllezër edhe pse nuk jemi pajtuar në mesele? «

...

Emin Limani

Kujto ditën e gjykimit

I
Secili njeri dhe secili besimtar ka nevojë të kujtojë ditën e gjykimit, sepse me kujtimin e ditës së gjykimit i zbutet zemra, i shtohet frika dhe i shton veprat e mira.

Në këto kohëra ku dominon materializmi edhe më shumë kemi nevojë të flasim për këto çaste dhe momente trishtuese të ditës së gjykimit, për t'u larguar nga ndikimi i botës materialiste dhe për të fisnikëruar shpirtin tonë.

Si na këshillon Kur'ani

Këshilla duhet t'i dedikohet zemrës, e cila ndryshon herë pas here, për këtë njeriu duhet të jetë i vendosur që të marrë pjesë në tubime të këshillave, sepse kështu e forcon njeriu veten e tij në rrugën e hajrit dhe e hidhëron shejtanin.

Të gjithë ne e dimë se zemrat tona janë mes dy gishtave të All-llahut dhe i ndërron si dëshiron Ai, sikurse ka ardhur në hadith të Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem.

Andaj edhe është lutur duke thënë: "All-llahu im, Ti që i ndërron zemrat e njerëzve forco zemrën time në fenë Tënde".

Pasi që Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, nuk e ka garantuar veten por është lutur që All-llahu ta përforcojë zemrën e tij në fe të Tij, kush jemi ne që të ndihemi të sigurt nga mosdevijimi, sidomos në këto kohëra kur na përplasim valët e fitnes nga të gjitha anët.

Kur'ani Fisnik është këshilluesi më i madh me të cilin duhet të këshillohen zemrat tona.

All-llahu, xhel-le shanuhu, thotë: "O ju njerëz! Juve ju erdhi nga Zoti juaj këshilla

(Kur'ani) dhe shërimi i asaj që gjendet në kraharorët tuaj (në zemra), edhe udhëzim e mëshirë për besimtarët". (Junus: 57).

Kur'ani i zbut zemrat sado që janë të ashpra, edhe nëse janë të ashpra si shkëmbi dhe guri. All-llahu, xhel-le shanuhu, thotë: "... madje ka prej tyre që nga frika ndaj Zotit rrokullisen tatëpjetë (nga maja e kodrës). All-llahu nuk është i pakujdesshëm ndaj asaj që veproni ju". (El-Bekare: 74).

All-llahu, subhanehu ve teala, thotë: "Sikur Ne ta zbritnim këtë Kur'an mbi ndonjë kodër, do ta shihje atë të struktur e të çarë prej frikës nga All-llahu. Këta janë shembuj që ua shkoqisim njerëzve, që ata të mendojnë". (El-Hashr: 21).

Ndal dhe mendo rreth këtyre ajeteve, largo shkujdesin dhe interesohu për zemrën tënde, nxito në vepra të mira para se të pendohesh.

Zemra zbutet duke e përmendur All-llahun dhe duke lexuar Kur'an, sepse kjo shkakton përulje, zbutje dhe përmirësim të tij.

All-llahu, subhanehu ve teala, thotë: "E, besimtarë të vërtetë janë vetëm ata, të të cilëve kur përmendet All-llahu u rrëqethen zemrat e tyre, të cilëve kur u lexohen ajetet e Tij u shtohet besimi, dhe që janë të mbështetur vetëm te Zoti i tyre". (El-Enfal: 2).

"... e përgëzo të dëgjueshmit. Të cilët, kur përmendet All-llahu, u dridhen zemrat e tyre, të cilët janë të durueshëm ndaj asaj që i godet, të cilët rregullisht e falin namazin dhe të cilët japin për qëllime të dobishme nga ajo me çka i furnizuar Ne". (El-Haxh: 34- 35).

"A nuk është koha që zemrat e atyre që besuan të zbuten me këshillat e All-llahut dhe me atë të vërtetën që zbriti (me Kur'an), e të mos bëhen si ata, të cilëve u është dhënë libri më parë e zgjati koha dhe zemrat e tyre u shtangën e shumë prej tyre janë jashtë rrugës". (El-Hadid: 16).

"All-llahu e shpalli të folmen më të mirë, librin, të ngjashëm në mrekulli, të përsëritur herë pas herë (me këshilla e dispozita), që prej (dëgjimit të) tij rrënoqethen lëkurët dhe zemrat e tyre. Ky (libër) është udhëzimi i All-llahut, me të udhëzon atë që do. E atë që All-llahu e lë të humbur, për të nuk ka ndonjë udhëzues". (Ez-Zumer: 23).

Mirëpo, fatkeqësisht, vetëm një pakicë e njerëzve ka marrë këshillë nga ky Kur'an, u është zbutur zemra dhe i janë përgjigjur thirrjes së All-llahut, subhanehu ve teala, siç na tregon All-llahu, xhel-le shanuhu, duke thënë: "Në të gjitha këto, për atë që ka mendje të shëndoshë dhe që i ka vënë veshin me vëmendje, ka argumente". (Kaf: 37).

Kujto momentin e vdekjes

Dije se dynjaja është e kufizuar, është e marrë në qira dhe duhet kthyer, në të ka sprovë dhe nuk mund të ikësh nga fundi dhe exheli.

Dije se varri është fitne dhe llogari, begati a dënim.

Dije se njeriu vdes ashtu si ka jetuar dhe ringjallet ashtu si ka vdekur, kurse pastaj një grup niset për në xhennet e tjetri për në xhehenem.

Parashtrohet pyetja: a je bërë gati për vdekjen?

A ke menduar ndonjë herë për vetminë e varrit?

A ke analizuar trishtimin dhe llahtarinë e ringjalljes dhe grumbullimit?

Rikujto popujt e kaluar

Qëndro te kalbësirat e varreve

Bërtit: ku është i fuqishmi mes jush

Ku është tirani, ose i dobëti dhe i shtypuri
Kishte dallime mes tyre mbi dhe

Janë barazuar tash nën dhe

Disa çaste të njerëzve në agoni të vdekjes

Mendoj se nuk prish punë të përmendim disa raste interesante të njerëzve në agoni të vdekjes, njerëz që All-llahu i forcoi ata në momentin e vdekjes dhe ua ka përfunduar ymrin me vepra të mira si shpërblim i veprave të mira që i kanë bërë sa janë gjallë.

Tregon Imam Kurtubiu, rahimehull-llah, për hoxhën e tij, Ahmed ibën Muhamed Kurtubiu, i cili duke qenë në momentin e agonisë së vdekjes, i thanë: thuaj: la ilahe il-lall-llah, kurse ai thoshte: jo, jo. Kur u kthjell, ia treguan këtë që kishte thënë, kurse ai e dha sqarimin: më erdhi një shejtan nga e djathta dhe një nga e majta. Njëri më thoshte: vdis si jehudi, se kjo fe është feja më e mirë! Tjetri më thoshte: vdis si i krishterë, sepse kjo fe është më e mirë. Unë u thosha: jo, jo. Domethënë se atyre u kam dhënë përgjigje, e jo juve.

Shejhul-Islam, Ibën Tejmijje, rahimehull-llah, në momentin e agonisë së vdekjes i lexoi ajetet kuranore: "Është e vërtetë se të devotshmit do të jenë në xhennete e në lumenj. Në një vend të kënaqshëm, te Sunduesi i plotfuqishëm (te All-llahu)". (El-Kamer: 54- 55).

Omer ibën Abdul-Azizi, rahimehull-llah, në momentin e vdekjes së tij tha: Më ulni, më ulni, e pastaj tha: Unë jam ai që më ke urdhëruar, e obligimet nuk i kam kryer, më ke ndaluar dhe nuk të kam respektuar, mirëpo la ilahe il-lall-llah, pastaj e ngriti kokën dhe e mprehu shikimin. I thanë: je duke shikuar një shikim të ashpër, o emirul-muminin? Jam duke parë disa krijesa, ata nuk janë njerëz e as xhin, e pastaj i doli shpirti dhe u dëgjua një zë duke lexuar:

"Atë vend të përjetshëm (xhennetin) ua kemi përcaktuar atyre që nuk duan as mendjemadhësi e as ngatërrësë në tokë, e

përfundim i këndshëm u takon atyre që i frikësohen All-llahut". (El-Kasas: 83).

Si të përgatitemi për vdekjen

1- largimi nga ndalesat.

Largohu nga ndalesat, lufto dhe përpigu që të ikësh nga epshet dhe dyshimet dhe dije se All-llahu është xheloz kur nëpërkëmben ndalesat e All-llahut.

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

"All-llahu është xheloz, kurse xhelozia e All-llahut shfaqet kur një njeri i vepron ndalesat e All-llahut".

All-llahu, xhel-le shanuhu, thotë:

"... prandaj, le të ruhen ata që kundërshtojnë rrugën e tij (të të dërguarit) se ata do t'i zë ndonjë telashe, ose do t'i godasë dënimin i idhët". (En-Nur: 63).

Dije, All-llahu të mëshiroftë, se ndalesat e All-llahut grumbullohen në tri kategori:

- Shirku; zullumi dhe imoraliteti.

All-llahu, subhanehu ve teala, kur i përshkruan besimtarët thotë:

"Edhe ata që pos All-llahut, nuk lusin zot tjetër dhe nuk mbysin njeriun që e ka ndaluar All-llahu, por vetëm kur e meriton në bazë të drejtësisë, dhe që nuk bëjnë kurvëri, ndërsa kush i punon këto, ai gjen ndëshkimin". (El-Furkan: 68).

All-llahu, subhanehu ve teala, tregon se çdo mëkat e fal përpos shirkut, duke thënë:

"S'ka dyshim se All-llahu nuk falë (mëkatin) t'i përshkruhet Atij shok (idhujtarinë), e përpos këtij (mëkati) i falë kujt do. Kush përshkruan All-llahut shok, ai ka trilluar një mëkat të madh". (En-Nisa: 48).

E ka ndaluar zullumin duke thënë: "...pra për zullumqarët nuk ka ndonjë ndihmëtar". (El-Haxh: 71).

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, thotë: "Kujdes nga zullumi, sepse zullumi bëhet errësirë në ditën e Kijametit. Kujdes nga

koprracia, sepse koprracia i ka shkatërruar popujt që kanë qenë para jush, i ka shtyrë të derdhin gjakun e tyre dhe të nëpërkëmbin ndalesat". (Muslimi).

All-llahu, tebareke ve teala, e ka ndaluar imoralitetin duke thënë:

"Ata që largohen prej mëkateve të mëdha dhe prej punëve të ndyta ...". (En-Nexhm: 32).

2- Kryerja e detyrave dhe obligimeve.

Nuk mund të dalë në shesh vërtetësia e islamit të një njeriu pa kryerjen e obligimeve që ia ka obliguar All-llahu, siç është namazi, zekati, agjërimi, haxhi, etj.

Këto obligime, janë të përmendura në hadithin e Abdullah ibën Omerit, radijall-llahu anhu, i cili tregon se Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

"Islami ndërtohet mbi pesë shtylla: dëshmia se nuk ka hyjni tjetër përpos All-llahut dhe se Muhammedi është rob dhe i dërguar i Tij, falja e namazit, agjërimi i ramazanit, dhënia e zekatit dhe kryerja e haxhit".

Erdhi një beduin te Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, e i tha:

"O i Dërguar i All-llahut më trego ndonjë vepër që nëse e veproj hyj në xhennet. Iu përgjigj: adhuroje All-llahun dhe Atij mos i bëj ortak, fal namaz, jep zekatin e detyrueshëm dhe agjëro ramazanin. Tha: pasha Atë në Dorë të të Cilit është shpirti im, asgjë më shumë nuk do të shtoj. E kur iku, Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, tha:

Kush dëshiron të shikojë një njeri nga banorët e xhennetit le të shikojë këtë njeri". (Buhariu).

3- Kujto vdekjen dhe llogarit veten.

Kjo vepër ta shton ambicien, të shtyn të bëhesh gati për vdekjen, vazhdimisht e kujton atë dhe e pret në çdo moment.

Sufjani, rahimehull-llah, thotë: "Ai që shumë e përmend varrin do ta gjejë si një kopsht prej kopshteve të xhennetit, kurse ai që e

neglizhon përkujtimin e varrit, i bëhet një gropë prej gropave të zjarrit".

Hatim Esami, rahimehull-llahu, thotë: "Ai që kalon pranë varreve dhe nuk mendon për vete dhe nuk lutet për ta, ai e ka tradhtuar veten dhe ata".

Për këtë Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka stimuluar në vizitë të varreve, sepse ka ndikim të madh në shpirtin e njeriut, duke thënë: "Ju pata ndaluar vizitën e varreve, kurse tani vizitoni, sepse kjo ua kujton ahiretin".

Omeri, radijall-llahu anhu, thotë: "Llogariteni veten para se t'ju llogarisin, peshoni para se t'ju peshohen, sepse më lehtë do të jetë nesër në llogari nëse jeni llogaritur sot. Stolisuni për ditën e prezantimit të madh. Atë ditë kur do të shfaqeni nuk fshihet asgjë".

4- Shtoni veprat e mira.

Kujdesu për veprat e mira vullnetare, për lutjen, dhikrin, bamirësinë, sjelljen e mirë, leximin e Kur'anit, etj.

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, thotë: "Çdo vepër e mirë konsiderohet sadaka".

"Secili prej jush ka për të folur me Zotin e vet, mes tyre nuk do të ketë ndërmjetësues. Do të shikojë në të djathtë dhe vetëm veprat e tij do të shohë. Do të shikojë në të majtë dhe vetëm veprat e tij do të shohë. Do të shikojë para vetes dhe vetëm zjarrin do të shohë. Kini frikë All-llahut, në mos më shumë me një gjysmë hurme, e kush nuk gjen as këtë, së paku me një fjalë të mirë".

Kur ishte Ebu Bekri, radijall-llahu anhu, në agoninë e vdekjes e thirri Omerin, radijall-llahu anhu, e i tha: "Omer, ki frikë All-llahun dhe dije se All-llahu ka caktuar vepra gjatë ditës që nuk i pranon gjatë natës dhe ka caktuar vepra gjatë natës të cilat nuk i pranon gjatë ditës. All-llahu nuk i pranon veprat vullnetare derisa nuk kryhen obligimet. I rëndohet peshoja atij që e ka pasuar të vërtetën në

dynja edhe pse i ka ardhur rëndë. Një peshojë në të cilën vendohet për peshim e vërteta duhet të jetë e rëndë".

...

Dita e gjykimit

Njerëzit gjatë kësaj jete janë neglizhent, kanë shpresa shumë të mëdha, andaj kemi nevojë të përkujtohemi dhe të këshillohemi për fundin tonë, me qëllim të ndërtimit të ahiretit me punët e mira që i bëjmë në këtë dynja, ta fitojmë ardhmërinë duke e shfrytëzuar kohën e tashme.

All-llahu, subhanehu ve teala, besimin e paluhatshtëm në ahiret e ka bërë një shtyllë prej shtyllave të besimit, andaj të gjithë ne duhet të jemi të bindur se do të vijë dita kur çdo krijesë do të vdesë, asgjë nuk do të mbetet, përveç madhërisë së All-llahut, subhanehu ve teala.

All-llahu, xhel-le shanuhu, thotë: "Çdo gjë që është në të (në tokë) është zhdukur. E do të mbetet vetëm Zoti yt që është i madhëruar e i nderuar!". (Er-Rahman: 26- 27).

Pas këtij shkatërrimi dhe zhdukjeje të çdo krijese, All-llahu i rikthen njerëzit dhe i ringjall ata nga varri, kurse i pari që ringjallet është pejgamberi ynë, Muhammedi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem.

Njerëzit ringjallen të zhveshur, të zbathur dhe të pasyretuar:

"...Ashtu sikundër e kemi filluar krijimin (tuaj), e rikthejmë. ...". (El-Enbija: 104).

All-llahu, xhel-le shanuhu, këtë ditë e ka përshkruar si ditë të rëndë dhe të vështirë, ditë kur fëmija thinjet, nëna e braktis foshnjën e saj dhe e hedh nga gjiri, shtatzëna e dësh-ton fëmijën, njerëzit sillen sikur të jenë të dehur edhe pse nuk janë të dehur, shikimet përqendrohen në një vend dhe nuk lëvizin, zemrat u ngrihen deri në gabzherr, askush nuk flet, të gjithë heshtin, njeriu ikën nga më të dashurit e vet, nga nëna, babai, vëllai, gruaja,

fëmijët, madje mëkatori dëshiron të shpëtojë veten duke flijuar më të shtrenjtit që i ka: "Edhe pse ata shihen ndërmjet vete (edhe njihen, por ikin prej njëri-tjetrit). Krimineli dëshiron sikur të kishte paguar dënimin e asaj dite me bijtë e vet. Dhe me gruan e vet dhe me vëllain e vet. Edhe me të afërmit e tij që ai te ata mbështetet. Edhe me krejt çka ka në tokë, e vetëm të kishte shpëtuar!". (El-Meairixh: 11- 14).

Dridhet toka, goditet me një goditje të vështirë, lëvizin kodrat, çahen, shndërrohen dhe bëhen sikur leshi, rrafshohen kodrat, shpërthejnë dhe ndizen detet, çahet qielli, bëhet i dobët dhe e ndryshon ngjyrën.

"E kur të çahet qielli e bëhet kuq si vaji i shkrirë". (Er-Rahman: 37).

Hasan Basriu, rahimehull-llah, tregon se qielli bëhet me dyer, nuk mbulon dhe nuk fsheh asgjë.

Zoti ynë e palos me Dorën e tij të majtë ashtu sikur paloset libri, e kap me një gisht, errësohet dielli, i largohet shkëlqimi, kurse hëna humbet krejtësisht.

"E, kur të merren sytë (të parët)? E të zëhet hëna (errësohet), Dhe të bashkohen dielli e hëna. Atë ditë njeriu do të thotë: "Nga të iket!" Jo, nuk ka strehim! Atë ditë vetëm te Zoti yt është cakul ". (El-Kijame: 7- 12).

All-llahu, subhanehu ve teala, në suren Tekvir, shikoni në fillimin e saj se sa interesant e përshkruan këtë ditë të trishtueshme: "Kur dielli të jetë mbështjellur (dhe errësohet), Dhe kur yjet të kenë rënë (e shkapërderdhur), Dhe kur kodrat të kenë udhëtuar (e bërë pluhur në ajër), Dhe kur devetë e shtrenjta të lihen pa bari në fushë, Dhe kur egërsirat të jenë bashkuar (tubuar). Dhe kur detet të vlojnë si zjarr i flakëruar, Dhe kur shpirtrat të jenë bashkuar. Dhe kur të pyeten ato vajza të varrosura të gjalla, Për çfarë mëkati ato janë mbytur, Dhe kur fletushkat të jenë shpaluar,

Dhe kur qielli të jetë hequr, Dhe kur xhehennemi të jetë ndezur fort, Dhe kur xhenneti të jetë afruar, Atëbotë njeriu do ta dijë se çka ka ofruar (të mirë ose të keqe)". (Et-Tekvir: 1- 14).

Yjet që shndrisin e humbin shkëlqimin e tyre, këputet peri i cili i lidhte ato dhe krijonte nga radhitja e tyre një bukuri të veçantë, errësohet toka, ikën drita, njerëzit përzihen mes vetes, melaqet i rendisin njerëzit, e Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, thotë: "All-llahu im kërkoi strehim te Ti nga ngushtica e qëndrimit në Ditën e Kijametit". (sahih, Nesaiu).

Në këtë ditë secili shpirt kupton atë që ka sjellë me vete. Në këtë ditë njeriu pendohet, mirëpo është bërë vonë, sepse ka kaluar koha e pendimit. Në këtë ditë del në shesh ajo që ka qëndruar në gjoksin e tij, shfaqen të gjitha sekretet. Heshtje e madhe, nuk flet askush dhe nuk ka hapësirë për arsyetim.

"Kjo është një ditë që ata nuk flasin. Atyre as nuk u lejohet që të arsyetohen". (El-Mur-selat: 35- 36).

Gjendja e besimtarëve dhe njerëzve të devotshëm

Njerëzit në këtë ditë ndahen në dy grupe kryesore. Njerëz me fytyra të buzëqeshura, të shndritshme dhe të gëzuara dhe njerëz me fytyra të nxira, të rraskapitura dhe të pluhurosura. Të devotshmit ringjallen dhe shkojnë te Zoti i tyre grupe-grupe, kurse kriminelët rresh-tohen duke pritur vendimin e All-llahut. dielli u afrohet njerëzve mbi kokë sa një milje largësi, nuk ka hije tjetër përveç hijes së All-llahut, subhanehu ve teala. Në këtë tollovi dhe kallaballëk të madh njerëzit shtyhen dhe përzihen mes vetes, kurse nga shkaku i diellit u dalin djersët dhe bëhet liqe, i cili disave u arrin deri në nyje të këmbës, e disave deri në gjunjë, disave deri në mes, e disave deri në fyt. Në këtë gjendje njerëzit i kaplon një pikëllim i

madh, u ngushtohet shpirti, gjunjëzohen nga trishtimi dhe llahtaria e madhe.

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, thotë: "Arrijnë njerëzit një gradë të lartë të brengës dhe pikëllimit saqë nuk mund ta durojnë". (Buhariu dhe Muslimi).

Mirëpo ai që një muslimani ia largon një brengë, All-llahu, xhel-le shanuhu, ia largon një brengë të ahiretit, ai që muslimani ia lehtëson një vështirësi, All-llahu, tebareke ve teala, ia lehtëson një vështirësi të dynjasë dhe ahiretit dhe ai që një muslimani ia mbulon një të metë, All-llahu, subhanehu ve teala, ia mbulon një të metë në dynja dhe ahiret. Njerëzit e drejtë do të ulen në kolltukë prej drite. Secili njeri do të ringjallet ashtu sikur ka vdekur, andaj ai që vdes duke thënë telbijen (lebejke All-llahumme lebejke) do të ringjallet në atë gjendje, ai që vritet në rrugë të All-llahut, në Ditën e Kijametit do të vijë me plagë që do të nxjerrë gjak, ngjyra e gjakut, kurse aroma e miskut. Muezinët do të kenë qafën më të gjatë në Ditën e Kijametit, sepse çdo gjë që dëgjon zërin e tij do të dëshmojë për të në Ditën e Kijametit. Ai që thinjet në Islam, ajo thinjë do të shndërrohet në dritë në Ditën e Kijametit dhe secili njeri do të jetë nën hijen e sadakasë së tij derisa të gjykohet mes njerëzve.

Gjendja e mëkatarëve dhe mosbesimtarëve

Në këtë ditë do t'u vijë shumë keq mëkatarëve që pse i kanë lënë pas dore adhurimet dhe nga kjo keqardhje do të kafshojnë duart e tyre.

All-llahu, azze ve xhel-le, na tregon këtë duke thënë: "Atë ditë zullumqari do t'i kafshojë duart e veta dhe do të thotë: "I mjeri unë, ta kisha marrë rrugën e Pejgamberit!". (El-Furkan: 27).

Në këtë ditë mëkatarit do të urrejë edhe vetveten, miqtë dhe dashamirët e tij, secila dashuri e cila nuk është bërë në bazë të fesë shndërrohet në armiçësi, madje njeriu do të

armiçësohet me gjymtyrët e veta. Mendjemë-dhenjtë do të ringjallen si grimca, do t'i shkelin njerëzit me këmbët e tyre për t'i nënçmuar. Njeriut që i lëshon rrobat zvarrë për toke nga mendjemadhësia, All-llahu nuk i flet dhe as që e shikon në këtë Ditë, nuk e pastron dhe do të ketë dënim të dhembshëm. Secilit mashtrues do ti vendohet një flamur në prapnicën e tij ku do të shënohet: ky është mashtrimi - tradhtia e filanit. Ai që merr ndonjë tokë pa të drejtë, kjo tokë do ta lëshojë në Ditën e Kijametit dhe do të zhytet në shtatë katet e tokës. Zullumi i dynjasë do të shtohet në Ditën e Kijametit, sepse zullumi bëhet errësirë në ditën e Kijametit, të drejtat nuk humben, por mazllumi do të marrë hakun e tij nga zullumqari, madje edhe kafshët mes tyre do të marrin hakun e njëri-tjetrit. Njeriu më i keq në këtë ditë është dyfytirësi, i cili disave ju flet ndryshe e disa të tjerëve ndryshe. Ura e Siratit është rrëshqitëse, dikush shpëton e dikush lëndohet dhe bie në zjarr. Peshoja është e drejtë, nuk ka hile në të, kurse llogaria bëhet me njësi matëse atomike.

All-llahu, azze ve xhel-le, thotë: "E kush punoi ndonjë të mirë, që peshon sa grimca, atë do ta gjejë. Dhe kush punoi ndonjë të keqe, që peshon sa grimca, atë do ta gjejë". (Zelzele: 7-8).

Fjala El-hamdulillah e mbush këtë peshojë, kurse fjala Subhanall-llahi ve Bihamdihni e rëndojnë këtë peshojë.

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, thotë: "Gjëja më e rëndë në Peshojë është devotshmëria dhe morali i mirë". (Tirmidhiu, hasen).

Librat e palosura do të shpërndahen, sa e sa bela që i ke harruar dhe sa e sa gabime që i ke fshehur do të shfaqen, do të lexohet Libri (regjistri), gjymtyrët do të flasin, melaqet do të dëshmojnë, kurse All-llahu është Dëshmitari i të gjitha veprave të njeriut.

All-llahu, xhel-le shanuhu, thotë: "Ti nuk angazhohesh me asnjë çështje, nuk lexon nga ai pjesë nga Kur'ani dhe nuk bëni ndonjë vepër, vetëm se ne jemi prezentuesit tuaj, kur ju ndërmerrni atë. Zotit tënd nuk mund t'i fshihet as në tokë e as në qiell as sa grimca e as më e vogël se ajo e as më e madhe, por vetëm sa është evidentuar në librin e sigurt". (Junus: 61).

Pasi që All-llahu të gjykojë mes kafshëve, fillon gjykimin mes njerëzve. Të parët që do të gjykojnë në këtë Ditë është ky umet, këta do të jenë të parët që do ta kalojnë urën e Siratit dhe të parët që do të hyjnë në xhennet.

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, thotë: "Ne jemi të fundit dhe të parët në Ditën e Kijametit". Në transmetimin tjetër qëndron: "Gjykojnë para krijesave të tjera". (Muslimi).

All-llahu, xhel-le shanuhu, e nderon robin e Tij, Muhammedin, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, në këtë moment duke i dhënë Pishinin (Haudin) e madh, i gjerë sa mund të ecë një njeri për një muaj, uji i tij më i bardhë se qumështi dhe më i ëmbël së mjalti, kurse aroma më e mirë se e miskut, përreth i sheh gastaret nga ari dhe argjendi sa yjet e qiellit, ai që pi nga ky ujë nuk do të ketë etje asnjëherë më vonë, kurse disa njerëz do të refuzohen, e Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, do të thotë: "Ata janë të mi". Do t'i thuhet: Nuk e di se çka kanë shpikur pas teje. Atëherë do të thotë: "Mallkimi qoftë për ata që kanë ndryshuar pas meje". (Ahmedi, sahih).

Shpëtimi nga kjo Ditë

Shpëtimi nga këto trishtime arrihet me mëshirën e All-llahut, e pastaj me vepra të mira. Njeriu që nuk ka bërë mjaft vepra të mira do të vijë i penduar në këtë Ditë, mirëpo në këtë Ditë nuk bën dobi arsyetimi dhe nuk shpresohet falja.

All-llahu, subhanehu ue teal, thotë: "O ju njerëz, s'ka dyshim se premtimi i All-llahut është

të i vërtetë, pra të mos u mashtroni juve jeta e kësaj bote dhe të mos u mashtroni juve ndaj All-llahut ai i mashtruar (shejtani)". (Fatir: 5).

I falimentuari në Ditën e Kijametit

I falimentuar në këtë Ditë është ai që vjen me namaz, agjërim, zekat, mirëpo ndërkohë ka akuzuar njeri, ka ofenduar njeri, ka ngrënë pasurinë e dikujt, ka derdhur gjakun e dikujt, e ka rrahur dikë, andaj duhet t'i japë secilit prej tyre nga të mirat e veta derisa t'i harxhojë të gjitha veprat e mira, atëherë do t'i marrë mëkatet e tyre dhe pastaj do të hidhet në zjarr.

Salih El-Merri thotë: "Hyra në varre në mesdite, i shikova varret dhe mu dukën si njerëz të heshtur dhe thashë: subhanall-llah, kush ju ringjall pasi që të qëndroni gjatë kohë në këtë vend? Doli një zë nga ato gropa duke më thënë: Salih: "Nga argumentet e Tij është që me fuqinë e Tij bëri të qëndrojë (pa shtyllë) qielli e Toka, mandej kur t'ju thërret juve me një të thirrme prej tokës, ju menjëherë dilni". (Er-Rum: 25). Tha: rashë i alivanosur".

Hasan Basriu, rahimehull-llah, thotë: "As-kush nga njerëzit nuk ka dëgjuar për dy ditë dhe dy net: nata kur do të buajsh me banorët e varreve e asnjëherë më parë nuk ke bujtur me ta dhe nata, pas së cilës vjen dita e Kijametit dhe Dita kur të vjen lajmëtari nga All-llahu, i cili të sjell lajmin ose për xhennet ose për në zjarr dhe Dita kur të jepet Libri yt, të cilin e merr ose me dorën e djathtë ose me dorën e majtë".

Kur të ndizet xhehenemi

All-llahu, subhanehu ue teal, e ka krijuar zjarrin dhe e ka bërë vendbanim të atyre që i kundërshtojnë urdhrat e Tij dhe tregohen mendjemëdhenj.

Pra, cili është ky zjarr dhe cilat janë vetitë e këtij zjarri?

All-llahu, subhanehu ue teal, tregon për lëndën e zjarrit duke thënë: "O ju që besuat, ruajeni veten dhe familjen tuaj prej një zjarri,

lëndë djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët. Atë (zjarrin) e mbikëqyrin engjëjt e rreptë e të ashpër që nuk e kundërshtojnë All-llahun për asgjë që Ai i urdhëron dhe punojnë atë që janë të urdhëruar". (Et-Tahrim: 6).

"Zjarri juaj, të cilin e ndez njeriu, është një pjesë e shtatëdhjetë pjesëve të zjarrit të xhehenemit". I thanë: pasha All-llahun do të mjaftojë kjo. Tha: Zjarri i xhehenemit është për gjashtëdhjetë e nëntë herë më i nxehtë se ky zjarr". (Buhariu dhe Muslimi).

Gjithashtu Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem, duke treguar se xhehenemi është një krijesë gjigande thotë: "Do të sjellin xhehenemin të lidhur me shtatëdhjetë mijë frerë, secilin fre do ta kapin shtatëdhjetë mijë melekë dhe do ta tërheqin". (Muslimi).

Kab El-Ahbari, rahimehull-llah, duke treguar për zjarrin e xhehenemit tregon e thotë: "Pasha Atë që në Dorë të Tij është shpirti i Kabit, po të ishe në lindje kurse zjarri në perëndim e të zbulohet, do të dilte truri nga hunda prej nxehtësisë së madhe që ka! O njerëz, a mund të qëndroni karshi kësaj nxehtësie, a mund ta duroni këtë gjë? O njerëz, respekti ndaj All-llahut është më i lehtë se ky dënim, andaj respektojeni".

Ushqimi i banorëve të xhehenemit është zekumi, kurse pija e tyre, lëngu i nxehtë.

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem, thotë: "Po që se një pikë nga zekumi bie në dynja, do t'ua prishte jetën njerëzve, e çfarë të themi për ata që këtë e kanë ushqim të tyre?". (sahih, Tirmidhiu).

"Është e vërtetë se pema e Zekumit, do të jetë ushqim i mëkatarëve. Vlon si katrani (si pezhgveja) në barqet, ashtu si vlon uji i valë". (Ed-Duhan: 43- 45).

Banorët e zjarrit vazhdimisht do të jenë në dënim, nuk kanë qetësi dhe as gjumë, nuk kanë rehati e as pushim, por prej dënimit në dënim.

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem, na tregon se sa i dhembshëm është dënimi më i vogël në xhehenem duke thënë: "Njeriu me dënimin më të lehtë është ai që do të ketë nallane prej zjarri, nga të cilat do t'i vlojë truri, ashtu sikurse vlon uji në kazan. Njerëzit do të mendojnë se ky vuan dënimin më të madh, kurse ky do të jetë dënimi më i lehtë". (Muslimi).

Nga këto vuajtje dhe dhimbje ata do të shpresojnë vdekjen, mirëpo aty vdekje nuk ka, do t'u nxihen fytyrat, do t'u verbohen sytë, do t'u mbyllet goja, do t'u thyhet kurrizi dhe do t'u grimcohen eshtrat: "Ndërkaq, kriminelët janë në vuajtje të përgjeshme të xhehenemit. Atyre as nuk u lehtësohet (vuajtja) dhe aty janë të dëshpëruar. Ne nuk u bëmë atyre padrejtësi, por ata vetë kanë qenë horra. Dhe ata thërrasin: "O Malik, le të na e marrë shpirtin Zoti yt!". Ai thotë: "Ju do të jeni aty përgjithmonë!". (Ez-Zuhruf: 74- 77).

"Ata përpiqen të dalin nga zjarri, por s'kanë të dalë nga ai, ata kanë dënim të përherëshëm". (El-Maide: 37).

"Është e vërtetë se ata që mohuan argumentet Tona, do t'i hudhim në zjarr. Sa herë që u digjen lëkurat e tyre, Ne ndërrojmë lëkura të tjera që të shijojnë dënimin. All-llahu është i plotëfuqishëm, i drejtë".

Hasan Basriu, rahimehull-llah, thotë: "U digjet lëkura gjatë ditës shtatëdhjetë mijë herë".

Veshmbathja e banorëve të xhehenemit është prej katrani, kurse ushqimi nga zjarri.

All-llahu, xhel-le shanuhu, thotë: "Petkat e tyre janë nga katrani (pezhgveja - zifti), kurse fytyrat e tyre do t'i mbulojë zjarri". (Ibrahim: 50).

"... u shuhet etja me ujë të valë që ua copëton zorrët e tyre". (Muhamed: 15).

Krahaso gjendjen e këtyre njerëzve të pafat, të cilët rrotullohen në lloj-lloj dënimesh, vuajnë në xhehenem aq shumë, saqë edhe kodrat nuk mund t'i durojnë dot këto vuajtje, tregime që na e shkatërrojnë zemrën.

Të lidhur në pranga dhe me zinxhir:

"Atyre do t'u vihen prangat dhe zinxhirët në qafat e tyre e do të zhyten". (Gafir: 71).

"Mandej lidheni atë me një zinxhirë të gjatë shtatëdhjetë kutë". (El-Haka: 32).

Ibën Abasi, radijall-llahu anhu, thotë: "Prangat dhe zinxhiri i vendohet në prapanicë dhe i del në hundë. Nuk mundet të ngrihet në këmbë dhe renditen në këtë zinxhir, ashtu sikurse renditen karkalecat në krënde derisa të piqen".

Vëllai im i dashur, shiko këtë gjendje të vështirë në të cilën gjenden këta fatzinj, paramendo veten tënde në vend të tyre. E lusim All-llahun që të mos jetë asnjë prej nesh në vendin e tyre, paramendo veten sikur të hedhin në zjarr, kur vjen para urës së siratit dhe e shikon se është më e hollë se qimja dhe më e mprehtë se shpata. I sheh njerëzit duke rrëshqitur nga kjo urë dhe duke rënë në zjarr, i sheh ata që janë para teje dhe trishtohesh, mirëpo ky trishtim nuk është asgjë në krahasim me rrëshqitjen e këmbëve të tua. Kjo llah-tari të shtohet edhe më shumë kur të depërtojnë kthetrat e ndryshme në lëkurën dhe mishin tënd dhe të hedhin në zjarr, kurse zjarri me shpejtësinë e vet, të kaplon dhe të djeg. Në këto çaste kur digjesh, të shkrihet lëkura dhe mishi, të thyhen eshtrat, ti thërret, mirëpo askush nuk të mëshiron, në këto momente dëshiron të kthehesh prapë që të pendohesh, mirëpo askush nuk të përgjigjet!

Paramendo veten pas një qëndrimi të gjatë në xhehenem, pasi që të arrijë pikëllimi kulmin e vet, atëherë kur etja nuk durohet, të kujtohet pija në dynja, nxiton drejt Hamimit, e merr një gotë nga Hazini, i cili është përgjegjës për dënimin tënd, e kur e merr këtë gotë, të shkrihet dora nga nxehtësia e kësaj gotë, kur ta afrosh te goja jote, të shkrihet goja nga nxehtësia, kurse kur ta gëlltitësh këtë lëng, ta shkatërron fytyrën dhe kur depërton në bark, ti copëton zorrët copë-copë, atëherë do të bër-

tasësh, do të ankohesh, do të kujtohet uji i ftohtë i dynjasë dhe kënaqësia e tij dhe do të ndjesh keqardhje. Sërish do të ndjesh dhimbje dhe do të nxitosh drejt pishinës përplot me Hamim që të freskohesh, ashtu siç freskohet njeriu në dynja, duke pirë dhe duke u zhytur në të, e kur të zhytesh në hamim të zhvishet mishi nga lëkura, prej kokës deri në këmbë, atëherë do të nisesh drejt zjarrit me shpresë se ai do të jetë më pak i nxehtë, mirëpo do të gjesh të kundërtën. Kur të digjesh me zjarrin e xhehenemit, do të kthehesh sërish në hamim, kështu do të rrotullohesh mes hamimit dhe zjarrit, ashtu sikurse na e tregon këtë All-llahu, subhanehu ue teala, duke thënë:

"Ata do të sillen vërdallë ndërmjet atij (zjarrit) dhe ujit të vluar deri në kulminacion". (Er-Rahman: 44).

Do të kërkojë rehati mes zjarrit dhe hamimit, mirëpo nuk do të gjejë as rehati dhe as qetësi.

Kur të shtohet pikëllimi dhe etja, e të arrije grada shumë të larta, të kujtohet xheneti. Një copë e zemrës tënde ta zë frymën nga keqardhja që pse nuk je afër All-llahut dhe nga mërzia për begatitë e xhenetit, të cilin e ke humbur për shkak të mëkateve dhe gabimeve që i ke bërë, atëherë do të drejtohesh nga All-llahu duke bërë titur që të të kthejë në dynja dhe të bësh punë të mira, mirëpo askush nuk të përgjigjet një kohë të gjatë, e pastaj të thuhet:

"Ai thotë: "Heshtni aty e mos më folni!" (El-Muminun: 108).

Pastaj All-llahu, tebareke ue teala, ta shton dëshpërimin dhe keqardhjen duke ta mbyllur derën e xhehenemit. Nuk ka dëshpërim dhe keqardhje më të madhe, sesa kur dëgjon kërcëllimin e mbylljes së dyerve të xhehenemit, sepse tani e kuptojnë se All-llahu e ka mbyllur këtë derë dhe se askush nuk ka për të dalë nga ky vend. Këtyre njerëzve u copëtohet zemra copë-copë, u humbet shpresa tërësi-

sht për shpëtim nga ky vend dhe nga dënimi i All-llahut. Këtu e kupton atë që na ka treguar Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem: "përhershmeri, nuk ka vdekje".

Dënim, i cili nuk largohet nga trupi i tyre, merzi që nuk përfundojnë, sëmundje që nuk shërohen, pranga që nuk zgjidhen, zinxhirë që nuk hiqen asnjëherë, etje që nuk kalon asnjëherë, nuk mëshirohen edhe nëse qajnë, lutjeve të tyre nuk u përgjigjet askush, pendimi i tyre nuk pranohet, gjenden në dënim të përhershëm dhe nënçmim të papërfunduar. Pastaj All-llahu, azze ue xhel-le, i dërgon me laqet që t'ua mbyllin çdo vrimë, që ti gozhdonë me gozhdën të zjarrit dhe t'i lidhin në shtylla të zjarrit. Në vendin ku gjinden ata, nuk lihet të hyjë as erë e as frymë dhe All-llahu i le në hareshë tërësisht.

Paramendoni të gjendeni në një vend të mbyllur nga të gjitha anët dhe të harruar se ka dikush atje. A ka gjendje më të keqe se kjo?!

"Harruan All-llahun, prandaj Ai i harroi". (Et-Teube: 67).

"Ai i mbyll ata, ua zë frymën. Ata janë të lidhur në pranga të njëpasnjëshme". (El-Humeze: 8-9).

E thërrasin dhe e lusin All-llahun që t'ua lehtësojë dënimin, pas një kohe u vjen përgjigja: "Ai thotë: "Heshtni aty e mos më folni!" (El-Muminun: 108).

Hasan Basriu, rahimehull-llah, thotë: "Këto janë fjalët e fundit që i thonë, e pas kësaj do të lëshojnë vetëm piskamë, britmë dhe lehje sikur të qenve".

Nuk ka jetë më të keqe se kjo dhe nuk ka njerëz më të këqij se këta, e lusim All-llahun që të mos jemi prej tyre. Humbje e madhe, e cila nuk mund të kompensohet në asnjë mënyrë. Pasha All-llahun, vaj për mendjet që dëgjojnë për këtë dënim dhe këtë vuajtje dhe i besojnë tërë kësaj, mirëpo nuk e përfillin aspak dhe nuk ikin nga kjo, por veprojnë drejt

saj me dëshirë dhe zgjidhje. La haulë ue la kuvvete il-la bil-lah.

Vëllai im i dashur, ti që bën mëkate ndaj All-llahut, paramendoje veten si banor të xhehenemit! A do të dakordohesh me këto dënime dhe vuajtje?

Nuk e besoj një gjë të tillë. Andaj pendohu te All-llahu, largohu nga gjërat që i urren Ai dhe afroju Atij me vepra të mira me shpresë se do të jetë i kënaqur me ty, qaj nga frika prej Tij me shpresë se do të mëshirojë gabimet e tua. Dije se rreziku është shumë i madh, trupi është shumë i dobët, vdekjen e ke afër, All-llahu, xhel-le xhelaluhu, të mbikëqyr dhe të sheh, andaj turpërohu prej Tij dhe mos e neglizho shikimin e Tij ndaj teje, mos nënçmo mëkatet që i bën ndaj Tij, mos shiko vogëlsinë e mëkatit por shiko madhësinë e Atij ndaj të cilit e bën mëkatin, e Ai është All-llahu, tebareke ue teala.

Mbushe zemrën tënde me frikë ndaj Tij para se të të merret shpirti në befasi. Mos iu shfaq Atij me mëkate, sepse nuk mund të durosh Hidhërimin e Tij dhe nuk mund t'i rezistosh dënimit të Tij. Kontrolllo veten para se të vijë dita e takimit me Të, ndoshta të mëshiron dhe t'i fal gabimet.

Një dritare drejt Xhenetit

Vëllai im i dashur, po të shkruaj për xhenetin, shtëpinë e begative, e cila është një shpresë shumë e shtrenjtë e secilit besimtar, me qëllim që të mendosh pak më gjatë për begatitë dhe gëzimet që gjenden në këtë vend, që të shtohet ëndërimi edhe më shumë për këtë shtëpi, sepse ai që e shpreson një gjë dhe e ëndërron atë, do ta kërkojë dhe do të punojë për të. Nuk kam për qëllim shpresat e kota, shpresat e atyre që zhyten në mëkate, shpresat e atyre që nuk pendohen, sepse kjo nuk është shpresë por është mburra-vecllek dhe i ngjan atij që hedh farën në tokë jopjellore, ose atij që pret fryte të xhenetit me fara të xhehenemit, ose atij që mbjell

mëkate dhe dëshiron të korrë shpërblime në Ditën e Gjykimit.

Shpresë e lavdëruar është ajo shpresë, e cila të shtyn të punosh, sepse All-llahu, tebareke ue teala, pasi që i tregon cilësitë e besimtarëve, tregon se ata janë që shpresojnë:

"Ata të cilët besuan, ata që u shpërngulën dhe luftuan në rrugën e All-llahut, ata meritojnë të shpresojnë në mëshirën e Tij. All-llahu falë shumë dhe është mëshirues". (El-Bekare: 218).

A ka vend për shpresë ai që e le namazin dhe zhytet në harame dhe kur ti thuash: kujdes se çfarë vepron, ai të përgjigjet duke thënë: All-llahu fal dhe është i Mëshirshëm! Këtij i përgjigjemi duke i thënë: a nuk ke lexuar ajetin Kur'anor ku All-llahu, subhanehu ue teala, na tregon se: "Nuk ka dyshim se Unë e fal atë që është penduar, që ka besuar, që ka bërë vepra të mira dhe që përqendrohet për në rrugën e drejtë". (Taha: 82).

Ku është në këtë rast pendimi dhe puna e mirë?!

Vëlla i dashur, dije se dynjaja është ara e ahiretit, po edhe zemra është si toka, kurse besimi është si fara, adhurimet e shtojnë e mëkatet e pakësojnë. Dita e Gjykimit është dita e korrjes, andaj ai që ka mbjellë mirësi, do të korrë mirësi dhe ai që ka mbjellë sherr, do të korrë sherr.

Kur e kanë pyetur Zjedin: Si gdhive? Ka thënë: gdhiva duke e dashur të mirën dhe njerëzit e mirë dhe çdo gjë të mirë që kam mundësi ta bëj, nxitoj ta bëj dhe jam i bindur në shpërblimin e saj, e nëse më ikën ndonjë vepër e mirë mërzitem dhe mallëngjehem për të.

Qëllimi është të tregojmë se ai që mendon më gjatë për xhennetin, gëzimin në të dhe begatitë që i ka përgatitur All-llahu për banorët e xhennetit, kjo e shtyn në punë të mira.

Habi është me punën e atij që beson në Ditën e Gjykimit dhe në Shtëpinë e jetës së vër-

tetë, ku nuk ka vdekje, as sëmundje e as fatkeqësi, dhe nuk e kërkon këtë vend!

Pasha All-llahun, sikur të mos kishte këtu asgjë tjetër përpos se shëndet në trup, siguri nga vdekja, uria dhe etja do të mjaftonte si shkak që të braktiset dynjaja për të. Si duhet të jetë gjendja jonë kur e dimë se banorët e xhennetit do të jenë mbretër të sigurt, kënaqen në gëzime dhe lumturi, kanë atë që ua ka ëndja dhe ua pëlqen syri, atje do të mbeten përgjithmonë, vazhdimisht duke u rrotulluar në llojet e ndryshme të begative dhe janë të bindur se këto mirësi kurë nuk përfundojnë?

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem, thotë: "Do të thërrasë një thirrës i banorëve të xhennetit: këtu do të jeni të shëndoshë dhe nuk do të sëmureni, do të jetoni dhe nuk do të vdisni, do të jeni të rinj dhe nuk do të plakeni dhe do të jetoni në begati dhe nuk do të vuani aspak". (Muslimi).

Begati të kulluar vetëm në xhennet mund të gjejmë.

Kurse në dynja sado që të kënaqemi, ajo ka vështirësitë e veta, sado që të qeshim edhe do të qajmë, sado që do të gëzohemi edhe do të mërzitemi, dhimbjet janë më shumë se kënaqësitë, fillimi i begative është frikë, kurse fundi harresë.

Kurse begatitë e xhennetit nuk mund të vlerësohen dhe as që mund të fantazohen.

Si ka mundësi të vlerësohen kur All-llahu i ka mbjellë me Dorën e Tij dhe e ka vërë vendbanim të njerëz të dashur te Ai, e ka mbushur me Mëshirë, Nderim dhe Kënaqësi të Tij. Begatinë e saj e ka përshkruar si fitore të madhe, kurse mbretërinë e saj me mbretëri të madhe. Në të ka deponuar të gjitha mirësitë dhe ka pastruar nga çdo mangësi dhe defekt. All-llahu, azze ue xhel-le, na ka treguar në Librin e Tij Fisnik gjërat që i ka përgatitur për robërit e Tij në Xhennetet e ndryshme; lloj-lloj ushqimesh, martesë, vendbanime, veshm-

bathe, qumësht, mjaltë, verë, ujë, mish, mëndafsh, ar, pemë, hurije, lumenj, pallate, etj. Begatitë e dynjasë nuk kanë asgjë të përbashkët me begatitë e ahiret përpos ngjashmëri në emra, sepse të gjitha lajmet që na tregojnë për gjërat e përgatitura në xhennet, afër Zotit të botëve, është në kundërshtim me atë që është në këtë dynja edhe cilësi edhe në formë. Pra, pajtohen në emra, mirëpo dallojnë në realitet, shije dhe aromë.

All-llahu, xhel-le shanuhu, atyre që e respektojnë u ka garantuar në xhennet atë që syri nuk e ka parë, veshi nuk e ka dëgjuar dhe as që i ka rënë ndërmend ndonjërit. Këto gjëra nuk i di as ndonjë pejgamber i dërguar e as ndonjë melek i afruar.

All-llahu, azze ue xhel-le, thotë: "Pra, për ata që kanë vepruar, nuk di askush për atë kënaqësi (të zemrës e shpirtit) që u është caktuar atyre si shpërblim". (Es-Sexhde: 17).

Imam Mundhiri, rahimehull-llah, thotë:

"Xhenneti dhe banorët e xhennetit janë shumë më lart se kjo që përshkruhen. Mes begative të përgatitura për besimtarët është edhe fakti se nuk u kalben rrobat, nuk u përfundon rinia, begatia është pa fund, nuk vuajnë e as që përjetojnë ndonjë defekt. Begatitë e xhennetit ndodhin në formën më të plotë dhe më të mirë. Shfrytëzimi i begative të xhennetit nuk ka pasojë sikur shfrytëzimi i begative të dynjasë.

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem, thotë: "Banorët e xhennetit hanë, pinë dhe nuk pëshqijnë, nuk urinojnë, nuk kryejnë nevojë të madhe dhe nuk nxjerrin qurra". Çfarë ndodh me ushqimin? Gogësimë dhe djersë me aromë misku. Inspirohen ta lavdërojnë dhe falënderojnë All-llahun ashtu siç inspirohen të marrin frymë". (Muslimi).

Banorët e xhennetit nuk flenë që të mos largohen nga kënaqësitë dhe jeta komode me gjumë. Ata janë të zhytur në begati e nuk

janë si njerëzit në këtë dynja që flenë. E kanë pyetur Pejgamberin, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem: A flenë banorët e xhennetit? Ka thënë: "Gjumi është vëlla i vdekjes, kurse xhennetit nuk flenë". (Sahih, Taberaniu dhe Bezari). Tërë kjo ndodhë për shkak jetës së plotë që e jetojnë njerëzit në xhennet.

Gratë e Xhennetit janë të pastra, në aq shumë hadithe është treguar për to dhe me tregime të tilla që e mahnitin kokën dhe e nxisin secilin njeri të mirë që shpreson All-llahun dhe Ahiretin që të veprojë vepra të mira dhe të pranuar te All-llahu, subhanehu ue teala, për të arritur atë që All-llahu, xhel-le shanuhu, ua ka premtuar besimtarëve të devotshëm.

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem, ka thënë: "Xhennetliu do ti ketë dy hyri, secila prej tyre do ti ketë shtatëdhjetë palë petka, i shihet palca e kërcikut të saj pas rrobave". (sahih, Ahmedi).

Gjithashtu janë përshkruar hyritë edhe në hadithe tjera për të stimuluar njerëzit në respekt ndaj All-llahut, azze ue xhel-le. Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem, thotë: "Po qe se një grua prej banorëve të xhennetit i shikon banorët e tokës do të shndriste gjithë hapësirën mes tyre dhe do ta mbushte me aromë. Shamia që ka mbi kokë është më e mirë se sa dynjaja dhe çka ka në të". (Buhariu).

Madje edhe dielli me fuqinë, dritën dhe shkëlqimin e tij, i cili kur del në mëngjes ua kalon të gjitha dritave dhe kur perëndon në mbrëmje nuk mund ta largojnë errësirën edhe nëse e përdorin mbarë rrymën elektrike, kurse: "Po qe se një grua prej banorëve të xhennetit do të shikonte tokë do ta mbushte me aromë, misk dhe do të eliminonte dritën e diellit dhe hënës". (Taberaniu).

Po përveç kësaj All-llahu, subhanehu ue teala, ka përgatitur edhe shtesa në xhennet, siç na tregon në suren "Kaf" ajeti 35: "Ata aty

kanë çka të dëshirojnë, e te Ne ka edhe më shumë".

"Kalon një re mbi banorët e xhennetit dhe thotë: a nuk luteni të sjellë bereqete si shiu. Atëherë për atë që do të luten, do t'u bjerë". (Abdullah Ibën Mubareku).

Kethir ibën Murrete thotë: "Nëse e përjetoj këtë ditë do të lutesha: na sill vasha të stolisura".

Begatitë e xhennetit dhe gëzimet që janë aty nuk mund të përshkruhen e as të fantazohen. Asgjë nga kjo dynja nuk mund të krahasohet me ato begati. Pema Tuba nuk gjendet kësaj në dynja, përshkrimi i kësaj peme të le pa mend.

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem, thotë: "Në xhennet ka një pemë që kalorësi ecë në hijen e saj një qind vjet pa u ndalur, lexoni nëse doni ajetin: "Nën hije të gjëra (përhershme)". (Muslimi).

Kurse Imam Ahmedi, rahimehull-llahu, regjistron një hadith në "Musnedin" e tij, se erdhi një njeri te Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem, e tha: çfarë është Tuba? Tha: Është pemë në xhennet, mund të ecësh në hijen e saj njëqind vjet, kurse nga degët e saj dalin rrobat e xhennetlive".

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem, nuk ka lërë pa sqarime as cilësitë dhe vetitë e xhennetlive, moshën, ngjyrën, gjatësinë, etj.

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem, thotë: "Xhennetlité hynë në xhennet të zhveshur, qose, të bardhë, me flokë pak si kaçurrela dhe me sy të ngjyrosur, në moshë tredhjet e tre vjeçare. Të gjithë do të jenë në gjatësinë e Ademit, alejhisselam, i cili ka qenë i gjatë gjashtëdhjetë llërë (30 metra përafërsisht), kurse të gjerë shtatë llërë". (Ahmedi).

Imam Ibën Kethiri, rahimehull-llahu, thotë: "Në këtë gjatësi, gjerësi dhe moshë ka urtësi të qarta, sepse në këtë formë njeriu arrin kulmin e kënaqësisë, pasi që janë bashkuar vitet

e fuqisë me mjetet e mëdha të kënaqësisë. Kur të grumbullohen këto dy gjëra arrihet kënaqësia e plotë dhe e fuqishme saqë një njeri ka mundësi të ketë marrëdhënie me një qind vajza beqare. Tregohet në hadithe se erdhi një njeri nga ithtarët e Librit dhe e pyeti Pejgamberin, sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem, duke i thënë: je duke pretenduar se xhennetlité hanë dhe pinë? Tha: "Po, pasha Atë që në Dorën e Tij është shpirti im, xhennetlive u jepet fuqia e njëqind njeriut në ngrënie, pirje dhe marrëdhënie". Përsëri i tha: Ai që ha dhe pi duhet të kryejë nevojën, kurse xhenneti është i pastër, nuk ka në të ndytësira? Tha: kryerja e nevojës ndodh me djersitje e cila ka aromë misku". (Daremiu).

A kanë pyetur Pejgamberin, sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem, a do të kemi marrëdhënie me gratë tona në xhennet? Ka thënë:

"Po, pasha Atë që në Dorë të Tij është shpirti im, një njeri për një ditë do të ketë marrëdhënie me një qind beqare". (Taberaniu).

Madje ka ardhur na hadithe se:

"Xhennetlité kur të kenë marrëdhënie intime me gratë e tyre në xhennet, ato sërish rikthehen beqare". (Taberaniu).

Pra, burrat me gratë e tyre në xhennet do të përjetojnë kulmin e dëshirave dhe sigurisë. All-llahun e lusim të na i shtojë mirësitë e Tija.

Xhennetlive u shtohet fuqia, u shndrit fytyra, kanë pamje të bukur, jetë të këndshme dhe kjo nuk ndalet asnjëherë.

"E për shpërblim të tillë le të garojnë ata që lakmojnë të mirën". (El-Mutaffin: 26).

"Për një shpërblim të këtillë le të veprojnë vepruesit". (Es-Saffat: 61).

Për të patur jetë të këndshme duhet të kanë edhe moral të mirë. All-llahu, xhel-le shanuhu, thotë: "Ne kemi hequr prej zemrave të tyre çfarëdo urrejtje, e ata në mbështetëse qëndrojnë ballë për ballë njëri-tjetrit duke qenë të vëllazëruar". (El-Hixhr: 47).

Kurse Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem, na ka treguar: "Nuk ka dallime mes tyre e as hidhërimi. Zemrat i kanë një, e lavdërojnë All-llahun në mëngjes dhe mbrëmje". (Buhariu).

Aroma e këndshme që gjendet në xhennet përhapet anembanë xhennetit me një shpejtësi shumë të madhe dhe secili xhennetli kënaqet duke e nuhatur këtë aromë.

Frytet e xhennetit nuk janë sikur frytet e dynjasë, sepse frytet e dynjasë vijnë në sezon të caktuar, kurse frytet e xhennetit i ke në çdo kohë. Pemët në dynja herë kanë gjethe e herë nuk kanë, kurse pemët e ahiretit çdo herë kanë gjethe dhe fryte.

"Shembulli (atributi) i xhennetit që u është premtuar të devotshëmve është: që nën (pallatet) të rrjedhin lumenj, që ushqimi në të dhe hija në të është e përhershme. Ai është përjetim i lumtur i atyre që ishin të ruajtur, e përfundimi i jobesimtarëve është zjarri". (Er-Rad: 35).

Frytet e xhenneti e ke shumë lehtë t'i vjelësh edhe nëse ato gjinden në majën e pemës, sepse vet pema afrohet dhe të bie fryti në dorë.

"Hijet e tyre (të pemëve) janë afër mbi ta dhe kalaveshët e pemëve janë të qasur shumë afër". (El-Insan: 14).

Secila pemë e xhennetit e ka trungun prej ari, dhe është nga shafрани dhe miski, paramendoni se çfarë fryte mund të japë ky lloj i pemës, sigurisht se do të dalin fryte të mrekullueshme dhe të këndshme.

Xhennetlità në xhennet do të kenë edhe çadra të cilët në asgjë nuk u ngajnë çadrave të dynjasë.

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem, thotë: "Besimtari do të ketë çadër nga margaritari bosh, i gjatë gjashtëdhjetë milë. Besimtari aty do të ketë gratë, do ti viziton ato,

kurse aq e madhe është saqë nuk do të shohin njëri tjetrin". (Buhariu).

Nuk ka dyshim se dhurata dhe begatia më e madhe e xhennetlive, ajo që i mahnitë tërësisht dhe i mallëngjen edhe më shumë shpirtat e tyre është momenti kur All-llahu e largon perden dhe u mundëson banorëve të xhennetit që ta shohin. Kur ta shohin xhennetlità All-llahun, subhanehu ue teala, do t'i harrojnë të gjitha kënaqësitë dhe lezetet që i kanë përjetuar në xhennet dhe do të shikojnë madhërinë e All-llahut, Zotit të botëve, subhanehu ue teala.

Imam Ibën Kethiri, rahimehull-llah, tregon nga Ebul-Meali El-Xhuvajni, se kur All-llahu, xhel-le shanuhu t'u zbulohet xhennetlive, do të gurgullohet uji i lumenjve të xhennetit, do të radhiten pemët, do të shtohet gëzimi dhe galdimi, do të këndojnë shpezët dhe do të shndrisin edhe më shumë hyritë, mirëpo tërë kjo nuk do të largojë shikimin e xhennetlive nga All-llahu, subhanehu ue teala, sepse kjo është kënaqësia më e madhe. E lusim All-llahun e madh që të na dhurojë kënaqësinë e shikimit në Fytyrën e Tij Fisnike.

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem, thotë: "Kur xhennetlità të hyjnë në xhennet dhe xhehenemlità në xhehenem, do të bërtet një thirrës: o xhennetli, te All-llahu keni një premtim të cilin dëshiron t'ua realizojë. Do të thonë: çka është ai premtim? A nuk na e rëndoi peshojën, a nuk na e zbardhi fytyrën dhe na shtiu në xhennet dhe na mbrojti nga zjarri? Atëherë All-llahu do ta largojë perden dhe do të shikojnë në Të. pasha All-llahun, nuk u ka dhënë All-llahu gjë më të dashur e as më të këndshme për syrin tyre se sa shikimi në Të". (Sahih, Ahmed).

All-llahu, azze ue xhel-le, thotë: "Aty do të jenë përgjithmonë, e nuk kërkojnë të largohen nga ai (ose t'u ndryshohet)". (El-Kehf: 108).

Nuk ka dyshim se kjo kënaqësi do të arrijë kulmin e vet kur ta marrin vesh xhennetit se qëndrimi i tyre në xhennet do të jetë pa fund.

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem, na tregon: "Do të sillen vdekja në formën e dashit të majmë dhe do të vendoset mes xhennetit dhe xhehenemit e do të thuhet: o ju xhennetli, e ata do të zgjasin kokën dhe do të shikojnë. Do të thotë: o ju xhehenemli, e ata do të zgjasin kokën dhe do të shikojnë. Mendojnë se u ka ardhur shpëtimit. Do të theret vdekja dhe do të thuhet: o ju xhennetli, amshueshmëri dhe nuk ka vdekje, o ju xhehenemli, amshueshmëri dhe nuk ka vdekje. Xhennetive do t'u shtohet gëzimi edhe më shumë, kurse xhehenemlive do t'u shtohet mërzia edhe më shumë". (Buhariu). Kurse në transmetimin e Ibën Ebi Dynajisë qëndron: "Do të sigurohen të parët dhe do të humbin shpresën përfundimisht të dytët".

Dijë vëlla i dashur se xhenneti nuk fitohet me shpresa të kota dhe pasim të epshit, kurse rruga e vetme që na shpie deri atje është respektimi i All-llahut dhe Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem.

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem, thotë: "I gjithë ummeti im do të hyjë në xhennet, përpos atij që refuzon. Thanë: kush do të refuzon o i Dërguar i All-llahut? Tha: ai që më respekton do të hyjë në xhennet, kurse ai që nuk më respekton vetëm se ka refuzuar".

Kujdes nga nepsi yt, sepse ky është pengesa kryesore në rrugën tënde drejt All-llahut, subhanehu ue teala, sidomos për ata që ecin në mbrëmje. Nëse njeriu nuk ka me vete nozull të imanit dhe llambë të bindjes, nuk do t'ia arrijë t'i tejkaloj këto barriera.

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem, thotë: "Ai që frikësohet ecën herët në mëngjes, kurse ai që del herët në mëngjes arrin në destinacionin e tij. Dijeni se malli i All-llahut

është i shtrenjtë, dijeni se malli i All-llahut është xhenneti". (sahih, Tirmidhiu).

Sa më lart hipën udhëtari aq më shumë shtohen britmat, tradhtitë dhe frikësimet, e nëse nuk ua vendon veshin dhe vazhdon në rrugën e tij, tërë këto vështirësi dhe frikësime shndërrohen në siguri dhe rrugë e gjerë, e cila e shpie deri te shtëpitë më të larta, aty ka shenja dhe vendpushime që i ka përgatitur All-llahu, tebareke ue teala, për robërit e Tij. Mes këtij vendi dhe mes teje është vetëm vendosmëria e fuqishme, durimi për çaste të caktuara, trimëria dhe lutja e gjatë.

I mençur është ai që e llogarit veten dhe punon për pas vdekjes, kurse i paaftë është ai që e pason epshin e tij dhe mbahet me shpresa të kota.

Dije se malli i All-llahut është i shtrenjtë dhe se për të arritur deri te ky mall duhet të përjetosh trishtime, brenga dhe pikëllime.

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem, ka thënë: "Xhenneti është rrethuar me gjëra të vështira, kurse xhehenemi me epshe".

Xhenneti qenka i rrethuar me gjëra të urryera, me vepra të vështira, me ikje nga harami, mirëpo përbrenda tyre ka kënaqësi dhe gëzime që nuk mund ti paramendosh. Kurse xhehenemi është i rrethuar me epshe, epshe të zullumit, të barkut, të epshit, të devijimit, të sprovave, etj. janë të lehta, mirëpo përbrenda kanë dëme dhe dënime të trishtueshme.

E lusim All-llahun, xhel-le shanuhu, që të na japë nga frika ndaj Tij aq sa të na largojë nga mëkati, të na dhurojë respekt ndaj Tij aq sa të arrijmë te xhenneti i Tij, të na dhurojë kënaqësinë e shikimit në Fytyrën e Tij, mallëngjimin për takimin me Të, duke mos përjetuar ndonjë fatkeqësi dëmtuese e as ndonjë fitne devijuese dhe të na furnizojë Kënaqësinë e Tij të madhe dhe firdausin e lartë. Amin.

Bekir Halimi

Mos mallko!

Prej pasojave më të rrezikshme të sjelljes së ngutshme dhe të pakujtuar për gjykim ndaj tjerëve, dhe me të cilën gjë i japim vetes pozitën e gjykatësit për të gjykuar dikë si të kapluar me mëshirën e Allahut ose me mallkim prej Tij.

Ai që mediton rreth kësaj e vëren se qortimi i kësaj cilësie në Islam qëndron sepse kjo cilësi mëton në mohimin e imanit të sinqertë, prej cilësive më të dalluara të të cilit është butësia me krijesat. Besimtari zemrën e ka të lidhur për All-llahun, subhanehu ve teala, gëlltit nga nektari i mëshirës së All-llahut me të cilën do të mëshirojë të tjerët dhe nga butësia dhe mirësia e All-llahut me të cilat do të jetë bamirës ndaj atyre që i ka përreth. Kështu, besimi formohet me të gjitha kuptimet e mëshirës dhe butësisë, si dhe, denoncohet prej çdo ashpërsie, vazhdësie dhe nënçmimi.

Mallkimi në kuptimin e tij të gjerë përfshin dëbimin nga mëshira e Allahut të Lartmadhëruar dhe është një prej gjërave të urryera dhe për të cilat neve na ka ndaluar Pejgamberi gjatë edukimit të tij, me shumë ndalime dhe udhëzime. Thotë ai, paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të;

“Unë nuk jam i dërguar si mallkues por u dërgova si mëshirë” (1)

“Nuk është besimtari akuzues, as mallkues, as sharës e as një që fol pistë” (2)

“Nuk i ngjan besnikut, (të sinqertit) që të jetë mallkues” (3)

“Besimtari nuk bëhet mallkues” (4)

“Mos mallkoni me mallkim nga Allahu as me Hidhërim të Tij e as me Zjarrin” (5)

Pra mos bëni lutje kundër njerëzve me diçka që shpreh largimin nga mëshira e Tij, qoftë në mënyrë eksplicite duke thënë: “Allahu e mallkoftë” ose indirekt duke thënë “qoftë Hidhërimi i Allahut ndaj Tij” ose “Allahu e futë në Zjarr”

Fjala e pejgamberit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem: “Mos mallkoni” është me kuptim të përgjithshëm, në disa raste është për qëllim ndalesa e vërtetë, e në disa raste është me alegori. Është me alegori, sepse mallkimi është i lejuar, kur është i drejtuar ndaj ndonjë karakteristike të përgjithshme apo të veçantë. Sikurse, të mallkuarit e kafirëve, apo në veçanti, sikurse mallkimi i Jehudive, të atyre që vizatojnë gjallesa apo të ndonjë kafiri përkatës, i cili ka vdekur në kufër, si faraoni apo Ebu Xhehli.

Transmetohet nga Zejd bin Eslem se AbdulMelik ibën Mervani i dërgoi Ummu Derdase ca mobilie për shtëpi, dhe ashtu, një natë AbdulMeliku u ngrit dhe e thirri shërbëtorin e tij, i cili ecte dalëngadalë, e AbdulMeliku e mallkoi. Kur gdhinë, Ummu Derdaja i tha: mbrëmë të dëgjova kur e mallkove shërbëtorin tënd, e kam dëgjuar Ebu Derdanë, radijallahu anhu, duke thënë: Resulullahu, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

“Ditën e kijametit, mallkuesit nuk do të mund të jenë as ndërmjetësues e as dëshmitarë (dëshmorë)”. (6) (d.m.th. nuk do të mund të ndërmjetësojnë ditën kur besimtarët do të ndërmjetësojnë për vëllezërit e tyre, dhe as nuk do të mund të dëshmojnë mbi popujt e tjerë se pejgamberët e tyre e kanë kumtuar fenë. Një tjetër mendim thotë se

Allahu, subhanehu ve teala, nuk do t'ua mundësojë atyre vdekjen në rrugë të Tij si dëshmorë).

Tregon Thabit ibën Dahhaki, radijallahu anhu, se Resulullahu, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: “Mallkimi i besimtarit është sikurse vrasja e tij” (7), pra, në ndalimin, dënimin dhe largimin prej mëshirës. Kjo, sepse mallkimi është largim nga mëshira, ndërsa vrasja është largim nga kjo jetë.

Në këto hadithe të shumta dukshëm shihet rreziku i çështjes së mallkimit, po ashtu edhe dëmi i lirisë së pakontrolluar në nxjerrjen e të tjerëve nga mëshira e Allahut, subhanehu ve teala, gjë që do të rezultojë me mbjelljen e urrejtjes dhe përçarjes, në një kohë, ku është më se e nevojshme që shoqëria islame të jetë e kapur për litarin e respektit dhe dashurisë. Anëtarët e të cilit do të jenë si ndërtesë e fortifikuar mirë.

Serioziteti i Resulullahut, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, për ta larguar këtë cilësi prej besimtarëve shihet në më tepër se një rast, ku ndonjëherë është mësues, ndonjëherë si qortues e ndonjëherë edhe si dënues.

Thotë Xhermuza el-Huxhejmi:

I thashë të dërguarit: Më këshillo! Më tha: “Të këshilloj që mos të bëhesh mallkues” (8)

Pra, mos e mallko atë që është e ndaluar ta mallkosh, ngase kjo ndalohet. Po ashtu ai mallkim i kthehet mallkuesit.

Tregon Ebu Dardaja, radijallahu anhu, se Resulullahu, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: “Kur njeriu mallkon diçka, ai mallkim drejtohet nga qielli, por i mbyllen dyert e qiellit, pastaj lëshohet nga toka dhe sërish mbyllen dyert, pastaj shikon djathtas-majtas, e nëse nuk gjen vend, drejtohet nga i mallkuari, nëse kjo cilësi nuk është për të, atëherë kjo cilësi i kthehet thënësit të saj” (9).

El-Munavi e ka shpjeguar kështu këtë hadith: “mallkon diçka” - qoftë njeri apo diç tje-

tër, duke bërë lutje që Allahu ta largojë nga mëshira e Tij; “drejtohet nga qielli” - për të hyrë; “por i mbyllen dyert e qiellit” - sepse ato hapen vetëm për punë të mira, Allahu, subhanehu ve teala, ka thënë:

“tek Ai ngritet fjala e mirë (besimi) dhe veprimi i mire”;

“pastaj lëshohet nga toka dhe sërish mbyllen dyert” - pra, mundohet që të arrijë në tokë për të arritur në Sixhxin, për do të pengohet nga kjo zbritje; “pastaj shikon djathtas-majtas” - bie në hall, nuk di nga të shkojë; “e nëse nuk gjen vend” - d.m.th. vend të përshtatur për t'u përqendruar aty; “drejtohet nga i mallkuari, nëse kjo cilësi nuk është për të” - mallkimi shkon deri te i mallkuari, i cili nëse e ka merituar mallkimin, menjëherë largohet nga mëshira, e nëse ky mallkim nuk zë vend në personalitetin e këtij; “atëherë kjo cilësi i kthehet” - me lejen e Allahut; “thënësit të saj” - sepse mallkimi është largim nga mëshira e Allahut, subhanehu ve teala, andaj, kush mundohet që një besimtar ta largojë nga mëshira e Allahut, atëherë vetë ai e meriton të largohet nga mëshira e Tij.

Qëllimi i hadithit është tërheqja e vërejtjes nga mallkimi i atij njeriu që nuk e meriton mallkimin, si dhe kërcënimi se kjo cilësi i kthehet thënësit. Në këtë ka mësim për atë që kupton.

Tregon Ibën Abbasi, radijallahu anhu, se një njeri mallkoi erën në prezencë të Resulullahut, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ashtu që ai i tha: “Mos e mallko erën, sepse ajo lëviz me urdhër, e kush mallkon diçka që nuk është për mallkim, ai mallkim i kthehet thënësit të saj” (11)

Tregon Zejd ibën Halid el-Xhuheni se një njeri mallkoi një gjel që këndoi, e Resulullahu sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem, i tha: “Mos e mallko, sepse ai thërret në namaz” (12)

Pra, thërret për të falur namaz nate kur këndon në atë kohë, e ai që thërret në punë të mira duhet të lëvdohet e jo të fyhet. El-Hulejmi ka thënë: Këtu ka argument se çdo gjë, nga e cila përfitohet diç e mirë, nuk guxon të nënçmohet e as të fyhet, përkundrazi, meriton nder, respekt dhe mirësi. Kuptimi i thirrjes së gjelit në namaz nuk është se ai realisht dhe me fjalë thërret për namaz, por kuptimi është se gjeli këndon zakonisht në kohën e daljes së agimit dhe në kohë të zenitit, kjo është natyrshmeri në të cilën e ka krijuar Allahu, subhanehu ve teala. Dhe kështu, me këndimin e tij njerëzit përkujtohen me ato kohë të namazit. Ndërsa, nuk lejohet që të mbështetemi plotësisht në këndimin e gjelit për hyrjen e kohës, përveç për ndonjë gjel konkret, që dihet se saktësisht në atë kohë këndon. (13)

Thotë Imran ibën Husajni, radijallahu anhu: Ishim së bashku me të dërguarin e Allahut në një udhëtim dhe një grua prej ensarëve

ishte mbi deve dhe përnjëherë u zemërua dhe e mallkoi devenë. Resulullahu sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem, e dëgjoi dhe tha: “Merreni atë që ka mbi dhe lëreni, sepse ajo (deve) është e mallkuar”; Imrani tha: Më kujtohet shumë mire se si ecte ajo (deve) mes njerëzve dhe askush nuk e shalonte. (14)

Dr. Halid Sejjad en-Nexhar

Përktheu: Omer Berisha

Burimet:

1. Muslimi nr. 4704
2. Tirmidhiu nr. 1900; në Sahihul Xhamië 5381
3. Muslimi nr. 4701
4. Tirmidhiu; shih në Sahihul Xhamië nr. 7774
5. Tirmidhiu; shih në Sahihul Xhamië 7443
6. Muslimi nr. 4702
7. Buhariu nr. 5640
8. Ahmedi; shih në Sahihul Xhamië 2542
9. Ebu Davudi nr. 4259; shih në Sahihul Xhamië 1672
10. Fejdul Kadir nga el-Munavi 2/154
11. Tirmidhiu nr. 1901; shih në Sahihul Xhamië nr. 7447
12. Ahmedi; shih në Sahihul Xhami nr. 7314
13. Fejdul Kadir nga el-Munavi 2/178
14. Muslimi nr. 4699

Sunneti dhe mustehabi

Lidhja ndërmjet sunnetit dhe mustehabit të dijetarët e fikhut merr dy kahje:

Kahja e parë: këto dy terma janë sinonime dhe në bazë të kësaj: sunneti, mustehabi, mendubi, nafiëja dhe tetavui janë me një kuptim. Këtë e ka përmendur Razi (1/129). Subkiu në “Ibhaxh” (1/257) thotë: ky është mendimi i shafijve dhe xhumhurit të dijetarëve të Usulit.

Disa prej tyre e definojnë sunnetin dhe sinonimet e tij: vepër në bazë të së cilës shpërblehet vepruesi i saj, ose vepër në bazë të së cilës vepruesi i saj meriton shpërblimin, ose vepruesi i saj meriton shpërblimin kur kryen atë vepër me nijet. Të gjitha këto janë definicione të pasojës dhe rezultatit të patjetërsuar

që buron nga ky term, shiko (komentet e “Verakat” dhe “Gidhaul elbab” 1/207)

Disa të tjerë e definojnë: “vepër që sheriati i dha përparësi kryerjes ndaj braktisjes së saj, mirëpo braktisja e saj lejohet” apo: “veprimi i saj është i ligjshëm jo në mënyrë të patjetërsuar”. Ky definim i fundit është më i mirë.

Është mirë të kemi vëmendjen se me termin “sunnet” kihet për qëllim kuptimi i tij i veçantë, siç thuhet: kjo vepër është sunnet, kurse kjo tjetra është uaxhib. Ose thuhet për ndonjë çështje se është uaxhib, apo mustehab apo sunnet. Termi sunnet ka edhe kuptime të tjera që nuk kanë të bëjnë me temën tonë, ato mund të kërkohen në librat e Usulit dhe Mustalahut.

Kahja e dytë: dhënia e çdonjërit prej këtyre termave kuptim të veçantë. Kjo është metodologji e hanefijve, disa malikijve dhe shafijve sikur: Kadi Husejn dhe të tjerë, si dhe disa hanbelij. Pastaj të gjithë këta nuk kanë rënë në ujdj për dallimin që ekziston ndërmjet sunnetit dhe mustehabit.

Disa thanë: sunnet është një vepër që Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, e ka bërë vazhdimisht, kurse mustehab që nuk e ka bërë vazhdimisht. Shiko ("el bahrurraik" 1/29), ("hashijetu ibën Abidin" 2/375), ("bedaiussanai" 1/24), ("bahrul muhit" 1/378). Në bazë të këtij definicioni, sunnetet e rregullta (sunnen revatib) për shembull ose vitri, quhen sunnete për shkak se Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, i ka bërë vazhdimisht. E namazi i duhasë, sipas këtij definicioni a mund të quhet sunnet? Këtu ka hapësirë për të medituar.

Shprehja e tyre: vepër që e ka bërë "vazhdimisht" është më e saktë se ajo që disa e thanë: vepër që Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, e ka bërë "një herë ose dy herë", sepse disa nga veprat në Haxh, Umreja, namazi i Kusufit dhe Husufit, namazi për shi, janë punë që Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, nuk i ka bërë vetëm një apo dy herë, e megjithëkëtë janë sunnete.

Disa të tjerë, përkrahës të mendimit se sunneti dhe mustehabi kanë kuptime të ndryshme, thanë: mustehab është një vepër që e ka urdhëruar Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, mirëpo ai nuk e ka vepruar, shiko ("el bahrul muhit") siç janë dy rekatet para farzit të Akshamit që janë përmendur në hadithin e Abdullah ibën Mugaffelit të transmetuar nga Buhariu, ku Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, thotë: "faluni para farzit të Akshamit, faluni para farzit të Akshamit, faluni para farzit të Akshamit! Në të

tretën herë tha: ai që dëshiron, - për të mos e marrë njerëzit si sunnet." (hadithi nr 1183)

Këta dijetarë siç duket kanë marrë për argument këtë hadith për të argumentuar se sunneti është në gradë më të lartë se mustehabi dhe më parësor për t'u vepruar. Për këtë nuk pëlqejnë që dy rekatet para farzit të Akshamit të quhen sunnet. Mirëpo vetë konteksti aludon në atë se sunneti mund të jetë edhe fjala dhe urdhri i Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, përveç veprës së tij. Vetë urdhri i tij për t'i falur dy rekatet para farzit të Akshamit pa përmendur fjalën "për atë që dëshiron" tek njerëzit është sunnet. E kjo nuk përputhet me definicionin e tyre për sunnetin: vepër që Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, e ka bërë vazhdimisht dhe nuk e ka lënë.

Disa prej tyre, sikur Halimij, sunnetin e definuan: vepër që preferohet të kryhet dhe urrehet lënia e saj, kurse tetavu: vepër që preferohet të kryhet mirëpo nuk urrehet lënia e saj.

Ibën Sem'anij në "kavatiul-edil'le" 1/21 thotë: nafileja është e përafërt me mendubin, vetëm se është në gradë më të ulët se ai.

Te malikijt, sunnet është: vepra, urdhri i së cilës është në gradë të lartë dhe sheriati fuqishëm ka nxitur tek ajo. Nëse është në gradat e para të ulëta quhet tetavu ose nafile ("el bahrul muhit" dhe "sherhul keukeb" 126)

Pasi që ky studim lidhet kryekëput me një çështje të pastër terminologjike, na bëhet e qartë duke analizuar metodologjinë e shumicës së dijetarëve, prej fukahave, muhadithëve dhe të tjerëve, se shumica e tyre nuk bëjnë dallim ndërmjet këtyre termave, përveç rasteve kur ata shprehin qartë të kundërtën ose kur konteksti aludon në një gjë të tillë. Ata për shembull thonë: sunnetet e abdesit, sunnetet e namazit, sunnetet e tavafit, sunnetet e ihramit... dhe nuk bëjnë dallim

ndërmjet sunneteve të thëna apo të vepruara. Nuk bëjnë dallim ndërmjet asaj që Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, e ka vepruar vazhdimisht apo ndonjëherë. Ata mund të bëjnë dallim ndërmjet sunneteve në bazë të rëndësisë së tyre, për shembull thonë: sunnet i fortë (sunne muekkede) si namazi i virtit, sepse Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, nuk e ka lënë as kur ka qenë udhëtar e as mukim (në vend), ka urdhëruar të kryejmë këtë namaz, na ka nxitur në të dhe na ka tërhequr vërejtjen që të mos e braktisim

kryerjen e tij. Për këtë shkak hanefijtë mendojnë se namazi i vitrit është uaxhib, kurse uaxhibi tek ata dallon prej farzit. Një grup prej dijetarëve të selefit mendojnë se vitri është uaxhib për hafizët e Kuranit vetëm, për shkak të hadithit: “faleni vitrin o ithtarë të Kur’anit.” (transmeton Ibën Maxhe, Nesaiu dhe Ebu Davudi) këtë mendim e saktëson edhe Ibën Tejmije, kurse mendimi më i saktë është se vitri është sunnet i fortë për të gjithë. Allahu e di më së miri.

Selman ibën Fehd el Avde
Shqipëroi: Agim Bekiri

Pavarësia e sistemit gjyqësor

Tekstet e shenjta dhe primet themelore të legjislacionit Islam, ndalojnë ndërhyrjen e pushtetit ekzekutiv në vendimet e pushtetit gjyqësor. Parimet e përgjithshme të Islamit, si dhe vendimet individuale për raste të ndryshme, synojnë zbatimin e drejtësisë që ndërtohet mbi parimin kryesor të Teuhidit. Njësimi i All-llahut nuk është vetëm fjalë që shqiptohet me gojë. Pjesë të pandarë të besimit janë edhe veprimet praktike që vërtetojnë bindjen e brendshme. Ky besim realizohet duke i zbatuar urdhrat e All-llahut, si dhe duke u larguar prej ndalesave. Implementimi i drejtësisë që ndërtohet mbi zbatimin e urdhrave dhe largimit prej ndalesave, është obligim kolektiv i tërë Ummetit. Zbatimi i ligjit të All-llahut është kriter i drejtësisë dhe vërtetësisë. Ajo të cilën e ka urdhëruar All-llahu është e drejtë dhe e vërtetë në kohë, që atë që e ka ndaluar e konsiderojmë si padrejtësi dhe gënjeshtëri.

Ka shumë ajete në të cilat All-llahu urdhëron për drejtësi dhe ndalon padrejtësinë: “All-llahu urdhëron drejtësi, bamirësi, ndihmë të afërmeve, e ndalon nga imoraliteti, nga e neveritura dhe dhuna. Ju këshillon ashtu që të merrni mësim.” (En Nahl, 90)

“...dhe të mos u shtyjë urrejtja ndaj një populli e t'i shmangeni drejtësisë; bëhuni të drejtë, sepse ajo është më afër devotshmërisë. Kini dro All-llahun se All-llahu di hollësisht për atë që veproni.” (El Maide, 8)

“Po nëse (ti o Muhammed) gjykon mes tyre, gjyko drejtë; All-llahu i do të drejtin.” (El Maide, 42)

“E kush nuk gjykon me atë që e zbriti All-llahu, ata janë mohues.” (El Maide, 44)

All-llahu ia ka ndaluar Vetës padrejtësinë dhe e ka bërë të ndaluar për robërit siç thuhet në një hadith kudsijj.

Këto janë vetëm disa tekste që flasin qartë për obligimin e të gjykuarit drejtë në pajtim

me atë që e ka shpallur All-llahu, subhanehu ve te'ala. Ky është obligim i përgjithshëm të cilit i nënshtrohen pushtetmbajtësit dhe ata që nuk kanë pushtet. Fuqia politike që e ka pushtetmbajtësi është e përkufizuar me ligjin e All-llahut. Asnjë vendim politik nuk zbatohet nëse ndeshet me ligjin e All-llahut, subhanehu ve te'ala. Kështu zbatohet drejtësia në kohën e të parëve tanë të mirë. Sunduesi ishte vetëm mbikëqyrës i zbatimit të ligjit Islam që kujdesej për çështjet shtetërore. Sunduesi suprem është All-llahu, në kohë që kalifi është vetëm njëri prej muslimanëve që zgjidhet prej muslimanëve dhe e merr pushtetin me pajtim të muslimanëve. Drejtësia hyjnore që siguron ekuilibrin në gjithësi, është themeli i qeverisjes islame.

Amër ibën El 'As, radijall-llahu anhu, ka thënë: “Nuk ka udhëheqësi pa njerëz, nuk ka njerëz pa pasuri, nuk ka pasuri pa përparim (prosperitet) dhe nuk ka prosperitet pa drejtësi.”

Omer ibën Abdul Azizi, halifi i drejtë, rahimehullah, guvernatorit të një qytetit që kërkonte ndihmë për ta fortifikuar qytetin i shkroi: “Qyteti do të fortifikohet me drejtësi dhe me largimin e padrejtësisë nga rrugët e qytetit.”

Sa'id ibën Suvejdi në një fjalim drejtuar qytetarëve të Homsit ka thënë: “O ju njerëz Islami ka një mur që nuk kalohet dhe një derë të sigurt. Muri i pakalueshëm është e vërteta dhe dera e sigurt është drejtësia...”

Për këtë shkak, halifët e drejtë dhe udhëheqësit e shtetit Islam punuan shumë për ta mbrojtur dinjitetin dhe nderin e sistemit gjyqësor nga ndërhyrjet e jashtme. Kështu vepruan për ta siguruar të vërtetën dhe drejtësinë, që nuk ndryshojnë për t'u përshtatur me “urdhrin prej lartë”. Vendimet e gjyqit ata i respektonin dhe zbatonin edhe

atëherë kur vendimet ishin jo në favorin e tyre.

Librat e historisë janë plot rrëfime që dëshmojnë për proceset gjyqësore në të cilat jo rrallë është vendosur në dëm të kalifëve dhe sunduesve. Në shumë raste halifeja ka qenë i vetëdijshëm për vendimin përfundimtar, (të dëmshëm për të) por ka lejuar vazhdimin e procesit duke e pasur për synim të vendosë model të sjelljes që duhet ndjekur nga ata që do të vijnë pas tij në postin e sunduesit. Në këtë mënyrë, ata gjithashtu e kanë testuar forcën e gjyqtarëve të ballafaqohen me situata të tilla ku sunduesit i kundërvihet ndoshta edhe një çifut ose jomusliman. Personaliteti i kadisë, në sallën e gjyqit, ka qenë i respektuar nga të gjithë. Ai trajtonte në mënyrë të barabartë princin dhe varfanjakun. Në librat e historisë kemi shumë shembuj të tillë.

Në një rast Esh'ath ibën Kajsi hyri tek Shurejhi në sallën e gjyqit. Shurejhi e përshëndeti dhe e uli pranë vetes. Në atë kohë një person hyri në sallën e gjyqit duke akuzuar Esh'athin. Shurejhi tha: Çohu dhe ulu në karrigen e të mbrojturit për t'ju drejtuar të pranishmëve. Esh'athi tha: Përkundrazi do të flas prej këtij vendi.

Shurejhi tha: ose do të ulesh në vendin e duhur, ose do të detyroj me forcë. Kur i dëgjoi këto fjalë, Shurejhi u ngrit dhe qëndroi në vendin e duhur.

Ebu Jusufi, njëri prej gjyqtarëve më të njohur, gjykoi për një rast në të cilin një njeri pretendonte të ishte pronar i kopshtit që ishte në pronësinë e halifes. Ebu Jusufi urdhëroi që halifja të vinte në gjyq dhe kërkoi që paditësi të sillte provën. Paditësi tha: Halifeja e përvetësoi tokën time. Unë nuk kam provë, pra le të betohet kalifi.

Kalifi tha: Kopshti është pronë e imja. Kalifi El Mehdi e bleu, por nuk kam asnjë kontratë të shkruar.

Ebu Jusufi kërkoi nga kalifi të betohet tre herë, gjë kjo të cilën ai nuk e bëri. Në këtë rast Ebu Jusufi gjykoi në favor të paditësit.

Kalifi Ebu Xha'fer, Sivar ibën Abdullahit, i cili në atë kohë ishte kryekadiu i Basras, i shkroi këtë letër: Tokën për të cilën paditen gjenerali dhe tregtari jepja gjeneralit.

Sivari ia ktheu letrën ku kishte shkruar: Sipas provave që u vërtetuan para meje, ajo tokë i takon tregtarit e nuk ia marr dot pa provë.

Kur i erdhi letra e Sivarit, kalifi tha: Toka që është nën sundimin tim është mbushur me drejtësi, saqë edhe gjykatësit që unë i vendosa në poste e refuzojnë padrejtësinë me të vërtetë. Pastaj ia ktheu letrën me këto fjalë: Pasha All-llahut, pos të cilit nuk ka Zot tjetër, mos e merr tokën e tregtarit pa të drejtë.

Për të parandaluar ndërhyrjen e pushtetit ekzekutiv në vendimet e gjyqit Islami nuk u ndal tek forma deklarative duke siguruar garanci që mbrojnë fuqinë e sistemi gjyqësor dhe pavarësinë e tij.

Pasi që u kuptua rëndësia e postit, të cilin e ushtron gjykatësi, (i cili vendos në konfliktet mes palëve) del në shesh nevoja për personalitet të drejtë të cilin duhet ta ketë gjykatësi. Gjykatësi nuk mund të arrijë nderim publik pa prova konkrete për karakterin e tij. Sjellja e mirë dhe përmbajtja drejtësisë gjatë gjykimit, janë provat më të sakta për personalitetin e gjykatësit. Në librat e tij potencojnë llojet e sjelljeve që nuk i përkasin postit që ai e ushtron.

Si duhet të sillet kadiu:

Gjykatësi duhet të ketë sjellje që korrespondon me sjelljen e personit nga i cili kërkohet integritet personal dhe paanësi. Çdo sjellje, e cila cenon integritetin e gjykatësit dhe paanësinë e tij, është e papranueshme.

Juristët islam kanë përmendur disa sjellje që nuk duhet t'i ketë gjykatësi:

1. Nuk lejohet që ai të angazhohet me tregti dhe me profesion të ngjashëm. Imam Shafi'iu, rahimehullah, ka thënë: Nuk është e pëlqyer që kadiu të merret me shitblerje sepse kam frikë se ai do të ketë përparësi të padrejta...

Këtë e ka thënë duke e pasur parasysht faktin se ka mundësi që gjykatësit t'i ofrohen privilegje të volitshme gjatë tregtisë dhe si kundërvlerë të kërkohet status i veçantë në sallën e gjyqit. Të gjitha format e marrëdhënies komerciale e kanë vendimin të njëjtë si shitblerja.

2. Nuk i lejohet pranimi i dhuratave: Kadiu nuk duhet të pranojë dhuratë nga njëra e palëve që paditen sepse kjo e vë në pikëpyetje paanshmërinë e tij. Në përgjithësi nuk është e pëlqyeshme që kadiu të pranojë dhurata.

Kur Omer ibën Abdul Azizi refuzoi dhuratën, i thanë: I Dërguari i All-llahut, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, pranonte dhurata? Këto gjëra ishin dhurata për të Dërguarin kurse për neve janë rryshfet. Me dhuratat që ia jepnin të Dërguarit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, muslimanët e parë kërkonin afërsinë e tij.

I Dërguari i All-llahut kishte mbrojtjen hyjnore nga gabimet, në një kohë që njerëzit e thjeshtë me vete nuk e kanë këtë veçori. Të gjitha format e dobisë që gjykatësi i pranon nga personi që është nën pushtetin e tij, konsiderohen dhurata (dhe nuk lejohet pranimi i tyre).

3. Sjellja e pahijshme shoqërore nuk është e pranueshme për postin e kadiut. Gjykatësi duhet të ketë kujdes për sjelljet që mund të cenojnë personalitetin tij. Nga kadiu kërkohet të jetë dinjitoz dhe i respektuar dhe të largohet nga gjërat që e dëmtojnë imazhin e

tij. Nuk duhet ta teprojë shoqërimin me njerëzit, gjë kjo e cila ia siguron paanësinë si dhe parandalon ndikimin e të tjerëve në vendimet e tij. Ky qëndrim nuk nënkupton largimin nga jeta shoqërore ku prezenca e tij është e nevojshme.

Nga gjykatësi kërkohet largim nga tallja dhe shakaja e tepruar që ndikojnë në uljen e respektit ndaj postit të tij.

Nga ai kërkohet t'u përmbahet standardeve më të larta gjatë bisedës së pastër nga gabimet dhe mangësitë. Ai nuk duhet të jetë as qesharak e as mendjemadh.

Për ta siguruar pavarësinë e sistemit gjyqësor, legjislacioni islam ndalon që pushteti ekzekutiv të bëjë ndërrimin e gjykatësve (pa arsye) dhe ky është mendimi i shumicës së juristëve. Shkarkimi i gjykatësit lejohet vetëm në rast kur atë gjë e kërkon interesi dhe mirëqenia shoqërore. Shkaku i shkarkimit duhet të jetë i njohur në mënyrë të pamohueshme dhe pranueshëm për shtresën e gjerë të popullsisë. Lejohet shkarkimi i gjykatësit edhe atëherë kur në atë post emërohet një person më i kualifikuar.

Shkarkimi është i pavlefshëm nëse bëhet pa arsye të pranueshme.

Sigurimi i të ardhurave të mjaftueshme për gjykatësin është shtyllë e rëndësishme në sigurimin e pavarësisë, të cilën e synon sistemi gjyqësor islam. Pavarësia e tij materiale është element i rëndësishëm në përfitimin e besimit tek ndërgjyqësit. Paga e tij duhet të jetë e mjaftueshme dhe të korrespondojë me nevojat e jetës dhe standardin shoqëror.

Rroga e tij sigurohet nga thesari shtetëror (المال بيت) Ibën Kudameja pasi që i përmend mendimet e ndryshme të juristëve (الفقهاء) për financimin e gjykatësit, shkruan: "Mendimi më i saktë është: Lejohet që gjykatësi të marrë rrogë për punën e tij, sepse Ebu Bekri, radijall-llahu anhu, i caktoi vetes rrogë pasi që u bë kalif (الخليفة) (mëditje dy dërhëm të argjendit). Më parë përmendëm që edhe Omeri, radijall-llahu anhu, paguante Zejdin, Shurejhin dhe Ibën Mes'udin, radijall-llahu anhum. Nëse rrogat nuk sigurohen sistemi gjyqësor do të asgjësohet dhe nuk do të ekzistojë mënyrë për t'i mbrojtur të drejtat e njerëzve.

marrë nga: IslamToday.net

Zgjedhi dhe përktheu: Talha Kurtishi

Vendimi islam për eutanazinë

Eutanazia, "vrasja e mëshirshme" apo "vdekja e lehtë" është: synimi i mjekut për t'i dhënë fund jetës së të sëmurit për të cilin nuk ka shpresë shërimi, sikur ai që vuan nga kanceri, SIDA etj., atëherë kur dhimbja është e madhe, ose duke i dhënë bar mbytës, ose duke ia hequr aparatet pa të cilat nuk mund të jetojë, siç janë aparatet për frymëmarrje, apo duke ia ndërprerë barin, pa të cilin gjithashtu nuk mund të jetojë.

Disa mjekë mendojnë se motivi për këtë vrasje është njerëzor, që synon t'i japë fund mundimeve dhe dhimbjeve të të sëmurit, madje edhe mundimeve të familjes së të sëmurit.

Kjo vepër është e ndaluar në ligjin islam, pa marrë parasysh motivet e saj. Atëherë kur mjeku apo dikush tjetër synon të kryejë këtë vepër, ai do të llogaritej vrasës, pa marrë parasysh se ia ndal barnat e duhura apo i jep barna vrasëse. Në tërësi këtë ai do

të mbajë mëkatin e vrasësit me qëllim, çfarëdo që të jenë arsyetimet e tij, sepse ligji islam i ka lejuar mjekut që të mjekojë trupin e të sëmurit për të përfutur të mira dhe për t'i eliminuar të këqijat eventuale, e të këqijat më të mëdha, janë ndalesat e ligjit islam.

Po ashtu, as i sëmuri nuk ka të drejtë që të japë leje për t'u bërë diçka e ndaluar (sipas shariatit) me trupin e tij, sepse trupi i njeriut është pronë e Allahut, subhanehu ue teala, siç thotë Allahu "Vetëm i All-llahut është sundimi ndaj qiejve e tokës dhe çka ka në to. Ai është i plotfuqishëm për çdo send." (1) asnjërit nuk i takon të nëpërkëmbë pasurinë e huaj.

Ibën Hazmi thotë: çdonjëri që urdhërohet të bëjë një ndalesë, e ka haram ta zbatojë atë, e nëse e bën, ai është mëkatar dhe nuk ka arsye. Edhe ai i cili urdhëron veten në diçka të ndaluar, po ashtu është mëkatar. (2)

Ibën Kajjimi thotë: ndalohet amputimi i ndonjë organi që Allahu dhe Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem, nuk kanë urdhëruar një gjë të tillë, as që e kanë obliguar. Po ashtu, edhe nëse atij i lejohet të amputojë veshin apo gishtin për shembull, e ka të ndaluar të aplikojë një gjë të tillë dhe bartë mëkatin për të. (3)

Muslimanët janë të një mendimit se nuk lejohet vetëvrasja, amputimi i organeve dhe shkaktimi dhimbje në vetvete. (4)

Vrasja është e ndaluar, All-llahu thotë: "Edhe ata që pos All-llahut, nuk lusin zot tjetër dhe nuk mbysin njeriun që e ka ndaluar All-llahu, por vetëm kur e meriton në bazë të drejtësisë, dhe që nuk bëjnë kurvëri, ndërsa kush i punon këto, ai gjen ndëshkimin. Atij i dyfishohet dënimi ditën e kiametit dhe aty mbetet i përbuzur përgjithmonë." (5)

Durimi gjatë dhimbjeve që e godasin njeriun është i obliguar, dhe nëse kërkon t'i

japë fund jetës së tij për shkak të tyre është njësoj si vetëvrasësi, kurse mjeku që i ndihmon e shoqëron atë në mëkat.

Madje edhe në ligjet që i kanë shpikur njerëzit në shtetet ku zbatohen ato, "vrasja e mëshirshme" ndalohet edhe nëse është me kërkesën e të sëmurit.

Pra, nuk ka dyshim se kjo vepër është haram, dhe nuk mendoj se në këtë çështje ka hapësirë për mendime të ndryshme mes muftive. Ajo është vrasje e ndaluar, kurse dhimbja nuk është arsye për ta lejuar. Xhundubi, radijallahu anhu, transmeton se Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem, tha: "një njeri u plagos dhe e mbyti veten, e Allahu, azze ue xhel, tha: "robi im e përshpejtoi vdekjen kurse unë ia ndalova Xhennetin" (6)

Allahu, azze ue xhel thotë: "mos mbytni veten tuaj (duke mbytur njëri-tjetrin). Vërtet, All-llahu është i Mëshirshëm për ju." (7) Ky ajet është teksti që e prenë këtë çështje, sepse përmendet arsyeja për ndalimin e vrasjes, e ajo është mëshira e Allahut ndaj robërve të Tij. Allahu po ashtu thotë: "mos e mbytni njeriun sepse mbytjen e tij e ndaloi All-llahu, përpos kur është me vend" (8)

Po ashtu është përmendur në një hadith se një njeri luftoi së bashku me Pejgamberin, sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem, derisa u plagos rëndë. Ai përshpejtoi vdekjen, andaj vendosi dorezën e shpatës në tokë, kurse thepin e saj në gjoks, u rëndua mbi të dhe e mbyti veten. Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem, tha: ai është në zjarr." (9)

Hani ibën Abdullah el Xhubejr

Kadi në gjykatën e Mekkes –Arabia Saudite

Shqipëroi: Agim Bekiri

Shënimet:

- | | | |
|---------------------|------------------------|------------|
| 1. Maide -120 | 2. El-muhal-la 10/471 | 3. |
| Tuhfetul meudud 136 | 4. Meratibul ixhma15 | 5. |
| Furkan, 68-69 | 6. Buhariu dhe Muslimi | 7. |
| Nisa -29 | 8. En'am- 151 | 9. Muslimi |

Rreziqet e zinasë

Zinaja është armiku kryesor i martesës. Është një nga mëkatet më të shëmtuara dhe të poshtra. Është shkatërrues për individin dhe shoqërinë dhe sjell sëmundje të panumërta, fizike, psikologjike, sociale, ekonomike dhe kështu me radhë.

Zinaja është kryerja e marrëdhënieve të palejuara seksuale vullnetarisht apo me vetëdije. (Në gjuhën e sotme shqipe, nëse një person kryen zina dhe është i martuar, vepra e tij quhet “kurvëri” dhe nëse ai nuk është i martuar, vepra e tij quhet “imoralitet”).

Një nga mëkatet më të shëmtuara

Zinaja është një nga mëkatet më të shëmtuara. Është e ndaluar nga besimet fetare përmes kohërave. Abdullah Ibën Mesudi ka transmetuar që një njeri e pyeti të Dërguarin e Allahut, sal-lallahu alejhi ve sellem: “O i dërguar i Allahut! Cili nga mëkatet është më i madhi tek Allahu?” Ai u përgjigj: “Shoqërimi i një partneri Allahut i Cili ju krijoi ju”. Ai e pyeti: “Çfarë vjen pastaj: “Ai ju përgjigj: “Vrasja e trashëgimtarëve tuaj nga frika se do të hanë me ju”. Ai pyeti: “Çfarë vjen pastaj?” Ai u përgjigj: “Kryerja e zinasë me gruan e komshiut (fqinji) tuaj”.

Islami jo vetëm që e ndalon zinanë por ndalon të gjitha gjërat që çojnë tek ajo. Allahu, subhanehu ve teala, ka thënë: “Mos ju afroni zinasë. Me të vërtetë është një gabim i madh dhe një rrugë e keqe”. Duke e bërë ndalimin vetëm “afirm”, ky ajet ndalon qartësisht çdo gjë që çon tek zinaja, të tilla si shikimi, prekja, puthja e kështu me radhë.

Nuk është një cilësi e besimtarëve

Në Suren el-Furkan, Allahu radhit një numër cilësish të besimtarëve të Tij të drejtë (robërit e të Gjithëmëshirshmit). Në vazhdim, Ai përmend zinanë, së bashku me shirkun dhe vrasjen, si të jenë midis gjynaheve më të mëdha që ekzistojnë dhe ata që i kryejnë ato meritojnë ndëshkime të dyfishuara në Ditën e Gjykimit: “Edhe ata që pos All-llahut, nuk lusin zot tjetër dhe nuk mbysin njeriun që ka ndaluar All-llahu, por vetëm kur e meriton në bazë të drejtësisë, dhe që nuk bëjnë kurvëri, ndërsa kush i punon këto, ai gjen ndëshkimin. Atij i dyfishohet dënimi ditën e kijametit dhe aty mbetet i përbuzur përgjithmonë.”. [Furkan:68-69]

Ky dyfishim i ndëshkimit është një tregues i seriozitetit të këtyre tre gjynaheve (shirkut, vrasjes dhe zinasë) dhe dëmit të madh që ata sjellin në shoqëritë njerëzore.

Humbja e besimit

Një person me iman të plotë do të ishte i vetëdijshëm për shikimin e Allahut mbi të. Ai do të frikësohej nëse nuk do i bindej Allahut, veçanërisht duke kryer një gjynah të madh siç është zinaja. Kryerja e një gjynahu të madh është një tregues i imanit të dobët, të paktën derisa ai është në procesin e kryerjes së tij.

Ebu Hurejre ka transmetuar që i Dërguari i Allahut ka thënë: “Një person i cili kryen zina nuk e kryen atë ndërsa ai është një besimtar (i plotë), e as që pi alkool kur ai e pi atë ndërsa ai është një besimtar (i plotë),

as një hajdut nuk vjedh ndërsa ai është një besimtar (i plotë)”.

Kështu, ndërsa është duke e kryer gjynahun e madh, një musliman është në një gjendje të njëjtë me atë të mosbesimit. Kur ai kryen zina, imani ngrihet nga zemra e tij dhe qëndron si re mbi kokën e tij. Vetëm pasi ai pushon së kryeri zinanë imani i vjen përsëri. Ebu Hurejre ka transmetuar që i Dërguari i Allahut ka thënë: “Kur një person kryen zina, imani i del jashtë derisa bëhet si një re (mbi të). Kur ai ndalon, imani i kthehet”.

Shpërblimi i madh për abstenuesit

Gjynahet janë zakonisht të shoqëruara me ngacmime të forta që i bëjnë ato të vështira për t'i rezistuar. Kur një besimtar frenohet nga të kryerit e një gjynahu, shpërblimi i tij shtohet me sasinë e ngacmimeve që ai përballet. Një i ri mund të ketë tre ndikime për tek zinaja, energjia dhe dëshirat rinore të tij, bukuria e një gruaje e cila e fton tek vetja e saj dhe statusi dhe influenca e saj. Nëse, për kundër gjithë kësaj, ai përmbahet dhe i frikësohet Allahut, ai do të meritojë shpërblimin më sublim.

Ebu Hurejre dhe Ebu Said el-Hudri kanë transmetuar që resulullahu salallahu alejhi ua selam ka thënë: “Shtatë lloje individësh Allahu do t'u bëjë hije në Hijen e (Arshit) Tij në atë ditë kur nuk do të ketë hije përveç (hijes) së Tij, një qeveritar i drejtë, një i ri i cili është rritur në dhurimin e Allahut, një njeri zemra e të cilit është e lidhur me xhamitë, dy njerëz që e duan njëri-tjetrin për hir të Allahut kështu që ata takohen dhe largohen për hir të Tij, një njeri i cili ftohet të kryejë zina nga një grua me status dhe e bukur dhe ai i përgjigjet: “Unë me të vërtetë i frikësohem Allahut” dhe një njeri i cili jep në bamirësi (aq fshehurazi) sa dora e tij e

majtë nuk e sheh se çfarë jep dora e tij e djathtë”.

Në anën tjetër, një person i cili kryen zina me ndikimin më të vogël meriton një dënim të dhimbshëm. Kjo vlen për një plak dëshira seksuale dhe energjia e trupit e të cilit nuk janë të mjaftueshme për të ofruar një ngacmim për të kryer gjynahun dhe megjithatë ai zhytet në ndyrësitë. Ebu Hurejre ka transmetuar se i Dërguari i Allahut ka thënë: “Gjenden tre individë që Allahu nuk do t'u flasë atyre në Ditën e Gjykimit, e as që do t'i pastrojë ata, e as që do t'i shikojë dhe ata do të kenë një dënim të tmerrshëm, një plak zinaqar, një mbret rrenacak dhe një i varfër arrogant”.

Urtësia e ashpërsisë së ndëshkimit për zinanë

Dikush mund të pyesë: “Pse është ndëshkimi i zinasë aq i rreptë dhe a nuk bie në kontradiktë me shpirtin mëshirues në Islam?” Përgjigjja ndaj kësaj është që ajo mëshirë duhet të ngrihet në nivelin e tërë shoqërisë dhe jo në një nivel individual. Një burrë i martuar që kryen zina është një person, i cili pasi Allahu ja ka garantuar atij mënyrën e lejuar për të shfryrë epshin e tij, ai vazhdon të ndjekë ndyrësirën e haramit. Ai me këtë i shkakton dëm familjes, moralit dhe prejardhjes së tij.

Kjo sjell pastaj përhapjen e sëmundjeve në shoqëri. Pastaj e kthen shoqërinë në një arenë korrupsioni ku veset më të liga bëhen më të dëgjuarat dhe lihen të lira për të shkatërruar atë shoqëri nga rrënjët e saj. Kur njerëzit e kuptojnë tmerrin e gjynahut të zinasë dhe ndëshkimin e saj të madh dhe poshtërujes, pak prej tyre do t'i afroreshin. Kjo është mëshira e vërtetë drejt tërë shoqërisë dhe jo mëshira false ndaj pak kriminelëve.

Ndëshkimi në varr

Ata të cilët kryejnë zina janë të ndëshkuar ashpërsisht në varrin e tyre gjithashtu. Në një hadith të gjatë, i dërguari i Allahut transmeton një ëndërr në të cilën ai pa sesi një numër gjynahqarësh po ndëshkoheshin në jetën e ndërmjetme të varrit el-berzah. Samurah bint Xhundub ka transmetuar që një mëngjes i dërguari i Allahut ka thënë: "Mbrëmë dy njerëz erdhën tek unë (në një ëndërr) dhe më thanë: "Eja me ne". Unë shkova me ta tek një vend i shenjtë. . . . ne vazhduam derisa erdhëm tek një vrimë në tokë që i ngjasonte një grope pjekjeje, e ngushtë në grykë dhe e gjerë në fund. Rënkime dhe zëra dilnin që aty. Ne vështruam dhe pamë disa gra dhe burra lakuriq. Nën gropë ishte një zjarr i ndezur, kurdo që ai ngrihej, ata bërtitnin dhe ngriheshin derisa ata gati nuk binin nga gropa. Kur ulej, ata uleshin (në fund). Unë i thashë: "Kush janë këta?" Ata më thanë:"Eja pas nesh!". . . . Unë i thashë: "Që me fillimin e kësaj nate ju më dërguat në vende të ndryshme dhe unë kam parë gjëra të çuditshme! Çfarë është e gjithë ajo që pashë?" Ata thanë: "Ne do ta tregojmë ty. . . . Përsa i përket grave dhe burrave lakuriq të cilët ishin tek gropa, ata janë burra dhe gra të cilët kanë kryer zina... dhe unë jam Xhibrili dhe ky është Mikaili. . . "

Vendosja e fakteve për zina

Përderisa zinaja është një gjynah i madh që meriton një ndëshkim të madh, Allahu ka ofruar një gjykim strikt për ndodhjen e saj. Nxjerrja e fakteve që një person specifik ka kryer zina mund të bëhet vetëm në një nga tri mënyrat, rrëfimi i qartë dhe absolut i fajtorit, ... ose dëshmia e katër personave të cilët e kanë parë të gjithë ndodhjen e zinasë, duke përfshirë fërkimin e organeve. Allahu thotë: "Ato nga gratë tuaja që bëjnë

imoralitet (zina), kërkoni që kundër tyre të dëshmojnë katër vetë prej jush (burra); nëse vërtetohet më dëshmitarë (imoraliteti), mbyllni ato në shtëpia derisa t'i marrë vdekja ose derisa All-llahu të përcaktojë ndonjë rrugë për to". [Nisa:15]

Kështu, tre ose më pak dëshmitarë nuk janë të mjaftueshëm për të provuar këtë gjynah të madh. Kjo është nënkuptuar nga akuzimi i muslimanëve për zina pa nivelin e lartë të sigurisë. Kushdo që akuzon një musliman se ka kryer zina pa nxjerrë katër dëshmitarë, është vetë i vënë para një ndëshkimi të tmerrshëm. Allahu thotë: "Edhe ata të cilët bëjnë shpifje për gratë e ndershme dhe nuk sjellin katër dëshmitarë, t'i rrahni ata me nga tetëdhjetë të rëna dhe atyre mos u pranoni dëshminë më kurrë. Të tillët janë të pabesueshëm. Me përjashtim të atyre që më vonë pendohen dhe përmirësohen, vërtet All-llahu është që shumë falë e mëshiron". [el-Nur:4-5]

Akuzimi me zina midis bashkëshortëve

Megjithatë, Allahu lejon një përjashtim në rastin e njerëzve të martuar që akuzojnë njëri-tjetrin. Nëse një burrë akuzon gruan e tij për zina, fjala e tij është e mjaftueshme nëse ai betohet katër herë për Allahun që ai është duke thënë të vërtetën dhe herën e pestë duke kërkuar mallkimin e Allahut nëse është duke gënjyer. Sigurisht që ajo nuk do ta konfirmojë gjynahun kundër saj përderisa ajo nuk hesht.

Nëse ajo dëshiron ta mbrojë veten....ajo duhet ta kundërshtojë thënien e tij duke u betuar katër herë që ai është një gënjeshtër dhe herën e pestë duke kërkuar mallkimin e Allahut mbi vete nëse ajo nuk është duke thënë të vërtetën. Allahu thotë: "Edhe ata të cilët bëjnë shpifje për gratë e ndershme dhe nuk sjellin katër dëshmitarë, t'i rrahni ata me nga tetëdhjetë të rëna dhe atyre mos u

pranoni dëshminë më kurrë. Të tillët janë të pabesueshëm. Me përjashtim të atyre që më vonë pendohen dhe përmirësohen, vërtet All-llahu është që shumë falë e mëshiron. Ndërsa ata të cilët shpifin për gra të veta dhe nuk kanë dëshmitarë tjetër përveç vetes dëshmimi i çdonjërit prej tyre është: të betohen katër herë në All-llahun se ai e thotë të vërtetën. E pesta (herë e betimit) është: mallkimi i All-llahut qoftë mbi të, nëse gënjen. E nga ajo (gruaja e shpifur) largohet dënimi, nëse katër herë betohet në All-llahun se ai (shpifësi) gënjen. E pesta herë e betimit të jetë që ta godis hidhërimi i All-llahut, atë (gruan) nëse ai, ka qenë i vërtetë. Dhe sikur të mos ishte dhurata dhe mëshira e All-llahut ndaj jush (ju do të mbaronit). Pa dyshim All-llahu pranon pendimin është i gjithëdjishëm”. [en-Nur:4-9]

Gjynahu i akuzimeve false për zina

Nuk është një gjynah i vogël për të akuzuar besimtarët për vese pa një fakt të fortë. Kur vesi është në madhësinë e zinasë, akuzimi fals është një gjynah i madh që meriton një ndëshkim në të dyja jetët. Allahu thotë: “Vërtet, ata që akuzojnë gratë e ndershme, besimtare të pafajshme, janë të mallkuar në këtë botë dhe në botën tjetër dhe ata i pret një dënim shumë i madh”. [en-Nur:23]

Akuzimet e pakujdesshme dhe të pavërifikuara çojnë në përhapjen e zërave në shoqëri. Ajo i bën gjynahet të zakonshme në mendjet e njerëzve të zakonshëm, të cilat pastaj rrjedhimisht i çojnë ata të pranojnë dhe të gëzohen me çdo informacion që marrin. Kjo ka qenë arsyeja që Allahu ka

vendosur një limit të fortë për përhapjen e akuzimeve dhe shpifjeve, veçanërisht në rastin e zinasë dhe është e konsideruar si një rrugë për përhapjen e imoralitetit midis besimtarëve. Allahu thotë: “Ata, të cilët dëshirojnë që te besimtarët të përhapet imoraliteti, ata i pret dënim i dhembshëm në këtë dhe në botën tjetër. All-llahu di (të fshehtat) e ju nuk dini”. [en-Nur:19]

Largimi nga ata që kryejnë zina

Besimtarët e vërtetë kurrë nuk e konsiderojnë martesën me një person i cili njihet si zinaqar. Vetëm një zinaqar si ai (ose ajo) ose një ateist, mund ta konsiderojë një marrëdhënie të tillë. Shoqëria e besimtarëve të vërtetë largohet dhe i braktis ata të cilët janë zinaqarë, derisa ata qartësisht dhe në mënyrë demonstrative pendohen dhe reformohen në sjelljet e tyre. Allahu ka thënë: “Laviri nuk do të duhej të martohej me tjetërkë, pos me ndonjë lavire ose idhujtare, e lavirja me të nuk do të duhej të martohej kush, pos ndonjë lavir o idhujtarë. Ajo (kurvëria ose martesa me të) është e ndaluar për besimtarët”. [en-Nur:3]

Individ të ndyrë, fajtorë për zina meritojnë vetëm partnerë të ndyrë si vetja e tyre. Në anën tjetër, individ të pastër dhe të mirë meritojnë individ të mirë si vetja e tyre. Allahu thotë: “Të këqijat (gra ose fjalë) janë për të këqinjët edhe të këqinjët janë për të këqijat, ndërsa të ndershmet janë për të ndershmit edhe të ndershmit janë për të ndershmet. Ata janë të pafajshëm nga ajo që u thonë atyre. Ata kanë falje të madhe dhe furnizim të begatshëm”. [en-Nur:26]

Muhammed el-Xhibali
Përktheu: Ammar Ardit Kraja

Artistja dhe udha e saj drejt dritës

Es-selamu alejkum ue rahmetullahi ue berekatuhu: Motra juaj, Emet All-llah, muslimane kanadeze, merrem me artin e ngjyrosjes së xhamave.

Kam filluar udhën time drejt Islamit që para dy vjetësh apo pak më shumë, pikërisht në një prej netëve të shkurtit të vitit 2003, kur isha vetëm në shtëpi. Më erdhi në mendje xheneti dhe zjarri, vendbanimi i njeriut, udhëtimi i tij në këtë dynja dhe përfundimi i tij në fund. Mendova se njeriu mund të jetojë pak, prandaj duhet që të bëjë diçka për përfundimin e tij, e të bëjë ç'është e mundur që të ndihmojë të tjerët. Gjithashtu duhet që të adhurojë All-llahun si Krijues. Fillova të qaja dhe të falja namazin e të krishterëve. E luta All-llahun që të më ndihmojë që ta (shërbej atë) gjatë gjithë jetës që më ka mbetur. Vendosa që nga ai moment të bëhem katolike e sinqertë.

Mendova të studioj Ungjillin, dhe të lidhem më shumë me kishën. Pastaj, mbasi qava gjatë dhe ndjeva se u afrova drejt All-llahut, shkova të flija.

Dy ditë pas kësaj ngjarje, ra zilja e derës (nuk kisha dëgjuar për Islamin akoma porse kisha dëgjuar për muslimanët, dhe nuk kisha takuar asnjë musliman apo muslimane më parë).. pashë para syve një grua muslimane e veshur me hixhab. Mendova se kjo veshje është nga zakonet dhe traditat e vendit të saj, dhe kultura e këtij vendi. Kërkoj prej meje xham të vizatuar me zbukurime Islame. Ngaqë nuk dija zbukurime Islame fillova të kërkoja për to në Internet.

Kur e shkrova emrin "Islam" në katrorin e kërkimit më dolën disa faqe Islamike. Fillova t'i lexoja e i harrova zbukurimet!! Fillova të kërkoja më shumë, e të mësoja, ndjeva se kjo

është fe e saktë. Besova se ka vetëm një "ZOT" porse nuk kisha dëgjuar më parë për të Dërguarin e All-llahut, salall-llahu alejhi ue selem. Ndjeva kënaqësi të pakufishme dhe lumturi të papërshkruar, dhe dëshirë për sa më shumë lexim, ku nuk munda të përmbahem.

Menjëherë bleva disa libra; një kopje nga Kur'ani dhe përkthime të tij. Ato që lexova për Islamin më afruan shumë, për të cilën falënderoj All-llahun.

Pa kaluar akoma muaji maj i të njëjtit vit, mora në telefon një prej xhamive, ku me pak frikë shkova të shfaq Islamin, në të cilën xhami dëshmoja dy dëshmitë e vërteta (shehadetin). Atje takova një prej thirrësve, e cila më dha tefsirin e xhuzit të 30-të të Kur'anit, dhe një libër të shpjegimit të akides Islamike. Dola nga xhamia sikur kisha lindur për së dyti. Muslimane pa asnjë gabim apo gjynah, ky është rast në favorin tim që të jetoj nën bindjen e All-llahut dhe ta adhuroj me adhurimet më të mira.

Oh sa e mrekullueshme është të gjesh të vërtetën dhe oh sa madhështore është kjo fe!!

Qysh në hapin e parë të futjes në Islam, ndjeva se mora përsipër detyra të reja dhe përgjegjësi të mëdha, fillimisht ndaj vetes, e së dyti ndaj të tjerëve, që t'i shpëtoj nga tmerrri i errësirave..

Fillova që të njihja farzet e Islamit, e të mësoja abdesin, pastrimin, namazin dhe hixhabin sipas sheriatit. Namazin e fal rregullisht qysh në futjen në Islam uelilahil hamd uel min-neh.

Jetoj në një qytet të vogël, prandaj kur dilja me hixhab tërhiqja vështrimet e të tjerëve. Më kujtohet që vishja hixhabin, pak flokë më dukeshin dhe vendosja të kuq buzësh lehtë.

Në fillim më zuri frika nga fjalët e njerëzve në qytetin tim, e kur u ktheva në shtëpi: hapa librin (mësimi i akides islame), në të cilin lexova se njeriu nuk duhet të ketë frikë vetëm se prej All-llahut të madhëruar. Në momentin kur e lexova këtë, më zuri një lumturi e madhe, sepse mësova se duhet të kem frikë vetëm prej All-llahut të madhëruar, Zotit të botëve e të mos frikësohem prej fjalëve të askujt prej njerëzve. Qysh nga ky moment e veshja hixhabin plotësisht me gjithë nikab (perçe). Edhe pse jetoj në këtë qytet të vogël, ku nuk ka shumë muslimanë e ku veshja ime e nikabit konsiderohet shumë e vështirë dhe kërkon vullnet.

Porse, Elhamdulillah, munda që t'ia dal mbanë, sepse unë fillova që të mos ua vë veshin disa komenteve të kota me të cilat tallen me mua. Pra falënderimi i takon All-llahut, i Cili më zgjodhi dhe më ndihmoi që të jem robëreshë e Tij dhe të përfaqësoj fenë e Tij të pastër.

Me ndjenjën se tani përfaqësoj Islamin në fshatin tim, u shtuan përgjegjësitë. Kalova një kohë të gjatë në studime. Nga fundi i muajit qershor takova një grup motrash, takim i cili u ndërtua nga ftesa që më bëri një motër, të cilën e takova në xhami ditën që shfaqta dëshminë. Ftesën ma çoi nëpërmjet postës elektronike (email-it) për të marrë pjesë në një festë islamike. Mora pjesë dhe e takova motrën, e cila ishte shumë bujare. Më ftoi që të merrja pjesë në disa mbledhje islamike në shoqërimin e saj.

Dhe ashtu ndodhi, shkova dhe u kënaqa shumë me këto mbledhje, porse gjeta se kjo nuk është mënyra shembullore për mësimin e fesë Islame.

Fillova që të pyesja për kërkimin e dijes, derisa gjeta një dijetar nga dijetarët e mëdhenj i cili studion sheriatin. Fillova të shkoj e të marr pjesë rregullisht më shumë se një vit (sepse mësimi i sheriatit është gjëja

më e rëndësishme për mua). Mësova akiden me argumente të plota e të sakta. Sikur të mos ishte kjo, do të kisha rënë në bidate, si unë dhe si shumë prej muslimanëve, të cilët i kam takuar, edhe pse nijetin e kanë për të ndihmuar. Porse ka prej tyre, të cilët filluan të më mësonin Islamin sipas zakoneve të tyre, dhe bidateve e gabimeve të përhapura, në të cilat kanë rënë shumë prej muslimanëve. Prandaj i këshilloj muslimanët kudo qofshin, në çdo cep të dynjasë, që të korrigjojnë akiden e tyre pikësepari në mënyrë që të përhapin saktë fenë e tyre.

Ai i cili e ka humbur këtë prej tyre, natyrisht do ta përhapë islamin të paqartë, sepse ai i cili nuk ka dije mbi diçka, nuk ka se si të ftojë për në të.

Unë tani po mësoj gjuhën arabe dhe kam mësuar disa sure nga Kur'ani, ku përkrah kësaj, mësoj edhe texhuidin dhe falënderoj All-llahun e madhëruar për këtë mirësi, edhe pse mësimi i gjuhës arabe është gjëja më e vështirë që po has.

Duke u mbështetur mbi besimin për përgjegjësi ndaj Islamit, edhe pse kjo është detyrë për mua, fillova të bëj dave me veten dhe veprat e mia ku mora pjesë vullnetarisht në një prej kampeve të dëbuarve në Toronto, i cili është 45 minuta me makinë, larg shtëpisë sime. Ku unë jam muslimanja e vetme, e cila marr pjesë vullnetarisht në këtë aktivitet. Me thënë të drejtën, të gjithë vullnetarët atje më presin shumë mirë. Gjithashtu mua mu dha rast veçimi në veshje dhe veshja e nikabit që të sqaroj veshjen e kësaj dhe njësimin e All-llahut të madhëruar dhe bisedë për Vulën e të Dërguarve, Muhamedin, salall-llahu alejhi ue selem. . .

All-llahu e di se sa u gëzova për përhapjen e Islamit nëpërmjet veprave të mira kundrejt nevojtarëve, të cilat dhanë frute, Elhamdulillah, të mira. Një prej pjesëtarëve të këtij kampi, i cili është 80 vjeç, u interesua për Islamin ku mori

pjesë me mua në xhami tre herë. E një tjetër pranoi Islamin. Shumë prej pjesëtarëve të kampit tani kanë njohuri mjaft të mira mbi Islamin, ku më parë nuk dinin për të asgjë. Me gjëra shumë të pakta mundem që të përhap Islamin ndërmjet nevojtarëve, si shembulli i këtyre pjesëtarëve të këtij kampi. Si p.sh.; nëpërmjet butësisë, dhe ndodhjes së disa pajisjeve të domosdoshme si batanije, ushqim, para etj. Ku u fut edhe një person tjetër në Islam sapo pyeti për mësimin e tij. Unë e kam ndërmend gjithmonë mësimin e Islamit nevojtarëve menjëherë sapo të marrin ndihmat e para. Duke u nisur nga kjo filluan të më ndihmonin disa motra në këtë aktivitet humanitar gjithashtu edhe prej bijve të mi ata që pranuan Islamin.

Me thënë të drejtën All-llahu i madhëruar më dhuroi mua që të ftoj familjen time në Islam. Ku unë jam e ndarë nga bashkëshorti. Dhe dola me sukses në thirrjen për në rrugë të All-llahut, të fëmijëve që janë me mua. Tani, Elhamdulillah, djali im, i cili është 14 vjeç tha dëshminë, masha' All-llah. Edhe vajza e vogël falet me ne, e do të veshë hixhabin insha'All-llah...

E lumturia arrin skajet e saj kur ne të tre falemë së bashku dhe adhurojmë All-llahun së bashku. Tani vajza ime e madhe akoma nuk e ka pranuar Islamin, porse Insha'All-llah do ta pranojë një ditë prej ditësh. Më parë thoshte se është e krishterë, ndërsa tani thotë se nuk është siç ishte më parë, dhe se ajo tani beson në njëshmërinë e All-llahut dhe për vulën e Pejgamberëve, salallahu alejhi ue selem. Kam një djalë i cili jeton me babain e tij, e ai e kundërshton pranimin e Islamit, porse Insha' All-llahu do të bëhet musliman..

Gjithmonë bëj dua për të dhe për të tjerë që All-llahu ti udhëzojë ...

Ndërsa babai im ka histori më vete me të cilën dua të përfundoj me ju këtë bisedë...

Babai im pranoi Islamin gjithashtu nga fundi i muajit Qershor. Është nga personat më të kapur për fe dhe më të turpshëm që kam njohur, ai adhuronte një Zot gjatë gjithë jetës së tij. Porse mendimet e tij ishin të çrregullta. Edhe ai gjithashtu nuk ka ditur asgjë mbi Islamin, e as mbi vulën e Pejgamberëve, salallahu alejhi ue selem. All-llahu e ndihmoi dhe e udhëzoi për në Islam, shqiptoi shehadetin. Mbas disa ditësh shkova me të tek doktori që të bënte vizitë, ku na doli se kishte kancer në gjak. Ditën e diel babai im u sëmur shumë, e çuam në spital dhe vdiq mbas 14 ditësh.

Elhamdulillah vdiq në formë të mirë, ku e llogaris, insha'All-llah, me përfundim të mirë. Ai nuk mundej që të fliste, porse vazhdimisht merrej me tesbih dhe thënien e shehadetit, qëndrova pranë tij gjatë gjithë kësaj kohe. Fjeta me të në dhomën e tij, ku vazhdimisht vija kasete me Kur'an dhe vetë i lexoja Kur'an. Në momentet e frymëmarrjes së fundit ishte duke përmendur All-llahun, e vdiq në këtë mënyrë... Falënderoj All-llahun e madhëruar, i cili e shpëtoi në duart e mia nga Zjari..

Në fund dua të them se: Secili prej nesh është përgjegjës për veten dhe për të tjerët, dhe për fenë e All-llahut të madhëruar. Duhet që të përhapim fenë e All-llahut të madhëruar, e të emigrojmë për tek All-llahu i madhëruar. Ne e dimë se nuk jemi melaike e as pa gjynahe, porse t'i pranojmë gjynahet e të lusim All-llahun e madhëruar të na i falë. Unë e di, se sot nuk jam siç isha atë ditë që u futa në Islam, ku atë ditë isha sikur atë ditë që më lindi nëna pa asnjë gjynah, porse e lus All-llahun e madhëruar të më falë, e të më ndihmojë që të punoj, që ti shërbej Islamit derisa ta takoj Atë dhe Ai të jetë i kënaqur prej meje...Ues-selamu alejkum e rahmetullahi ue berekatuhu. Motra juaj, shërbyesja e Islamit, (EmetAll-llah)

Marrë nga: Islamway.Com Përktheu: F.Gurra

Ahmed Didat

Në mëngjesin e herët të 8 Gushtit 2005 (2 Rexheb 1426 H) ndërroi jetë dijetari dhe thirrësi i njohur Ahmed Hoosen Didat. Kjo ishte fundi i sëmundjes nëntëvjeçare që e la të lidhur për shtrat gjatë së cilës nuk e ndërpreu punën si thirrës që inspironte, edukonte, sfidonte dhe i informonte njerëzit për mesazhin universal të Islamit. Me këtë rast përshëndesim dhe falënderojmë këtë hero të botës Islame për punën e tij të mrekullueshme si dhe për trimërinë që shfaqti gjatë thirrjes dhe debatimeve.

Ai me të vërtetë ishte trim i besimtarëve në tërë globin.

Shejhi Ahmed Didat është lindur më 1 Korrik të vitit 1918 në krahinën Surat të Indisë. Në moshën nëntëvjeçare së bashku me familjen e tij shpërngulen në Afrikën e Jugut ku paraqitet si nxënës i dalluar gjatë shkollimit. Mungesa financiare u bë shkak që ai të ndërpriste shkollimin në moshën gjashtëmbëdhjetë vjeçare duke filluar me punë për të siguruar kafshatën e bukës.

Pasi që lexoi librin *Idharul Hakk* ku në fakt bëhet fjalë për debat mes Islamit dhe krishterimit që e prezantonin misionarët e Anglisë në Indi, vendosi të ndërmerre aktivitete që do ta ndalnin valën e misionarëve kishtar.

Shkaqet më kryesore që e nxitën atë të bëhej mbrojtësi i Islamit, e kanë rrënjën në vitin 1936 kur ai punonte në një dyqan që ishte afër një qendre misionare e krishterë, nga e cila i vinin misionarët në dyqan dhe e provokonin duke ia sulmuar Islamit.

Ai thotë se atëherë nuk ka ditur asgjë më tepër për Islam se sa që ai e ka emrin Ahmed, fal namaz, agjëron, nuk e ha mishin e derrit, nuk pi alkool, dëshmon se nuk ka Zot tjetër përveç Allahut (La ilahe il-lall-llah) dhe se Muhammedi është i Dërguari i Tij, etj.

Gjatë katër dekadave që vijonin e angazhoi veten në shumë aktivitete, ligjërata, debate dhe veprimtari shkrimtare. Në Afrikën e Jugut në qytetin Braemar hapi seminarin e parë për përgatitjen e thirrësve. Ai gjithashtu është themelues i organizatës së njohur botërore për thirrje në Islam I.P.C.I. (Islamic Propagation Center International) Qendra Ndërkombëtare për Thirrje në Islam me seli në Durban-Afrika e Jugut.

Ka botuar mbi njëzet tituj si dhe ka bërë distribuimin falas të miliona kopjeve të librave në tërë botën. Librat e tij janë përkthyer në shumë gjuhë të botës: rusisht, urdu, arabisht, frëngjisht, holandisht, zulu, shqip, japonisht, kinezisht, në gjuhën malajo, indonezish si dhe në shumë gjuhë të tjera.

Ka organizuar ligjërata dhe debate në shumë vende të botës ku me sukses të madh u ballafaqua me misionarët më të njohur të botës së krishterë. Incizimet e këtyre ligjëratave janë përhapur në shumë vende të botës në gjithë video formatet. Gjatë jetës së tij vizitoi kontinentet e botës dhe sfidoi krerët e botës protestante dhe kreun e kishës katolike papën Gjon Pali i dytë. I ishte ndaluar hyrja në Francë dhe

Nigeri me pretekst se do të shkaktonte rrëmujë civile.

Më 1986 u shpërblye me Çmimin e Mbretit Fejsal (të Arabisë Saudite) për shërbimet që ia bënte Islamit në fushën e Da'ves (thirrjes).

Nga librat që shkroi do të përmendim:

Al-Qur'an the Miracle of Miracles

Arabs & Israel - Conflict or Conciliation?

Christ in Islam

Combat Kit Against Bible Thumpers

Crucifixion or Cruci-Fiction?

How Rushdie Fooled The West

Is the Bible God's Word?

Muhammad The Greatest

The Choice-Islam & Christianity-Vol. 1

The Choice-Islam & Christianity-Vol. 2

What The Bible Says About Muhammad

What was the Sign of Jonah?

Who Moved the Stone?

Në gjuhën shqipe janë përkthyer këto libra:

50 000 gabimet e Biblës

Zoti që kurrë s'ka ekzistuar (ku mohohen cilësitë hyjnore të Isait me tekste të Biblës).

Allahu e mëshiroftë dhe e shpërbleftë me xhennetet e Tij më të larta. Amin!

Përgatiti: Talha Kurtishi

Emin Limani

Imam Shu'be ibën El Haxh-xhaxh

Emiri i hadithit, Hafidhi, Imami, njeriu që ngriti lart standardet e shkencës së hadithit, dijetari i Basras dhe mësuesi i saj. Askush në kohën e tij nuk ishte më i ditur se ai në lëmin e hadithit...

Në librat e hadithit shpeshherë përmendet vetëm me emrin e parë Shu'be sepse ishte shumë i njohur dhe nuk ka pasur nevojë që të përmendet prejardhja e tij.

Emri i plotë: Quhet Shu'be ibën Haxh-xhaxh ibën El Verd Ebu Bistam El Ezdi El Ateki El Vasiti El Basri.

Lindi në fshatin Nehrul Bustan në afërsi të Vasitit, qytet në jug të Irakut në vitin 82 H ose 83 H (701 G) ku edhe ndjek mësimet e para, para se të shpërngulet në qytetin e Basras. Pas vdekjes së babait i cili ishte i interesuar që djali i tij të mësonte hadithet e të Dërguarit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, nëna e tij vazhdon edukimin e tij duke e dërguar atë tek mësuesit ku do të mësojë.

Vetë Shu'beja rrëfen: Një ditë nëna më tha: Këtu është një grua që ka dëgjuar hadithe prej Aishes, radijall-llahu anha, eja dhe dëgjoji prej saj hadithet që ajo i transmeton. Ajo quhej Shumejse Ummu Seleme.

Kërkimin e dijes e filloi duke i dhënë rëndësi gjuhës dhe letërsisë arabe. Mësoi përmendësh shumë libra të poezisë dhe nxënësit e vet i këshillonte të mësonin gjuhën arabe nëse dëshironin të mësonin mirë hadithin e të Dërguarit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem. El Esme'i, dijetari kryesor që dokumentoi poezinë arabe shpeshherë merrte pjesë në tubimet e Shu'bes duke shpresuar se do të dëgjonte diçka të re nga lëmi i tij. Pas gjuhës, ai iu përkushtua tërësisht hadithit pasi që dëgjoji El Hakem ibën Utejben, i cili hadithet i transmetonte me zinxhirin e transmetuesve, gjë kjo e cila i pëlqeu shumë.

Duke e praktikuar traditën e dijetarëve të hadithit, Shu'be udhëtoi shumë. Në një udhëtim për në Medine në vitin 118 H u ul për të mësuar para Imam Malikut i cili ishte më i ri se ai (kishte 27 vjet). Në kërkim të dijës udhëtoi edhe në Bagdad dy herë. Në një prej këtyre udhëtimeve mësoi 4000 hadithe gjatë 40 takimeve që i pati me dijetarët.

Thoshte: Asgjë nuk është më e këndshme se ulja me dijetarët në tubim ku njerëzit përfitojnë njëri nga tjetri. Në një udhëtim për t'u siguruar për vërtetësinë e një hadithi udhëtoi prej Basras në Kufe dhe pastaj në Mekke. Ai nuk e transmetonte asnjë hadith për të cilin nuk ishte i sigurt. Pasi u kthye në Basra, kuptoi se njëri prej transmetuesve të hadithit në fjalë nuk ishte i besueshëm.

Mësoi para shumë imamëve të tabi'inëve numri i të cilëve arrin katërqindëshin.

Mësues të tij ishin: Maliku, Davud ibën Ebi Hindi, A'meshi, Mensur ibën Mu'temiri, Ejjubi dhe Sa'd ibën Ibrahim, kadiu i Medinës.

Ibën Hibban kështu e përshkruante: Imami i besueshëm dhe i sigurt, dijetari i madh dhe i devotshëm që mjaftohej me pak. Ai që më së miri i bashkoi veprën dijës...

Sufjani: Ai është Emir i hadithit.

Imam Shafi'iu: Po të mos ishte Shu'beja banorët e Irakut nuk do ta njihnin hadithin.

Ebu Davud Et Tajalisi: Prej Shu'bes kam dëgjuar 7000 hadithe.

Jetonte një jetë modeste dhe thoshte: Më mjafton për jetë, mielli dhe kallam sheqeri.

Kur njërit prej nxënësve ia pa një këmishë që ai e kishte blerë 8 dërhëm i tha: A nuk ke frikë All-llahut të vishesh me këmishë kaq të shtrenjtë? Pse nuk e bleve një këmishë prej

katër dërhëmësh e ato që mbesin t'ua japësh të varfërve?!

Ebul Velid Et Tajalisi: Nuk kam parë njeri më bujar se Shu'be.

Ejjub Es Sihtijani thoshte: Nëse ju vjen Shu'be merrini hadithet e tij sepse ai është kalorës i hadithit.

Thoshte: Po të mos ishin nevojtarët nuk do të ulesha me të pasurit.

Hamze Et Tusi: Nga adhurimi i shumtë i është tharë lëkura.

Ishte zemërbutë dhe nuk e kthente lypësin.

Duke u frikësuar nga mossinqeriteti thoshte: Shpeshherë mendoj se për mua do të ishte më mirë të punoja si nxehës i ujit në banjat publike (hamamet) se sa të tuboja hadithet.

Dhehebiu duke i komentuar këto fjalë thotë: çdonjëri që analizon nijetin nga kërkuesit e dijës frikësohet nga kjo gjë dhe shumica e tyre shpresojnë prej All-llahut që dija e tyre të mos bëhet argument kundër tyre.

Shpeshherë shkonte te njerëzit që ishin të dobët në transmetimin e hadithit dhe u thoshte: Mos transmetoni hadithe...

Thoshte: Që të hidhem prej qiellit në tokë është me lehtë për mua se sa të bëj tedlis (të transmetoj hadithin duke e fshehur emrin e vërtetë të mësuesit prej të cilit e ka dëgjuar hadithin).

Nga ky dijetar përfituan shumë kërkues të dijës të cilët Abdull-llah ibën Mende i shënoi në libër me një nga transmetimet e tyre. Që të mos e rëndojmë tekstin me emra nuk do të përmendim asnjë prej tyre.

All-llahu e mëshiroftë me mëshirën e tij të gjerë. Amin.

Talha Kurtishi

Burimi kryesor: Sijer El A'lam En Nubela

Hafsa bint Sirin

Dijetarja e hadithit, Hafsa bint Sirin. Transmetimet e saj i kanë shënuar gati të gjithë përmbledhësit e hadithit. Për këtë shkak Imam Dhehebiu pranë emrit të saj ka shënuar shkronjën (Ajn) (ع) shenjë që do të thotë se transmetimet e saj gjenden në gjashtë librat bazë të hadithit-elkutubus-sitte (السنة الكتب)

Emri i plotë: Hafsa bint Sirin Ummu Hudhejl El Ensarije El Basrije. Është dijetare e gjeneratës së dalluar të tabi'inëve. Mësoi Kur'anin në moshën dymbëdhjetë vjeçare. Gjatë kërkimit të dijes ka pasur fatin të mësojë nga shumë dijetarë nga mesi i të cilëve do të përmendim:

Enes ibën Malik, radijall-llahu anhu, vëllai i saj Jahja ibën Sirin, Ummu Atijje El Ensarije, Er Rebab Umm Revaih, Ebul Alije, Ebu Dhibjan Halife ibën Ka'b, Er Rebi' ibën Zijad El Harithi, El Hajre nëna e Hasan El Basriut

Ibën Me'ini ka thënë: E besueshme (eth-thika) dhe autoritet në lëmin e hadithit.

Ibën Hibbani e ka përmendur në mesin e transmetuesve të besueshëm (الثقات)

Për vlerën e saj Ijas ibën Mu'avijje thotë: Nuk jam takuar me dijetar të cilit i jap përparësi para saj (Hafsas). Kur ia përmendën Hasanin dhe Ibën Sirinin përsëri tha: Asnjërit nuk i jap përparësi para saj.

Mehdi ibën Mejmun thotë: Plot tridhjetë vjet nuk doli prej dhomës ku falej përpos për nevojë dhe gjumë.

Nga kjo dijetare mësuan shumë bartës të sunnetit: Muhammed ibën Sirin, Katadeja, Asim El Ahvel, Ejjubi, Ibën Auni, Hisham ibën Hassani, Halid El Hadhdha' dhe të tjerë.

Jetoi shtatëdhjetë vjet . Ndërroi jetë në vitin 101 H.

All-llahu e mëshiroftë me mëshirën e Tij të gjerë.

Talha Kurtishi

Burimet kryesore:

Tehdhibut Tehdhib, vëll. 6 fq. 536

Sijer A'lam En Nubela, vëll.4, fq. 507

Imam ibën Ebil Izz el Hanefi

Emri dhe prejardhja e tij: Ai është Imami, Al-lameja Sadruddin Ebul Hasen Ali ibën Alauddin Ali ibën Shemsuddin Ebu Abdil-lah ibën Sherefuiddin Ebul Berekat Muhammed ibën Izzuddin Ebil Izz ibën Vuhejb ibën Ata ibën Xhubejr ibën Xhabir ibën Vehb El Edhrei, Ed Dimeshki, El Hanefi i njohur me nofkën Ibën Ebil Izz.

Prejardhja e tij është prej krahinës Edhrean, fshati Salihijje, në jug të qytetit Damask. Stërgjyshi i tij Muhammed ibën Ebil Izz është lindur në Damask, fakt ky nga cili kuptojmë që familja e tij është shpërngulur nga fshati Salihijje në Damask.

Fshati i tyre Salihijje ka qenë qendër e dijes në kohën e Memalikëve, gjë kjo për të cilën flasin shumë burime historike si libri i Ibën Batutasë, i cili këtë fshat e vizitoi në vitin 728 H.

Lindja e tij: Ka lindur më 22 Dhul Hixhxe të vitit 731 H në familje të njohur për dije, devotshmëri dhe famë në qytetin e Damaskut.

Baba i tij ka qenë gjykatës (kadi) dhe hatib në xhaminë El Efrem post ky (gjykatës) të cilin e ka ushtruar edhe gjyshi i tij Muhammedi i cili gjithashtu ka qenë dijetar i njohur i Hanefitëve.

Stërgjiysi i tij, i cili gjithashtu quhej Muhammed, përpos postit të kadisë ishte edhe mësues në medresenë Murshidijje.

Edhe shumë nga kushërinjtë e tij ishin dijetarë dhe si shembull do t'i përmendim: Kryekadiun Sadruddin Sulejman ibën Ebil Izz, Muhammed ibën Sulejman ibën Ebil Izz, Jusuf ibën Muhammed ibën Ebil Izz, Ismail ibën Ebil Berekat dhe shumë të tjerë.

Në kërkim të dijes:

Koha në të cilën jetoi Ibën Ebil Izz është periudha në të cilën thirrja e Shejhul Islam Ibën Tejmijjes ishte në kulminacion. Ajo kohë dallohej me dijetarë të njohur, me personalitete të forta, prijë të shumta dhe veprimtari të gjerë dhe të llojllojshme...

Tek këta dijetarë mësoi Ibën Ebil Izz, i cili pasoi traditën e vjetër të uljes para dijetarëve për të mësuar libra të ndryshëm nga lëmi të ndryshme.

Burimet historike nuk japin shumë informata për mësuesit e tij. Ajo që me siguri dihet që ka mësuar nga familja e tij dhe dijetarët e kohës së tij.

Ajo që gjithashtu dihet, është edhe fakti se në formimin e tij kanë ndikuar shumë edhe dy nxënësit e Ibën Tejmijjes; Ibën Kajjim El Xhevziije dhe Ibën Kethiri, All-llahu i mëshiroftë.

Ndikimi i këtyre se bashku me mësuesin e tyre shihet qartë në komentimin e tij që ia ka bërë Tahavijjes, ku shpeshherë përmend fjalë të këtyre dijetarëve, pa përmendur emrat e tyre për shkak të rrethanave të atëhershme politike.

Në vitin 748 H u emërua si mësues në medresenë Kajmazijje dhe më vonë emërohet si gjykatës i Damaskut dhe Egjiptit.

Nxënësit e tij nuk përmenden në burimet që na kanë arritur tek ne përpos Ibën Ed Dirit për të cilin Imam SeHAVIU thotë që ka marrë ixhazet prej Ibën Ebil Izz El Hanefiut.

Duke e shpjeguar metodologjinë që e ndjekë ai, ka shkruar: "Obligimi i atij që kërkon dije të dobishme është të mësojë

përmendësh Kur'anin duke i analizuar kuptimet e tij. Të njëjtën duhet të bëjë edhe me Sunnetin, nga burimi i të cilit duhet të pijë derisa ta asgjësojë etjen. Për t'i kuptuar mirë fjalët e All-llahut dhe hadithet e të Dërguarit le t'i ndihmojë vetes më mësim të gjuhës dhe të komentimeve që i kanë dhënë tre gjeneratat e para që i ka lavdëruar i Dërguari i All-llahut, sal-lallahu alejhi ue sel-lem duke filluar prej gjeneratës më të zgjedhur, shokët e tij, as'habët..." (El Ittiba' fq.88)

Për shkak të kritikës që i bëri Ibën Ejbekit në poezinë e tij (në të cilën ky i fundit përkrauan të Dërguarin, sal-lallahu alejhi ue sel-lem, me cilësi që i takojnë vetëm All-llahu!) u shkarkua nga të gjitha postet, u dënua dhe u burgos katër muaj.

Pas burgut qëndroi pa punë zyrtare në shtëpinë e tij deri në vitin 791 H kur me letër iu drejtua emirit Sejfuddin Jalbuga që t'i ktheheshin vendi i punës në medresenë El Xheuherijje si dhe privilegjet që i ka gëzuar para burgimit, gjë kjo e cila me urdhër të emirit u realizua përkundër orvatjeve të pengohet nga Ali El Ekber, i cili në atë kohë ishte drejtues i medresesë në fjalë. Deri në fund të jetës punoi si mësues në atë shkollë dhe si hatib në xhaminë El Efrem.

Veprat e tij:

1. Sherh El Akide Et Tahavijje (e botuar)
2. Risaletul Ixhabeti ala Mesail Fikhijje (e humbur)
3. Et Tenbih ala Mushkilat El Hidaje (e humbur)
4. En Nur El Lami' ala ma ju'mel bi fil Xhami' (e humbur)
5. El Ittiba' (e botuar)

Fundi i jetës: Në Dhul Ka'de të vitit 792 H ndërroi jetë ky dijetar dhe u varros poshtë kodrës Kasion në Damask. All-llahu e mëshiroftë më mëshirën e Tij të gjerë.

Talha Kurtishi

Muaji Shaban – Rregulla dhe dispozita

Falënderojmë All-llahun, i Cili na e ka plotësuar fenë, na i ka plotësuar dhuntitë, kurse paqë dhe bekimi qofshin mbi Pejgamberin, Muhammed, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, Pejgamberi i mëshirës dhe teubes.

Shaban është emër i muajit (të tetë të kalendarit lunar), kështu është emërtuar sepse arabët shpërndaheshin për të kërkuar ujë, ose sipas disave për shkak të shpërndarjes nëpër shpella, e sipas të tretëve për shkak se gjendet mes muajit Rexheb dhe Ramazan. Shumësi i këtij emri është Shabanat ose Sheabiin.

Duke e analizuar sunnetin dhe hadithet e të Dërguarit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, do të mësojmë për disa vepra me të cilat i Dërguari e veçonte këtë muaj prej të cilave më i potencur ishte:

Agjërimi në muajin Shaban

Aisheja, radijall-llahu anha, thotë: "Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, agjëronte sa që mendonim se aspak nuk është duke ngrënë, dhe nuk agjëronte sa që thonim se aspak nuk agjëronte. Nuk e kam parë Pejgamberin, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, duke agjëruar një muaj të plotë përveç Ramazanit, kurse më së shumti e kam parë duke agjëruar në muajin Shaban". (Buhariu dhe Muslimi). Në transmetimin tjetër të Muslimit qëndron: "E agjëronte gjithë Shabanin, përveç një pjesës së vogël".

Një grup i dijetarëve, prej tyre është edhe Abdull-llah ibën Mubareku, kanë anuar nga mendimi se Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, kurrë nuk e ka plotësuar muajin e Shabanit me agjërim, por e ka agjëruar pjesën më të madhe. Këtë mendim e përforcon hadithi të cilin e transmeton Muslimi nga Aisheja, radijall-llahu anha, ku thotë: "Nuk di se Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka agjëruar muaj të plotë përveç Ramazanit", ose në transmetimin tjetër: "nuk e kam parë duke agjëruar një muaj të plotë prej ditës që ka ardhur në Medinë, në përjashtim të Ramazanit".

Kurse Ibën Abbasi, radijall-llahu anhu, thotë: "Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, nuk ka agjëruar asnjë muaj të plotë përveç Ramazanit". (Buhariu dhe Muslimi). Andaj Ibën Abbasi, radijall-llahu anhu, e urrente të agjëron muaj të plotë përveç Ramazanit.

Ibën Haxheri, rahimehull-llah, thotë: "Agjërimi i tij vullnetar ishte më i shumtë në muajin e Shabanit sesa në muajtë tjerë. Ai agjëronte pjesën më të madhe të Shabanit".

Usame ibën Zejdi, radijall-llahu anhu, thotë: i thashë Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem: të shoh që më së shumti je duke e agjëruar muajin e Shabanit? Mu përgjeggj: ky është muaji që njerëzit e neglizhojnë, sepse gjendet mes Rexhebit dhe Ramazanit. Ky është muaji që ngriten veprat te Zoti i botëve, kurse unë dëshiroj

që të më ngriten veprat duke qenë agjërueshëm". (Transmeton Nesaiu. Shiko: "Sahihut-Tergibi vet-Terhibi", të Shejh Albanit, rahimehull-llah, fq. 425). Kurse në transmetimin e Ebu Davudit, Aisheja, radijall-llahu anha, thotë: "Muaji më i dashur për ta agjëruar Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ishte muaji Shaban, pastaj e vazhdonte me muajin Ramazan". (Shejh Albani, rahimehull-llah, thotë se ky hadith është i vërtetë. Shiko: "Sahih Sunen Ebi Davud", 2/461).

Ibën Rexhebi, rahimehull-llah, thotë: "agjërimi i muajit Shaban është më i vlefshëm se agjërimi i muajve të shenjtë, kurse agjërimi më i mirë vullnetar është ai që është më afër Ramazanit, qoftë para ose mbrapa, ashtu sikurse namazet vullnetare me farzet, ato që falen para edhe ato që falen mbrapa, domethënë i plotësojnë mangësitë e farzeve. E njëjta gjë vlen edhe për agjërimin. Pastaj ashtu sikurse që sunetet e rregullta janë më të vlefshme sesa namazi vullnetar, ashtu edhe agjërimi para Ramazanit dhe pas është më i mirë sesa ai që është më larg.

Fjala e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem: "Shabani është muaj që e neglizhojnë njerëzit sepse gjendet mes Rexhebit dhe Ramazanit", domethënë se pasi që kufizohet me dy muaj të mëdhenj, muaji i shenjtë dhe muaji i agjërimit, njerëzit angazhohen nga ky muaj, andaj bëhet i neglizhuar. Shumica e njerëzve mendojnë se agjërimi i Rexhebit është më i vlefshëm se agjërimi i muajit Shaban, sepse muaji Rexheb është muaji i shenjtë, mirëpo kjo nuk është e saktë.

Në hadithin e lartëpërmendur tregohet se mundet disa kohëra, vende ose persona të njihen si më të vlefshëm edhe pse gjinden

kohëra, vende ose persona që janë më të vlefshëm se to.

Në këtë hadith gjithashtu ka argument se është e pëlqyeshme që të shfrytëzohen me ibadet kohërat që i neglizhojnë njerëzit. Për këtë disa nga selefi (muslimanët e parë) e shfrytëzonin kohën mes Jacisë dhe Akshamit me ibadet, sepse shumica e njerëzve janë neglizhent nga ibadeti në këtë kohë. E njëjta vlenë edhe për përmendjen e All-llahut, subhanehu ve tealë, në treg, sepse e përmendin All-llahun në vend të neglizhencës dhe mes neglizhentëve. Të shfrytëzosh me ibadete kohën që zakonisht njerëzit e neglizhojnë, ka shumë dobi, prej tyre janë:

Dobitë e adhurimeve në kohëra që i neglizhojnë njerëzit:

- Më lehtë e ke ta fshehësh këtë ibadet, kurse te veprat vullnetare fshehja e tyre është më e mirë. Sidomos agjërimi, i cili është ibadet i fshehur me robit dhe Zotit të vet, për këtë edhe është thënë se në te nuk ka mundësi të ketë rija, syfaqësi. Ka pasur njerëz nga selefi që kanë agjëruar me vite, askush nuk e ka ditur. Kur ka dalur nga shtëpia për në treg ka marrë me vete bukën, rrugës i jepte ato sadaka, kurse ai vet agjëronte. Kështu, familja e tij mendonte se ka ngrënë bukën, kurse njerëzit e tregut mendoni se ka ngrënë në shtëpi. Për këtë, selefi e kanë pëlqyer për atë që agjëron që të tregon gjëra me të cilat do ta fshehë agjërimitin e tij. Abdull-llah ibën Mesudi, radijall-llahu anhu, thotë: "nëse agjëroni, përdorni vajra (në fytyrë dhe flokë)". Kurse Katadeja, rahimehull-llah, thotë: "është e pëlqyer për agjëruesin që të përdorë vajra, që të largon nga vetja pluhurin e agjërimit".

- Veprat e mira në kohën e neglizhencës janë të rënda për nefsin, kurse prej shkaqeve që një vepër e bëjnë më të

vlefshme, është vështirësi e tyre për nefsin, sepse kur një vepër e bëjnë shumë njerëz, atëherë është ma e lehtë, kurse nëse e neglizhojnë një vepër shumica e njerëzve, atëherë u bëhet e rëndë të zgjuarve. Transmeton Imam Muslimi nga Ma'kel ibën Jesari, radijall-llahu anhu, se Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "Ibadeti në kohën e fitnes është sikur të bësh hixhret tek Unë". Sepse në këtë kohë njerëzit i pasojnë epsheet e tyre, andaj ai që kapet për të vërtetën është duke bërë një vepër të rëndë.

Shkaku i agjërimit të shpeshtë në Shaban

Dijetarët kanë shumë mendime për shkakun e agjërimit të shumtë të Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, në muajin Shaban, prej tyre janë edhe këto mendime:

1- Nuk mundej ti agjëron çdo herë nga tre ditë të çdo muajit për shkak të udhëtimit, andaj të gjitha këto i kompensonte në muajin Shaban. Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, kur e bënte ndonjë vepër vullnetar e vazhdonte, e nëse i kalonte e kompensonte.

2- Disa kanë thënë: gratë e tij, i kompensojnë ditët e mbetura nga Ramazani i kaluar në muajin Shaban, edhe ai agjëronte me to. Këtë e vërteton edhe Aisheja, radijall-llahu anha, e cila e vononte kompensimin e agjërimit të ditëve të mbetura nga Ramazani deri në Shaban, sepse ishte e angazhuar me Pejgamberin, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem.

3- Disa të tjerë kanë thënë: sepse është muaji që shumica e njerëzve e neglizhojnë. Ky është mendimi më i saktë, duke u mbështetur në hadithin e Usame ibën Zejdit që e përmendëm pak më lartë.

Në këtë rast duhet t'ua tërheqim vërejtjen se atij që i ka mbetur diç pa agjëruar nga

muaji i kaluar i Ramazanit, duhet ta kompensoj para se të hyjë muaji i ardhshëm i Ramazanit dhe nuk i lejohet ta vonojë, përveç se me ndonjë arsye. Ai që ka mundësi ta kompensoj para Ramazanit të ardhshëm dhe nuk e ka bërë, përveç kompensimit duhet bërë teube dhe për çdo ditë duhet ushqyer nga një të varfër. Ky është mendimi i Malikut, Shafiut dhe Ahmedit.

Prej dobive të agjërimit të muajit Shaban është se agjërimi i këtij muaji e stërvitë njeriun para ardhjes së agjërimit të muajit Ramazan, që mos ti vjen i rëndë agjërimi i muajit Ramazan, por i vjen muaji i Ramazani, kurse ky është i përgatitur dhe aktiv.

Agjërimi në fund të Shabanit

Tregon Ebu Hurejreja, radijall-llahu anhu, se Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "Mos agjëroni para Ramazanit një ose dy ditë, përveç atij që ka agjëruar ditë të zakonshme". (Buhariu dhe Muslimi)

Sipas argumenteve që i kemi në disponim agjërimi para muajit Ramazan i ka tre situata:

A) Të agjëron me nijet që mos të gabon fillimin e muajit Ramazan, kjo është haram.

B) Të agjëron me nijet të zotimit, ose kompensimit, etj, kjo është e lejuar sipas shumicës së dijetarëve, dhe

C) Të agjëron me nijet të agjërimit vullnetar, nëse e ka pasur traditë ti agjëron ato ditë, siç është e hënë dhe e enjte, atëherë i agjëron, përndryshe jo.

Nëse ndokush thotë: pse urrehet të agjërohet në ditët para muajit Ramazan, si përgjigje mund të themi, se kjo është kështu për shumë aspekte:

1- Për mos t'i shtuar muajit të Ramazanit ditë që nuk janë të tij. Për këtë shkak është i ndaluar edhe agjërimi i ditës së bajramit, që

mos të bëjnë muslimanët siç kanë bërë pasuesit e librave, të cilët kanë shtuar sipas mendimeve dhe epsheve të tyre. Për këtë edhe ka ndaluar Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, agjërimin e ditës së dyshimtë.

2- Për të ndarë agjërimin vullnetar nga ai obligueshëm, edhe kjo është një gjë e ligjshme. Për këtë Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka ndaluar ngjitjen e namazit obligueshëm me atë vullnetar pa i ndarë ato me selam ose fjalë, sidomos sunnetet para namazit të sabahut.

Ndokush mund të mendojë se ngrënia para Ramazanit ka për qëllim ngopjen me ushqim dhe ngopjen e epsheve para se ta ndalon nga ushqimi me agjërim, por kjo është gabim dhe injorancë, nëse ndokush kështu ka menduar.

Leximi i Kur'anit dhe lëmosha

Pasi që muaji Shaban është paralajmërues i muajit Ramazan, atëherë edhe ky muaj duhet të ketë disa gjëra që i ka muaji i Ramazanit, siç është agjërimi, leximi i Kur'anit dhe dhënia e lëmoshës. Seleme ibën Suhejli thoshte: Muaji i Shabanit është muaj i lexuesve të Kur'anit".

Edhe Habib ibën Ebi Thabit kur hynte muaji Shaban thoshte: Ky është muaji i lexuesve të Kur'anit. Kurse Amr ibën Kajs el-Mulai kur hynte muaji i Shabanit, e mbyllte dyqanin e tij dhe lirohej nga angazhimet tjera për të lexuar Kur'an.

Festimi i natës në mes të muajit Shaban (Lejletul Berat)

All-llahu, subhanehu ve teala, thotë: "Sot përsosa për ju fenë tuaj, plotësova ndaj jush dhuntinë Time, zgjodha për ju islamin fe". (El-Maide: 3).

"A mos kanë ata ortakë (zota ose idhuj) që u përcaktuan atyre fé, të cilën nuk e urdhëroi All-llahu?". (Esh-Shura: 21).

Transmeton Buhariu dhe Muslimi nga Aisheja, radijall-llahu anha, se Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "Kush shpikë në fenë tonë gjëra që s'janë prej sajë, kjo vepër është e refuzuar".

Transmeton Xhabiri, radijall-llahu anhu, se Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, gjatë hutbes së tij thoshte: "Biseda më e mirë është, Libri i All-llahut e udhëzimi më i mirë është udhëzimi i Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, kurse gjërat më të këqija janë ato të shpikurat, kurse çdo bidat është delalet". (Muslimi).

Shumë ajete dhe hadithe flasin në këtë drejtim.

Prej bidateve që i kanë shpikur njerëzit është edhe festimi i natës në mes të muajit shaban (nata e beratit), duke e veçuar këtë ditë me agjërim, duke mos pasur për këtë argument në të cilin mundet të mbështetemi. Mbi vlerën e kësaj dite ekzistojnë disa hadithe, mirëpo janë të dobëta, kurse sa i përket namazit në këtë ditë, të gjitha janë apokrifë, siç e kanë treguar këtë shumë dijetarë. Disa prej tyre do t'i përmendim pak më poshtë.

Sipas mendimit të shumicës së dijetarëve festimi i kësaj dite është bidat dhe se hadithet që flasin për këtë ditë janë të dobëta, e disa janë edhe apokrifë. Prej dijetarëve që e kanë treguar këtë gjë është edhe Ibën Rexhebi, rahimehull-llah, në librin "Letaiful-Mearif". Sipas disave ka mundësi të punohet me hadith të dobët, mirëpo nëse për këtë vepër ka bazë të shëndoshë në hadithet e vërteta, kurse për këtë ditë nuk ka bazë të shëndoshë, që ta forcojmë me hadith të dobët. Këtë rregull e ka sqaruar shumë mirë Shejhul-Islam, Ibën Tejmijje, rahimehull-llah.

Të gjithë dijetarët janë të pajtimit se nëse muslimanët kanë mendime të ndryshme për

ndonjë çështje, duhet kthyer në Kur'an dhe Sunnet, e çka të gjykojnë ato, ose njëri prej tyre, ajo është sherijat dhe fe që duhet ta pasojmë, kurse ajo që është në kundërshtim me te duhet refuzuar. Nëse për ndonjë ibadet nuk ka bazë në Kur'an dhe Sunnet, atëherë është bidat të cilin nuk lejohet ta bëjmë, e mos të flasim për davet në te ose t'i nxisim njerëzit në këtë vepër. All-llahu, subhanehu ve teala, thotë: "Nëse nuk pajtoheni për ndonjë çështje, atëherë parashtrojeni atë te All-llahu (te libri i Tij) dhe te i dërguari, po qe se i besoni All-llahut dhe ditës së fundit. Kjo është më e dobishmja dhe përfundimi më i mirë". (En-Nisa: 59).

Ka shumë ajete që flasin në këtë drejtim dhe janë vendimtare se gjatë mendimeve të ndryshme duhet kthyer në Kur'an dhe Sunnet, dhe se duhet kënaqur me këtë gjykim, dhe se kjo është argument i imanit të një besimtari dhe e mirë për robin në dunja dhe ahiret.

Hafidh Ibën Rexhebi, rahimehull-llah, në librin e tij, "Letaiful-Mearif", thotë: "Namazi gjatë natës në mes të muajit shaban nuk ka bazë nga Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, e as nga shokët e tij".

Kurse çdo gjë që nuk ka bazë në argumente të shëndosha nuk i lejohet muslimanit ta shpikë në fe, pa marrë para sysh a është duke e bërë vet ose në grup, pa marrë para sysh a e bënë publikisht ose e fshehtë, duke u bazuar në përgjithshmërinë e fjalës së Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem: "Kush shpikë në fenë tonë gjëra që s'janë prej sajë, kjo vepër është e refuzuar".

Imam Ebu Bekr Tartushi në librin e tij, "Shpikjet dhe bidatet", thotë: "transmetohet nga Ibën Vedahi, e ky nga Zejd ibën Eslemi, i cili ka thënë: asnjë hoxhë i yni e as fukahatë tonë nuk i kanë dhënë asnjë vlerë

natës së mesme të muajit shaban, nuk e kanë zë gjë hadithin e Mekhulit, nuk e kanë konsideruar natë me vlerë. Kur Ibën Ebi Melikeja e ka dëgjuar njërin duke thënë: fulani thotë se nata e Beratit ka vlera sa nata e Kadrit, ia ktheu: po ta dëgjoja do ta goditja me shkop".

Shevkaniu, rahimehull-llah, në librin e tij, "Dobi të përmbledhura", thotë: "Hadithi që fletë për namazin e natës së mesme të muajit shaban është i trilluar". E në disa libra tjerë ka thënë se është i kotë, i pa bazë, i dobët etj.

Disa dijetarë janë mashtruar me këto hadithe, siç është rasti me Ebu Hamid Gazalin dhe disa dijetarë të tefsirit.

Hafidh Iraku thotë: Hadithi që flet për namazin në natën e mesme të muajit shaban është i trilluar mbi Pejgamberin, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, dhe është gënjeshtër mbi te".

Imam Nevevi thotë: "Namazi i Regaibit dhe namazi i natës së beratit janë bidate dhe nuk duhet të mashtrohet ndokush nga fakti se janë të përmendura në librin "Kutul-Kulub", ose "lhaju ulumud-din", e as nga hadithet që janë përmendur atje, sepse krejt ato janë të kota, e as me shkrimet e disa dijetarëve që u është përzier kjo çështje, sepse ata kanë gabuar në këtë rast".

Shejhu Ebu Muhammed, Abdur-Rahman ibën Ismail El-Makdisiu ka shkruar libër shumë të vlefshëm mbi këtë temë, ku ka vërtetuar kotësinë e sajë në mënyrë të zgjeruar dhe të mirë. Dijetarët kanë folur shumë rreth kësaj teme, po të dëshironim t'i përmendim do ta zgjatnim shumë. Mirëpo kjo që kemi përmendur, mendojmë se mjafton për ate që e kërkon të vërtetën.

Ajetet, hadithet dhe fjalët e dijetarëve që i përmendëm më lartë i sqarojnë kërkuesit të të vërtetës se: festimi i natës në mes të

muajit shaban, me namaz ose gjëra tjera, veçimi i ditës së sajë me agjërim, është bidat i urretur sipas shumicës së dijetarëve dhe nuk ka bazë në sherijatin e pastër, bidat i cili ka dalur pas shekujve të sahabeve, radijall-llahu anhum.

Në këtë kontekst kërkuesit të të vërtetës i mjafton ajeti: "Sot përsosa për ju fenë tuaj..". Dhe ajetet tjera që flasin në këtë drejtim.

Edhe hadithi: "Kush shpikë në fenë tonë gjëra që s'janë prej sajë, kjo vepër është e refuzuar".

Imam Muslimi transmeton nga Ebu Hurejre, radijall-llahu anhu, i cili thotë se Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "Mos e veçoni natën e xhuma me namaz të veçantë, e as ditën e sajë me agjërim të veçantë, në përjashtim të rastit kur ju takon në agjërim të zakonshëm".

Po të ishte e lejuar të veçohet ndonjë natë me agjërim, atëherë nata më meritore do të ishte nata e xhuma, sepse dita e sajë është dita më e mirë në të cilën ka lindur dielli, sipas haditheve të Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem. Pasiqë Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ua ka tërhjekur vërejtjen nga veçimi i natës së xhuma me namaz të veçantë, kjo tregon se veçimi i ndonjë nate tjetër edhe më parë është i ndaluar, në përjashtim të ndonjë rastit kur është veçuar me hadith të vërtetë.

Pasi që sipas sherijatit është e ligjshme namazi i natës gjatë ramazanit dhe natës së Kadrit, Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ua ka treguar ummetit dhe i ka nxitur në te, bile edhe vet i ka bërë.

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, thotë: "Kush falet gjatë netëve të Ramazanit, me besim dhe shpresë të

shpërblimit, i falen mëkatet e mëparshme". (Buhariu dhe Muslimi).

"Kush e falët Natën e Kadrit me besim dhe shpresim të shpërblimit, i falen mëkatet që i ka bërë më parë". (Buhariu dhe Muslimi).

Kështu që, po të ishte nata në mes të muajit shaban dhe nata e parë e xhumasë së parë të Rexhebit (që e quajnë Regaib), ose nata e Israsë dhe Miraxhit e ligjshme veçimi i tyre me festim ose me ndonjë ibadet të veçantë, do tia tregonte Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, këtë mbarë ummetit ose do ta bënte vetë, po të ndodhte diç e tillë, këtë do të na e tregonin sahabet e tij e nuk do të na e fshehnin, sepse ata kanë qenë njerëzit që më së shumti kanë këshilluar, pas Pejgamberëve. All-llahu qoftë i kënaqur prej tyre.

Pak më parë të treguam fjalët e dijetarëve se për këtë gjë nuk ka asnjë hadith të vërtetë nga Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, e as nga sahabet e tij,, radijall-llahu anhum, as për natën e Regaibit e as për natën e Beratit, atëherë na bëhet e qartë se festimi i kësaj nate është bidat, gjë e shpikur në Islam edhe veçimi me ibadet të veçantë është bidat. Kjo vlenë edhe për natën e Israsë dhe Miraxhit.

...

E lusim All-llahun që ti udhëzojë mbarë muslimanët që të kapen për Sunnet dhe të përqëndrohen në te dhe të kujdesen prej bidateve dhe gjërave që i kundërshtohen. Paqa dhe bekimi qofshin mbi Muhammedin, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, dhe mbi shokët e tij në përgjithësi.

Bekir Halimi

Talha Kurtishi

Referencat: "Lataiful-Mearif fima limevasimil-Ami minel-Vedhaifi", të Ibën Rexheb Hanbeliut

"Përmbledhja e fetvave" të shejh Ibën Baz, rahimehull-llah, vëll. 2, fq. 882

"El-Ilamamu bishejin min ahkamis-Sijami", Abdul-Azizi Raxhihi

Veçoritë e besimit

Akideja islame veçohet me:

1. Qartësi. Pra ky besim është i qartë pa mugullim dhe komplikime. Mund të rezymohet në atë se krijesat kanë një Hyjni i Cili meriton të adhurohet, ai është Allahu, subhanehu ve teala, që krijoi këtë gjithësi të mrekulluar dhe të harmonizuar dhe çdo gjë në të e paracaktoi. Ky Zot nuk ka rival, të ngjashëm, bashkëshorte apo fëmijë. Kjo qartësi përputhet me logjikën e shëndoshë sepse logjika vazhdimisht kërkon lidhshmërinë dhe unitetin kur kemi të bëjmë me llojlojshmërinë e gjerave, dhe dëshiron që gjërat e ndryshme të kthehen te një shkak. Pasi që kjo Akide është e qartë, ajo nuk thërret në pasim të verbër porse na nxitë që të logjikojmë dhe meditojmë, "Thuaj: "Kjo është rruga ime, e vënë në fakte të qarta, e që unë thërras te All-llahu, unë dhe ai që vjen pas meje. Larg të metave është All-llahu, e unë nuk jam nga idhujtarët." (Jusuf – 109). Po ashtu, Akideja i huton mendjet të cilat pa u mbështetur në shpalljet e Zotit mëtojnë të arrijnë tek ajo. Shumë filozof dhe apologjetë braktisën metodologjitë e tyre dhe u kapën për metodologjinë e Kur'anit dhe Sunnetit . Prej tyre ishte Fahrudin Er Razi, një filozof i madh musliman, i cili pas një përvoje të gjatë në studime racionale, thotë: "fondi i logjikeve tona është qorrrokaku dhe veprimtaria e shumë njerëzve është në lajthitje. Shpirtat tonë nuk i kemi aspak të rehatshëm, kurse atë që fituam prej kësaj dunjaje është dhimbje dhe sëmundje. Nuk kemi përfituar nga studimi ynë (filozofik, racional) gjatë tërë jetës tonë, vetëm se kemi mbledhur thashetheme." Pastaj vazhdoi: "kam medituar thëllë në rrymat apologjete dhe metodologjitë filozofike, mirëpo nuk kam gjetur në to ilaçin që kërkoja. Metodologjia më e kapur për mendjen është ajo e Kur'anit. Tani lexoj dhe pohoj ajetin: "(Ai është) Mëshiruesi që u lartësua mbi Arsh" (Ta ha, 5), "te Ai ngritët fjala e mirë (besimi) dhe veprimi i mirë," (Fatir, 10), dhe lexoj duke mohuar atë që Allahu, subhanehu ve teala, e ka mohuar në ajetin: "dija e tyre nuk mund ta përfshijë. Atë." (Ta ha, 110), e ai që provon atë që unë kam provuar do të kuptojë atë unë kam kuptuar.

2. Përputhja e akides me natyrën njerëzore. Akideja islame nuk është e panjohur për natyrën e pastër të njeriut e as që e kundërshton atë, madje ajo është në përputhshmëri të plotë me të. Kjo nuk është një gjë për t'u habitur sepse Krijuesi i Gjithëdijshëm, është Ai i cili ia ligjësoi njeriut këtë fe, dhe Ai e di më së miri se çka i përshtatet atij, Allahu thotë: "Përqendro vetveten tënde singërisht në fenë, i larguar prej çdo të kote, (e ajo fé), feja e All-llahut në të cilën i krijoi njerëzit, s'ka ndryshim të asaj natyrshmërie të krijuar nga All-llahu, ajo është feja e drejtë por shumica e njerëzve nuk e dinë." (Rum, 30), po ashtu thotë: "A nuk e di Ai që ka krijuar, kur dihet se Ai depërton në thellësi të sekreteve, i njeh hollësitë." (Mulk – 14). Realiteti është dëshmitar për përputhjen e natyrës së pastër njerëzore me Akidenë islame që është ngritur mbi bazën e singëritetit, atëherë kur njeriu e godet ndonjë e keqe të

cilën forcat materiale nuk mund ta largojnë. Në atë rast menjëherë i drejtohet Allahut me përkulje e përkushtim. Në këtë janë të barabartë muslimani dhe jomuslimani, madje edhe fëmija i vogël nëse lihet ashtu siç është, pa ndikuar në të prindërit dhe rrethi, do të zhvillohej së bashku me besimin në një Zot të vetëm, të Cilit nuk do t'ia shoqëronte askënd në adhurim. Për këtë, Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: “çdo fëmijë lindet në natyrë të pastër, pasta prindërit e bëjnë hebre, krishterë apo zjarrputist.”

3. Akideja islame mbështet në Kur'an dhe sunnet dhe është e argumentuar. Akideja islame veçohet me atë se nuk i kalon tekstet e Kur'anit dhe Sunnetit, sepse veti e saj kryesore është argumentimi. Gjatë konkluzioneve të sajë nuk mjaftohet vetëm me Shpalljen, por e nderon edhe mendjen. Ithtarët e sajë e kanë të ndaluar që të futen në çështjet e Akides pa argument, Allahu, subhanehu ve teala, thotë: “Mos iu qas asaj për të cilën nuk ke njohuri, pse të dëgjuarit, të pamurit dhe zemra, për të gjitha këto ka përgjegjësi.” (Isra, 36), po ashtu thotë: “All-llahu nuk e humb një popull pasi që ta ketë udhëzuar atë, para se t'ju sqarojë atyre se prej çka duhet ruajtur. All-llahu është i Gjithëdijshëm për secilin send.” (Teube, 115). Kur'ani fisnik kur i thërret njerëzit të besojnë në çështjet e ndryshme të Akides, sjell argumente nga horizontet dhe nga vetë ata. Ai nuk thërret në pasim të verbër, madje ai i mëson ata që të kërkojnë argumente “Thuaju: "Sillni argumentin tuaj (çka thoni) po qe se jeni të drejtë” (Bekare, 111). Kur flasim për argumentet duhet të dimë se:

a) Argumentet e Akides përkufizohen në Kur'an dhe Sunnet.

b) Duhet t'i përmbahemi shprehjeve (termeve) të këtyre dy burimeve kur flitet për çështjet e besimit.

c) Marrja parasysht konotacionin e përdorimit të këtyre termeve.

d) Moshtrembërimi i kuptimit të fjalëve duke iu dhënë kuptime që nuk i bartin ato terme.

e) Të heshturit për ato gjëra të besimit për të cilat nuk flet Kur'ani dhe Sunneti.

f) Duhet t'i japim përparësi Kur'anit dhe Sunnetit ndaj burimeve tjera të njohjes siç janë: logjika, shqisat, shija e tjera.

Shembujt që flasim për argumentimin e Akides islame janë si vijojnë:

-argumenti logjik, fjala e Allahut: “A mos u krijuam prej kurrgjësë, apo ata vetë janë krijues?” (Tur, 35)

-argument nga vet njeriu, fjala e Allahut: “Edhe në tokë ka argumente për ata të bindurit. Po edhe në veten tuaj. A nuk jeni kah e shihni?” (Dharijat, 20, 21)

-argumenti nga horizontet, fjala e Allahut: “Ai i lejoi dy detet të puqen ndërmjet vete. Ndërmjet atyre të dyve është një pengues që ata të dy nuk e kapërcejnë.” (Rahman, 19, 20)

4. Akideja islame është e pandryshuar dhe e përhershme. Pasi që Akideja islame ngritët mbi argumente dhe fakte atëherë patjetër të jetë e pandryshuar dhe e përhershme, Allahu thotë: “Fjalët e All-llahut nuk mund të pësojnë ndryshim.” (Junus, 64). Shkak i kësaj është pandryshueshmëria dhe përhershshmëria e burimeve të saj, sepse Allahu mori përgjegjësinë e mbrojtjes së tyre: “Ne me madhërinë Tonë e shpallëm Kur'anin dhe Ne gjithsesi jemi mbrojtës të tij. (Hixhër, 9), pra është besim i pandryshuar dhe i definuar, nuk pranon shtesa as mangësi, as falsifikim e as ndryshim. Asnjë kryetarë, apo institucion shkencor, apo ndonjë kongres fetar nuk mund të shtojnë diçka apo të heqë nga ky besim sepse ajo do të ishte e refuzuar me fjalën e Pejgamberit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, “çdonjëri i cili shpik diçka në fenë tonë, që nuk është prej sajë, ajo

është refuzuar.” (Buhariu dhe Muslimi). Kur’ani ua ka tërhequr vërejtjen dijetarëve në veçanti që të mos bien nën ndikimin e epsheve dhe aspiratave të tyre e të shtojnë apo heqin diç që është prej kësaj feje, Allahu thotë: “Është shkatërrim për ata që me duart e veta e shkruajnë librin, e pastaj thonë: “Ky është prej All-llahut!” E për të arritur me të një fitim të paktë, pra është shkatërrim i madh për ta çka shkruan duart e tyre dhe është shkatërrim i madh për ta ajo çka fitojnë.” (Bekare, 79). Duke patur parasysh këto argumente themi se të gjitha risitë, përrallat, gjërat e kota që janë futur në disa libra të muslimanëve apo janë shpërndarë në mesin e muslimanëve janë të kota, të refuzuara dhe nuk i pranon Kur’ani, nuk argumentohet me to, porse me atë që është vërtetuar. Allahu, subhanehu ve teala, thotë: “Të dërguar që ishin lajmëzues e kërcënues, ashtu që pas dërgimit të dërguarve njerëzit të mos kenë fakt (arsyetim) para All-llahut.” (Nisa, 165)

5. Akideja islame është mesazhi në të cilën nuk as ekstremizëm e as liberalizëm total. Akideja islame është në mes atyre që mohojnë gjithçka që është jonatyrore, që nuk mund të kapet me shqisa dhe atyre të cilët besojnë në më shumë se një Zot, ata të cilët mbretin apo kryetarin e tyre e konsiderojnë hyjni, madje edhe disa kafshë, bimë dhe gjëra tjera të ngurta. Akideja islame refuzoi rrymën ateiste ashtu siç mohoi injorancën politeiste dhe pohoi njëshmërinë e Krijuesit i Cili nuk ka rival. Po ashtu ky besim është mesatar kur janë në pyetje cilësitë e patjetërsuara të Zotit, ndërmjet atyre të cilët mohuan deri në skajshmëri që Zoti të ketë cilësi siç vepruan filozofët grek dhe atyre të cilët duke pohuar cilësitë e Zotit ranë në përngjasim të Krijuesit me krijesën siç vepruan disa ithtarë të besimeve të kota. Besimi islam Krijuesin e konsideron larg përngjasimit me krijesat, “Asnjë send nuk është si Ai; Ai është dëgjuesi, shikuesi.” (Shura, 11), “Dhe Atij askush nuk i është i barabartë.” (Ihlas, 4), “A di për Të ndonjë të ngjashëm” (Merjem, 65), megjithëkëtë Krijuesin e cilësojnë me cilësi pozitive që shkaktojnë shpresë dhe frikë te njerëzit, thotë Allahu, subhanehu ve teala, : “All-llahu është një, nuk ka zot tjetër përveç Atij. Ai është Mbikëqyrës i Përhershëm dhe i Përfshëm. Atë nuk e kap as kotja as gjumë, gjithçka ka në qiej dhe në tokë është vetëm e Tij. Kush mund të ndërmjetësojë tek Ai, pos me lejen e Tij, e di të tashmen që është pranë tyre dhe të ardhmen, nga ajo që Ai di, tjerët dinë vetëm aq sa Ai ka dëshiruar, Kursija e Tij përfshijnë qiejt dhe tokën. Kujdesi i Tij ndaj të dyjave, nuk i vjen rëndë, Ai është më i larti, më i madhi.” (Bekare, 255). Po ashtu kjo Akide është ndërmjet nënshtrimit naiv, pasimit të verbër në çështjet e besimit dhe ndërmjet atyre të cilët mendojnë se me mendjet e tyre mund të arrijnë gjithçka madje edhe kuptimin e esencial te cilësive dhe qenies hyjnore. Pra ky besim ndalon imitimimin e verbër, siç qëndron në ajetin “Jo, por ata thanë: “Ne i kemi gjetur të parët tanë në këtë fë dhe vazhdojmë gjurmëve të tyre” (Zuhruf, 22) ashtu siç ndalon teprimin e besimit në logjikë dhe se me të mund të kuptojmë realitetin e cilësive të Allahut, siç qëndron në ajetin: “Mos iu qas asaj për të cilën nuk ke njohuri, pse të dëgjuarit, të pamurit dhe zemra, për të gjitha këto ka përgjegjësi.” (Isra, 36). Njerëzit i nxitu që të jenë mesatarë dhe të logjikojnë rreth argumenteve që aludojnë në ekzistimin e Zotit, “Edhe në tokë ka argumente për ata të bindurit. Po edhe në veten tuaj. A nuk jeni kah e shihni?” (Dharijat, 20, 21)

Agim Bekiri

Pyetje dhe përgjigje

Numri: 1198 Data: 3.9.2005

Pyetje: Sa është e lejuar të shprehurit me fjalën: e kemi njohur Zotin me mendjet tona? Shtjelloni në hollësi këtë çështje, Allahu ju shpërbleftë!?

Përgjigje: Falënderimi i takon Allahut, subhanehu ve teala. Kur Zoti i krijoi njerëzit, në natyrën e tyre skaliti njohjen ndaj Tij. Njeriu pra, me natyrën e tij të pastër (fitren) e din se çdo krijesë patjetër të ketë krijuesin e sajë dhe se gjërat e shpikura patjetër të kenë shpikësin e tyre. Allahu, subhanehu ve teala, për ekzistimin, fuqinë, dijen dhe urtësinë e Tij ka përmendur argumentet kosmologjike të qiejve dhe Tokës dhe ka dënuar mospërfilljen e tyre nga mushrikët, Allahu thotë: “Sa e sa argumente ka në qiej e në tokë, të cilët i shohin, por ata nuk i vështrojnë fare.” (Jusuf, 105). Kjo njohuri të cilën e përfitojmë nga argumentet qiellore arrihet me mendje, studim dhe meditim, për këtë Allahu, subhanehu ve teala, thotë: “Dhe, a nuk menduan ata me veten e tyre se All-llahu nuk krijoi qiejt dhe tokën dhe çdo gjë që gjendet ndërmjet tyre pa ndonjë qëllim të caktuar dhe për një kohë të kufizuar.” (Rum, 8) kurse ajetet me këtë kuptim janë të shumtë. Megjithëkëtë, kjo njohuri që arrihet me mendje është njohuri globale, sepse njeriu në këtë mënyrë nuk mund ta njeh Zotin me gjithë emrat, cilësitë dhe veprat e Tij në mënyrë të detajizuar vetëm nëpërmjet pejgamberëve, librave që ka zbritur Allahu, subhanehu ve teala. Pejgamberët, sal-lall-llahu alejhim ve sel-lem, u dërguan për t’i njoftuar njerëzit me Zotin e tyre, me emrat dhe cilësitë e Tij, ç’është e domosdoshme dhe ç’është e lejuar për Të në mënyrë të hollësishme. Me këtë na bëhet e ditur se mendjet janë të paafta për t’i njohur cilësitë dhe emrat e Allahut, subhanehu ve teala, dhe ç’është e domosdoshme dhe ç’është e lejuar për Të në mënyrë të hollësishme. Kjo gjë pra nuk mund të arrihet vetëm se nëpërmjet pejgamberëve, mirëpo përsëri nuk mund që dija njerëzore ta përfshijë Zotin në të gjitha aspektet, siç thotë Allahu “po dija e tyre nuk mund ta përfshijë Atë” (Ta ha, 110) kurse Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, thotë: “nuk mund që të të jap falënderimin e duhur, por ti (o Zot) je ashtu siç e ke lavdëruar Vetën.” (Muslimi). Nga tërë kjo që u tha mund të përfundojmë se mënyrat e njohjes së Allahut janë mendja dhe Shpallja e Allahut (Kur’ani dhe Sunneti) dhe se disa emra dhe cilësi të Allahut njihen më shpallje dhe mendje kurse disa të tjera nuk mund të njihen vetëm se me shpallje.

Në këtë rast është mirë të tërheqim vëmendjen se bazë të njohjes duhet të bëjmë Shpalljen kurse mendjen ta bëjmë pasuese të saj me të cilën udhëzohet. Nga utopia e qartë është që të vijmë në kundërshtim Shpallja dhe logjika e shëndoshë siç pretenduan disa filozof dhe apologjet.

Allahu e udhëzoi Ehli Sunne vel xhema’a që të kapet për Kur’anin dhe Sunnetin e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, dhe ecjen gjurmëve të gjeneratave të para e të mira (selefit), duke venduar çdo gjë në vendin e tyre. Ata nderuan mendjen duke mos nënvlerësuar pozitën e saj as duke mos i dhënë përparësi ndaj Kur’anit dhe Sunnetit siç vepruan të devijuarit. Allahu udhëzoi ithtarët e Sunnetit në rrugën e drejtë. Lusim Allahun që edhe neve të na udhëzojë në këtë rrugë dhe ta na mbrojë nga rruga e atyre më të cilët Allahu u hidhërua dhe nga rruga e të devijuarve. Allahu e di më së miri.

Prof. Dr. Abdurahman ibën Nasir el Berrak

Shqipëroi: Agim Bekiri

Porosia e Nuhit, alejhis-selam

Kur Nuhit, alejhis-selam, i erdhi vdekja i tha të birit të tij: Po të porosis me disa porosi: Të urdhëroj në dy gjëra dhe të ndaloj në dy. Të urdhëroj në thënien La ilahe ilallah, se shtatë qiejt dhe shtatë tokat nëse vendosen në një anë të peshores dhe nga ana tjetër vendoset fjala La ilahe ilallah, kjo fjalë do të peshonte dhe do të anonte. Sikur shtatë qiejt dhe shtatë tokat të ishin një hallkë e mbyllur fort, fjala La ilahe ilallah do ta thyente atë, kurse fjala Subhanallahi ve bi hamdihi (I madhëruar qoftë Allahu dhe Atij i takon falënderimi) është duaja e çdo krijese dhe me të furnizohen ata. Dhe të ndaloj nga shirkun (Politeizmi) dhe kibri (mendjemadhësia) tha: Thashë ose është thënë: O i Dërguari i Allahut, për shirkun veç e kemi kuptuar dhe e dimë. Po na trego për kibrin? A mos është të kesh nalle të bukura? Tha: Jo. A mos është të kesh shokë që rrinë me ta bashkë? Tha: Jo. Atëherë u pyet Pejgamberi, alejhis-selam: O i Dërguari i Allahut, e atëherë çfarë është kibri? Tha: Nënvlërësimi i të vërtetës dhe fyerja e njerëzve. Transmeton Buhariu në Edebul Mufred 548, Ahmedi 2/169-170, dhe 225, dhe Bejhaku në El Esmā 79.

Po ashtu, nga Abdullah ibën Amri tregon se ishim te Pejgamberi, alejhis-selam, dhe aty erdhi një beduin (fshatar) me xhube të gjatë, e qëndisur me mëndafsh dhe tha: Me të vërtetë ky shoku juaj do të mposhtë kalorësit dhe të ngrejë barinjte. Pastaj Pejgamberi, alejhis-selam, e kapi për xhuben e tij dhe tha:

A nuk po të shoh të veshur me një petk të atyre që nuk kuptojnë. (për shkak të mëndafshit i cili është petk i veçantë për mosbesimtarët). Pastaj përmendi hadithin e lartpërmendur.

Thashë (Albani): senedi i këtij hadithi është i vërtetë. Transmeton Ahmedi dhe Taberaniu të ngjashëm si kjo, dhe me një transmetim tjetër thotë: Dhe të porosisë në tekbir dhe tespih se kjo është adhurim i krijesave. Transmeton Bezariu nga hadithi i lbën Omerit, transmetuesit e Ahmedit janë të besueshëm.

Përfitim nga hadithi

Thashë: (Albani) Në të ka shumë përfitime, mjafton ti përkujtojmë disa prej tyre:

1. Ligjësimi i vasijetit (porosisë) para vdekjes.
2. Vlera e tehlilit (La ilahe ilallah) dhe e tesbihut (Subhanallah), dhe se ata janë shkak për furnizimin e krijesave.
3. Dhe se peshorja në Ditën e Gjykimit është e vërtetë dhe se i ka dy anë. Ky është besimi i ehli sunnetit në dallim nga mu'tezilive dhe pasuesit e tyre të kohës së sotme, të cilët nuk besojnë në atë që është vërtetuar nga hadithet e vërteta duke pretenduar se janë hadithe ahad që nuk na japin bindje. E kam sqaruar kotësinë e këtij pretendimi në librin tim "Me profesor Tantavin".

4. Dhe se tokat janë shtatë, sikurse qiejt dhe për këtë ka hadithe të shumta në dy Sahihet dhe në të tjerët, si dhe për këtë dëshmon fjala e Allahut, subhanehu ue teala, ku thotë: “Allahu është Ai që krijoi shtatë palë qiej dhe prej tokës aq sa ata.” (Talak, 12.) Që do të thotë në krijim dhe numër dhe mos shiko se si komentojnë dhe si i ndryshojnë në mohim të numrave qofshin të qiejve apo të tokës sikurse kanë arritur disa shkencëtarë të zhvilluar evropianë të mohojnë këtë gjë dhe ata nuk njohin shtatë palë toka gjithashtu nuk dinë as për qiejt. A të mohojmë fjalën e Allahut dhe të Dërguarit të Tij për injorancën e evropianëve dhe të tjerëve me çdo respekt për ta? Çdo herë që shtojnë dijen e tyre mbi gjithësinë, aq më tepër iu shtohet bindja për injorancën e tyre.

Të vërtetën e thotë Zoti: “E juve u është dhënë fortë pak dije...” (Isra, 85).

5. Zbukurimi me rroba të bukura nuk është prej kibrit por kjo gjë është e ligjësuar, sepse Allahu është i bukur dhe e do bukurinë. Sikurse ka thënë i Dërguari i Allahut, alejhis-selam, në hadithin që transmeton Muslimi në Sahihun e tij për këtë çështje.

6. Kibri që është përmendur baraz me shirkun, ku nuk hyn në xhennet ai i cili ka një grimcë nga ajo, është kibri ndaj të vërtetës, refuzimi pas qartësimit dhe shpifja e njerëzve të pafajshëm pa të drejtë.

- Le të ketë kujdes çdo musliman që të mos cilësohet me diçka prej këtij vesi sikurse të kujdeset që të mos cilësohet me diçka i cili të fut përgjithmonë në zjarr.

Muhammed Nasirud-din Albani
përktheu: Fatmir Zaimi
marrë nga libri: Silsiletul el hadith es Sahiha

26. Mëshira

26. Xherir ibën Abdullahi, radijall-llahu anhu, transmeton se Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: “Kush nuk mëshiron nuk mëshirohet” (Buhariu dhe Muslimi)

Allahu, subhanehu ve teala, thotë: Muhamedi është i dërguar i Allahut, e ata që janë me të (sahabët) janë të ashpër kundër jobesimtarëve, të mëshirshëm ndërmjet vete” (Feth – 29), poashtu thotë: Ndaj besimtarëve bëhu i përlulur dhe i butë” (Hixhër – 88)

Muslimi me një sened tjetër transmeton se Ekra' ibën Jabisi e pa Pejgamberin, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, duke e puthur Hasenin, radijall-llahu anhu, dhe tha: Unë kam dhjetë fëmij dhe asnjërin prej tyre nuk e ka puthur. Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, ia ktheu: “Ai që nuk mëshiron nuk mëshirohet” Neveviu thotë: Dijetarët kanë thënë se kjo fjalë e Pejgamberit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, është e përgjithshme, përfshinë mëshirën ndaj fëmijëve dhe gjëra tjera.

Hadithi i lartëpërmendur na nxit që të jemi të mëshirshëm ndaj gjithë krijesave, ndaj besimtarit dhe jobesimtarit, ndaj kafshëve që i zotëron apo kafshëve që nuk i zotëron. Me mëshirë ndaj kafshëve nënkuptohet edhe dhënia e ushqimit, pijes, të mos ngarkohen tepër dhe mosrrahja e tyre.

Muslimani obligohet që të jetë i mëshirshëm ndaj vëllezërve të tij që ta mëshiron ate Allahu, Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: Allahu i mëshiron prej robërve të Tij ata që janë të mëshirshëm” (Buhariu) Gjithashtu thotë: Mëshirë nuk ka vetëm ai që është i keq” , (Ebu Davudi)

Mëshira është virtyt i shoqërisë islame, Allahu, subhanehu ve teala, thotë: Muhamedi është i dërguar i Allahut, e ata që janë me të (sahabët) janë të ashpër kundër jobesimtarëve, të mëshirshëm ndërmjet vete” (Feth – 29), kurse Pejgamberi, thotë: Shembulli i besimtarëve në mëshirën, dashurinë dhe ndjenjat e tyre reciproke është sikur shembulli i trupit, nëse një pjesë e tij ankohet tërë trupi e ndien dhimbjen me pagjumësi dhe temperaturë.” (Muslim)

Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, është shembëlltyra ynë më e mirë, ai ka qenë i mëshirshëm dhe i butë, Enesi, radijall-llahu anhu, thotë: Nuk kam parë ndonjë më të mëshirshëm ndaj fëmijëve se Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem” (Muslim), kjo mëshirë nuk ka qenë e veçantë vetëm ndaj fëmijëve porse i ka përfshirë edhe të rriturit ashtu siç e ka përshkruar Zoti i tij: “Është i ndijshëm dhe i mëshirshëm për besimtarët” (Teube – 128)

Në një fjalë është thënë: Prej shenjave të fisnikërisë është mëshira kurse ashpërsia është shenjë e poshtërsisë.

Ahmed Muadh Hakkij

Përktheu: Agim Bekiri

(pjesë nga libri: Katërdhjet hadithe mbi moralin, NuN, Shkup, 2005)